



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**PLANI I VEPRIMIT 2008 PËR IMPLEMENTIMIN E  
PARTNERITETIT EVROPIAN PËR KOSOVËN**



*destinacion be*  
AGJENCIA PËR INTEGRIM EVROPIAN



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet, me vërejtje, Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2008 dhe strukturat që kanë për qëllim monitorimin/zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian.
2. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2008 të rishikohet dhe harmonizohet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2008-2011 dhe planifikimet buxhetore për të njëjtën periudhë.
3. Ngarkohet Agjencia për Integrim Evropian në Zyrën e Kryeministrit për inkuorimin e vërejtjeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Agjencia për Integrim Evropian në Zyrën e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe ministritë - institucionet tjera relevante.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

## Përmbajtja

|            |                                                                                                     |           |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1</b>   | <b>HYRJE.....</b>                                                                                   | <b>9</b>  |
| <b>1.1</b> | <b>RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN.....</b>                                  | <b>9</b>  |
| <b>1.2</b> | <b>PUNËT FILLESTARE PËRGATITTORE NË PLANIN E VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN (PVPE 2008).....</b> | <b>10</b> |
| <b>1.3</b> | <b>SYNIMET E PLANIT KOSOVAR TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN .....</b>                          | <b>11</b> |
| <b>1.4</b> | <b>PËRMBAJTJA E PLANIT TË VEPRIMIT.....</b>                                                         | <b>12</b> |
| <b>1.5</b> | <b>SHTOJCAT/LLOJET E AKTIVITETEVE .....</b>                                                         | <b>13</b> |
| <b>1.6</b> | <b>MONITORIMI DHE RAPORTIMI SIPAS PVPE-SË DHE RISHQYRTIMIT TË PROGRAMIT .....</b>                   | <b>15</b> |
| <b>2</b>   | <b>KOMPONENTI NARRATIV I PVPE-SË 2008 .....</b>                                                     | <b>16</b> |
| <b>2.1</b> | <b>KRITERET POLITIKE .....</b>                                                                      | <b>16</b> |
| 2.1.1      | <i>Demokracia dhe Sundimi i Ligjit .....</i>                                                        | <i>16</i> |
| a.         | Kushtetuta .....                                                                                    | 16        |
| b.         | Parlamenti .....                                                                                    | 16        |
| c.         | Zgjedhjet .....                                                                                     | 17        |
| d.         | Qeveria .....                                                                                       | 18        |
| e.         | Administrata Publike (AP).....                                                                      | 18        |
| f.         | Vetë-Qeverisja Lokale/Decentralizimi.....                                                           | 22        |
| g.         | Sistemi Gjyqësor .....                                                                              | 22        |
| h.         | Politika Anti-Korrupsion.....                                                                       | 24        |
| 2.1.2      | <i>Të Drejtat Njerëzore dhe Mbrojtja e Pakicave .....</i>                                           | <i>25</i> |
| a.         | Të Drejtat Civile dhe Politike .....                                                                | 25        |
| b.         | Të Drejtat Ekonomike dhe Sociale .....                                                              | 25        |
| c.         | Të Drejtat e Pakicave, të Drejtat Kulturore dhe Mbrojtja e Pakicave.....                            | 26        |
| 2.1.3      | <i>Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare .....</i>                                          | <i>27</i> |
| <b>2.2</b> | <b>KRITERET EKONOMIKE .....</b>                                                                     | <b>28</b> |
| 2.2.1      | <i>Ekzistimi i Ekonomisë Funksionale të Tregut.....</i>                                             | <i>28</i> |
| a.         | Thelbi i Politikës Ekonomike.....                                                                   | 28        |
| b.         | Stabiliteti Makroekonomik .....                                                                     | 29        |
| c.         | Bashkëveprimi i Forcave të Tregut .....                                                             | 31        |
| d.         | Hyrja dhe Dalja në Treg .....                                                                       | 31        |
| e.         | Sistemi Ligjor.....                                                                                 | 31        |
| f.         | Zhvillimi i Sektorit Financiar.....                                                                 | 32        |
| 2.2.2      | <i>Kapaciteti për t'u përballë me presionin konkurrent dhe forcat tregtare të Bashkimit .....</i>   | <i>32</i> |
| a.         | Kapitali Njerëzor dhe Fizik .....                                                                   | 32        |
| b.         | Struktura e Sektorit dhe Ndërmarrjeve .....                                                         | 33        |
| c.         | Ndikimi i Qeverisë mbi Konkurrencën .....                                                           | 34        |
| d.         | Integrimi Ekonomik me BE-në .....                                                                   | 35        |
| <b>2.3</b> | <b>STANDARDET EVROPIANE .....</b>                                                                   | <b>35</b> |
| 2.3.1      | <i>Tregu i Brendshëm .....</i>                                                                      | <i>35</i> |
| a.         | Lëvizja e Lirë e Mallrave .....                                                                     | 35        |
| b.         | Lëvizja e Lirë e Kapitalit.....                                                                     | 36        |
| c.         | Dogana dhe Tatimet .....                                                                            | 38        |
| d.         | Prokurimi Publik .....                                                                              | 41        |
| e.         | Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale .....                                                           | 41        |
| f.         | Punësimi dhe Politikat Sociale.....                                                                 | 42        |
| g.         | Arsimi dhe Hulumtimi .....                                                                          | 50        |
| 2.3.2      | <i>Politikat Sektoriale.....</i>                                                                    | <i>51</i> |
| a.         | Industria dhe NVM-të .....                                                                          | 51        |

|          |    |                                                                             |            |
|----------|----|-----------------------------------------------------------------------------|------------|
|          | b. | Bujqësia dhe Peshkataria.....                                               | 52         |
|          | c. | Mjedisi.....                                                                | 54         |
|          | d. | Politikat e Transportit.....                                                | 55         |
|          | e. | Energjia .....                                                              | 60         |
|          | f. | Shoqëria Informative dhe Mediat.....                                        | 64         |
|          | g. | Kontrolli Financiar .....                                                   | 64         |
|          | h. | Statistikat.....                                                            | 67         |
| 2.3.3    |    | <i>Drejtësia, Liria dhe Siguria .....</i>                                   | 68         |
|          | a. | Vizat, Kontrollimi i Kufijve, Azili dhe Migrimi.....                        | 69         |
|          | b. | Shpërlarja e Parave.....                                                    | 70         |
|          | c. | Luftimi i Krimit të Organizuar.....                                         | 70         |
|          | d. | Drogat.....                                                                 | 71         |
|          | e. | Policia.....                                                                | 71         |
|          | f. | Mbrojtja e të Dhënave Personale .....                                       | 72         |
| <b>3</b> |    | <b>REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KAPACITETET ADMINISTRATIVE .....</b> | <b>73</b>  |
|          | a. | Sfondi.....                                                                 | 73         |
|          | b. | Institucionet Përgjegjëse dhe Gjendja Aktuale.....                          | 73         |
|          | c. | Çka duhet bërë...? .....                                                    | 73         |
| <b>4</b> |    | <b>PËRKTHIMI I ACQUIS TË BE-SË.....</b>                                     | <b>74</b>  |
|          | a. | Sfondi.....                                                                 | 74         |
|          | b. | Institucioni Përgjegjës dhe Gjendja Aktuale .....                           | 74         |
|          | c. | Çka duhet bërë...? .....                                                    | 74         |
| <b>5</b> |    | <b>INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI.....</b>                                        | <b>75</b>  |
|          | a. | Sfondi.....                                                                 | 75         |
|          | b. | Institucionet e Përgjegjëse dhe Gjendja Aktuale .....                       | 75         |
|          | c. | Çka duhet bërë...? .....                                                    | 76         |
| <b>6</b> |    | <b>2008 SHTOJCAT: TABELAT .....</b>                                         | <b>77</b>  |
|          | a. | Tabela e Shpenzimeve të PVPE-së.....                                        | 77         |
|          | b. | Tabela e Legjislacionit të Ri .....                                         | 78         |
|          | c. | Tabela e Ndryshimeve Institucionale .....                                   | 89         |
|          | d. | Tabela e Rekrutimeve të Reja.....                                           | 95         |
|          | e. | Tabela e Nevojave Trajnimit .....                                           | 99         |
|          | f. | Tabela e Nevojave të TIK.....                                               | 109        |
|          | g. | Tabela e Investimeve Kapitale.....                                          | 113        |
|          | h. | Tabela e Projekteve për Donator .....                                       | 115        |
| <b>7</b> |    | <b>TABELA E VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN .....</b>       | <b>122</b> |

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

|        |                                                                |
|--------|----------------------------------------------------------------|
| AAKK   | Agjencia Anti-Korrupsion e Kosovës                             |
| AAP    | Arsimi dhe Aftësimi Profesional                                |
| ABGj   | Agjencia për Barazi Gjinore                                    |
| ABK    | Asociacioni i Bizneseve të Kosovës                             |
| AER    | Agjencia Evropiane për Rindërtim                               |
| AETR   | Transporti Rrugor Ndërkombëtar                                 |
| AIE    | Agjencia për Integritet Evropiane                              |
| AKB    | Aleanca Kosovare e Bizneseve                                   |
| AKK    | Agjencia Kadastrale e Kosovës                                  |
| AKM    | Agjencia Kosovare e Mirëbesimit                                |
| AKP    | Agjencia Kosovare e Pronës                                     |
| AKPI   | Agjencia Kosovare për Promovimin e Investimeve                 |
| AKPM   | Agjencia e Kosovës për Produkte Mjekësore                      |
| AKRB   | Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve                 |
| AM     | Afatmesëm                                                      |
| ANP    | Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës                            |
| APK    | Agjencia Pyjore e Kosovës                                      |
| AQBK   | Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës                            |
| ARrK   | Autoriteti Rregullativ i Kosovës                               |
| ARrT   | Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit                    |
| ASh    | Afatshkurtër                                                   |
| ASSME  | Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme  |
| ATK    | Administrata Tatimore e Kosovës                                |
| AVUK   | Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës                |
| BB     | Banka Botërore                                                 |
| BE     | Bashkimi Evropian                                              |
| BKK    | Buxheti i Konsoliduar i Kosovës                                |
| CARO   | Agjencia Rregullative e Aviacionit Civil                       |
| CEEPUS | Programi Shkëmbyes i Evropës Qendrore për Studime Universitare |
| CHUIA  | Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditime të Brendshme       |
| CITT   | Qendra për Inovacion dhe Transferim të Teknologjisë            |
| CPC    | Certifikata e Aftësisë Profesionale                            |
| DASHC  | Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil                |
| DD     | Departamenti i Drejtësisë                                      |
| DFID   | Departamenti Britanik për Zhvillim Ndërkombëtar                |
| DGSA   | Këshilltari për Siguri të Mallrave të Rrezikshme               |
| DKA    | Drejtoria Komunale e Arsimit                                   |
| DKMA   | Departamenti për Kufij, Migrim dhe Azil                        |
| DPEF   | Departamenti për Politika Ekonomike dhe Fiskale                |
| DPS    | Departamenti për Politika Sociale                              |
| DZhAPU | Departamenti për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar         |
| EA     | Korporata Evropiane për Akreditim                              |
| EChSE  | Karta Evropiane për Ndërmarrje të Vogla                        |
| ECT    | Traktati i Kartës së Energjisë                                 |
| EJL    | Evropa Juglindore                                              |
| ESK    | Enti Statistikor i Kosovës                                     |
| ESTAP  | Projekti i Asistencës Teknike për Sektorin e Energjisë         |
| EULEX  | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë    |
| EUPT   | Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian                         |
| FMN    | Fondi Monetar Ndërkombëtar                                     |
| GMF    | Fondi Marshall Gjerman                                         |
| GP     | Grupi i Punës                                                  |

|        |                                                                             |
|--------|-----------------------------------------------------------------------------|
| GTZ    | Agjencia Gjermane e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit                            |
| HAÇP   | Programi i Analizës së Rrezikut dhe Pikave Kritike të Kontrollit            |
| IBK    | Instituti Bujqësor i Kosovës                                                |
| IÇK    | Indeksi i çmimeve të Konsumit                                               |
| IGjK   | Instituti Gjyqësor i Kosovës                                                |
| IGS    | Iniciativa e Gruas për Siguri                                               |
| IKAP   | Instituti Kosovar i Administratës Publike                                   |
| IKShP  | Instituti Kosovar i Shëndetit Publik                                        |
| IMMK   | Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës                            |
| IPVQ   | Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse                                  |
| IRU    | Unioni Ndërkombëtar i Rugëve                                                |
| IShK   | Inspektorati Shëndetësor i Kosovës                                          |
| ISK    | Inspektorati Sanitar i Kosovës                                              |
| ISO    | Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit                                   |
| KAMB   | Korniza Afatmesme Buxhetore (e shpenzimeve)                                 |
| KE     | Komisioni Evropian                                                          |
| KEC    | Qendra e Arsimit të Kosovës                                                 |
| KEK    | Korporata Energjetike e Kosovës                                             |
| KELP   | Komisioni për Emërime të Larta Publike                                      |
| KFOR   | Forca e Kosovës                                                             |
| KGjK   | Këshilli Gjyqësor i Kosovës                                                 |
| KiE    | Këshilli i Evropës                                                          |
| KIR    | Komisioni për Implementimin e Rindërtimit                                   |
| KNJ    | Komisioni për Ndihmë Juridike                                               |
| KOSTT  | Operatori i Tregut dhe Sistemit të Bartjes së Energjisë Elektrike në Kosovë |
| KPK    | Këshilli i Prokurimit të Kosovës                                            |
| KPK    | Komisioni Prokurorial i Kosovës                                             |
| KPMM   | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale                                |
| KQZ    | Komisioni Qendror Zgjedhor                                                  |
| KRrPP  | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik                                   |
| LBGj   | Ligji mbi Barazinë Gjinore                                                  |
| LFQ    | Pyetësi i Fuqisë Punëtore                                                   |
| LMFPP  | Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë               |
| MAPL   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                                |
| MASHT  | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë                              |
| MBPZhR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural                      |
| MD     | Ministria e Drejtësisë                                                      |
| MEF    | Ministria e Ekonomisë dhe Financave                                         |
| MEM    | Ministria e Energjisë dhe Minierave                                         |
| MKK    | Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve                                        |
| MKRS   | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve                                   |
| MMPH   | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor                             |
| MMRr   | Marrëveshja mbi Mallrat e Rrezikshme në Rugë                                |
| MPB    | Ministria e Punëve të Brendshme                                             |
| MPMS   | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale                                    |
| MSh    | Ministria e Shëndetësisë                                                    |
| MSHP   | Ministria e Shërbimeve Publike                                              |
| MTI    | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë                                         |
| MTPT   | Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit                         |
| NCSC   | Qendra Nacionale e Gjykatave Shtetërore                                     |
| NjDNj  | Njësia për të Drejtat e Njeriut                                             |
| NjQH   | Njësia Qendrore e Hetimeve                                                  |
| NOBPDP | Organi Nacional Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale             |
| NSh    | Ndërmarrjet Shoqërore                                                       |
| NVM    | Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme                                            |

|         |                                                                        |
|---------|------------------------------------------------------------------------|
| OEAK    | Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë                                      |
| OECD    | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim                       |
| OEK     | Oda Ekonomike e Kosovës                                                |
| OJQ     | Organizata Jo-Qeveritare                                               |
| ORCD    | Zyra për Bashkëpunim dhe Dialog Rajonal                                |
| OSBE    | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                        |
| OShP    | Organi Shqyrtues i Prokurimit                                          |
| PAI     | Public Administration International                                    |
| PIP     | Plani i Investimeve Publike                                            |
| PMP     | Praktika të Mira të Prodhimit                                          |
| PPP     | Partneriteti Publiko-Privat                                            |
| PSSP    | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm                      |
| PTK     | Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës                                  |
| PVKV    | Programi Vjetor Kosovar i Veprimt                                      |
| PVPE    | Plani i Veprimt për Partneritetin Evropian                             |
| PZhrB   | Plani Zhvillimor Rural dhe Bujqësor                                    |
| QIF     | Qendra e Inteligjencës Evropiane                                       |
| QKD     | Qendra për koordinim të donatorëve                                     |
| QKD     | Qendra për koordinim të donatorëve                                     |
| QKSPEZh | Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim               |
| QPS     | Qendrat për Punë Sociale                                               |
| RAP     | Reforma e Administratës Publike                                        |
| SEETO   | Observatori i Transportit për Evropën Juglindore                       |
| SHCK    | Shërbimi Civil i Kosovës                                               |
| SHDK    | Shërbimi Doganor i Kosovës                                             |
| SHKK    | Shërbimi Korrektues i Kosovës                                          |
| ShKS    | Shërbimi Kosovar i Sigurisë                                            |
| SHPK    | Shërbimi Policor i Kosovës                                             |
| SIDA    | Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar                             |
| SIGTAS  | Sistemi Standard i Integruar Qeveritar për Administrimin e Tatimeve    |
| SKQ     | Sekretariati Koordinues Qeveritar                                      |
| SNS     | Skema e Ndihmës Sociale                                                |
| TACTA   | Asistenca Teknike për Administratat Doganore dhe Tatimore              |
| TAIEX   | Shkëmbimi i Informatave mbi Asistencën Teknike                         |
| ThPNjK  | Themelimi i Pilot-Njësie Komunale                                      |
| TMK     | Trupat Mbrojtëse të Kosovës                                            |
| TVSH    | Tatimi në Vlerë të Shtuar                                              |
| UA      | Udhëzimi Administrativ                                                 |
| UITP    | Unioni Ndërkombëtar i Transportit Publik                               |
| UNDP    | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim                           |
| UNICEF  | Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë                   |
| UNMIK   | Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administratë në Kosovë |
| UP      | Universiteti i Prishtinës                                              |
| UrA     | Urdhëresa Administrative                                               |
| USAID   | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar             |
| VNM     | Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor                                          |
| ZAGJ    | Zyra e Auditorit Gjeneral                                              |
| ZCN     | Zyra Civile Ndërkombëtare                                              |
| ZKK     | Zyra Komunale për Komunitete                                           |
| ZKM     | Zyra e Kryeministrit                                                   |
| ZMAGZ   | Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare                |
| ZMF     | Zyra e Menaxhimit të Frekuencave                                       |
| ZP      | Zyra e Presidentit                                                     |
| ZPI     | Zyra e Pronësisë Intelektuale                                          |
| ZPS     | Zyra e Paktit të Stabilitetit                                          |

ZPSK  
ZQM  
ZRRÉ

Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës  
Zyra për Qeverisje të Mirë  
Zyra e Rregullatorit të Energjisë

# 1 HYRJJE

## 1.1 Raportet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian

Qysh prej Samitit të Selanikut më 2003, **Kosova është fuqimisht e përfshirë** në kornizën e Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit. Më 20 prill 2005, Komisioni Evropian miratoi Komunikatën për Kosovën **‘E ardhmja evropiane për Kosovën’**, gjë që përforcon përkushtimin e Komisionit për Kosovën. Për më shumë, më 20 janar 2006, Këshilli miratoi **Partneritetin Evropian** (edhe për Kosovën).

Në janar të vitit 2005, Qeveria e Kosovës miratoi **Planin e Parë të Veprimit** për implementimin e Partneritetit Evropian. **"Mekanizmi Përcjellës i SA "(MPSA)** është baza për dialogun e rregullt mes BE-së dhe autoriteteve kosovare mbi çështjet e BE-së. Përveç kësaj, u themelua një strukturë e re e **“Grupeve Punuese”** sektoriale nën ombrellën e MPSA-së në fushat e qeverisjes së mirë, ekonomisë, tregut të brendshëm, inovacionit, infrastrukturës dhe bujqësisë, në vitin 2007.

Bashkimi Evropian siguron **ndihmë të konsiderueshme financiare** për ndërtimin dhe përmirësimin e institucioneve të Kosovës, nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik si dhe avancimin e mëtutjeshëm të integritetit rajonal të Kosovës. BE-ja është **donatori më i madh i Kosovës**, i cili ndan më shumë resurse për kokë banori në Kosovë sesa në secilin vend të botës.

Instrumenti kryesor i asistencës së donatorëve më 1999-2006 ishte Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim **(CARDS)**. Më 2007, programi CARDS u zëvendësua me **Instrumentin e Para-Asocimit (IPA)**. Kosova do të përfitojë nga IPA dy komponentë: **Komponenti I** – Mbështetja për Ndërtimin dhe Tranzicionin e Institucioneve dhe **Komponenti II** – Bashkëpunimi Ndërkufitar. Për periudhën 2007-2009 Komisioni Evropian ka paraparë të mbështesë Kosovën me 199.1 milionë €. **Prioritetet kryesore të programeve të IPA-s 2007-2009** janë përfundimi i kapaciteteve administrative në të gjitha nivelet, avancimi i sundimit të ligjit, të drejtave njerëzore dhe qeverisjes së mirë, përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike të të gjitha komuniteteve, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit rajonal.

Ende nuk ekzistojnë **marrëdhënie kontraktuale** mes BE-së dhe Kosovës.

**Më 17 shkurt, Kuvendi i Kosovës miratoi Deklaratën e Pavarësisë**, duke hapur kështu një faqe të re në historinë e Kosovës dhe qytetarët e saj, si dhe **të ardhmen e re evropiane** për Kosovën dhe gjithë rajonin. Procesi i njohjes së Kosovës si shtet i pavarur është në vazhdim e sipër. Kosova është duke zbatuar një agjendë gjithëpërfshirëse dhe komplekse, ku procesi i Integritetit Evropian po bëhet **motori kryesor udhëheqës dhe udhëzues për të gjitha proceset/reformat progresive**.

**Hapi/sfida e radhës për Kosovën** në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian është të hyjë në fazën e ardhshme të procesit, **në hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit**, në përputhje me procedurën e rregullt. Sa më shpejt që Kosova të tregojë fakte të qarta të **zbatimit të plotë të rekomandimeve të Partneritetit Evropian**, e sidomos implementim të parëzervë të **Prioriteteve Kryesore dhe atyre Afatshkurtra**, aq më herët do të hapet dera për Kosovën që të tregojë përkushtimin e saj të plotë për procesin e integritetit evropian dhe të hyjë në fazat e ardhshme:

- **Vendimi i Këshillit** për t'i dhënë mandatin Komisionit Evropian për të përgatitur **Studimin e Gatishmërisë për fillimin e Negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim me Kosovën**,

- Komisioni Evropian përgatit dhe paraqet **përfundimet e Gatishmërisë për hapjen e Negociatave për MSA** me Qeverinë e Kosovës,
- **Vendimi i Këshillit për Hapjen e Negociatave për MSA** me Qeverinë e Kosovës dhe KE-së për përgatitjen e qëndrimeve në Negociata,
- **Hapja Zyrtare e Negociatave për MSA,**
- **Negociatat** për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale përmes MSA-së,
- Dhe më vonë **Aplikacioni për Anëtarësim,**
- Përgjigjet në **Pyetësorë,**
- **Statusi i Kandidatit** dhe fillimi i përgatitjeve për fazën përfundimtare,
- **Hapja e negociatave për Anëtarësim,**
- **Përfundimi i Negociatave,**
- **Nënshkrimi i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe kalimi në procedurën e ratifikimit, dhe ndoshta edhe përmes Referendumit për Anëtarësim.**

## 1.2 Punët Fillestare Përgatitore në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE 2008)

**Disa faktorë të rëndësishëm janë marrë parasysh në përgatitjen e Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian 2008:**

- **Pavarësia e Kosovës** dhe finalizimi e zbatimi i **Kushtetutës së re të Kosovës,**
- **Struktura e re institucionale evropiane** e vendosur në Kosovë (**ZCN, EULEX, ZPN**)
- Ndikimi i **Raportit të fundit të Progresit** (Nëntor 2007) nga Komisioni Evropian mbi arritjet dhe dobësitë e Kosovës,
- Ndikimi i **Partneritetit të ri të rishikuar evropian** për Kosovën për periudhën 2008-2009 si dhe perspektiva afatmesme për 36-48 muajt e ardhshëm,
- Nevojat në lidhje me rishqyrtimin e prioritetëve në lidhje me shfrytëzimin e **Ndihmës së Donatorëve** në përputhje me rekomandimet e Partneritetit Evropian dhe qasjen e strukturuar me ndarje të qartë mes AIE-së dhe QKD,
- Pjesëmarrja në zbatimin e **Planit të Veprimit dhe Strategjisë** për trajnime dhe Strategji dhe Planit të Veprimit për Informim dhe Komunikim.

**Për më shumë, puna e institucioneve të Kosovës do të udhëzohet në të gjitha fushat e rëndësishme nga disa dokumente zyrtare të përgatitura dhe miratuara nga Qeveria në periudhën e kaluar:**

- **Programi i Qeverisë për periudhën 2008-2011,**
- **Plani për Integrim Evropian të Kosovës 2008-2010,** miratuar nga Qeveria më **3 prill 2008,** duke përfshirë:
  - o **Mekanizmin e rishqyrtuar Koordinues për Menaxhimin e procesit të integritimit evropian,**
  - o **Koncept-dokumentet për Përafrimin e Legjislacionit dhe Përkthimin e Acquis të BE-së,**
  - o **Plani i ri/rishqyrtuar i Veprimit për Partneritetin Evropian 2008,**
  - o **Strategjia dhe Plani i Veprimit për Trajnime Evropiane,**
  - o **Strategjia dhe Plani i Veprimit për Komunikim në IE.**
- **Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2008.**

### 1.3 Synimet e Planit Kosovar të Veprimit për Partneritet Evropian

Secili **zhvillim (përparim) i mëtutjeshëm i Kosovës** do të matet në bazë të zbatimit të prioritetëve kryesore, afatshkurtra dhe afatmesme të **Partneritetit Evropian**.

**Në këtë kuptim, Plani i Veprimit duhet të përdoret për planifikimin e veprimitarisë së Qeverisë,**

- Në lidhje me **agjendën politike** të Qeverisë dhe prioritetëve të saj,
- **Agjendën legislative** të Qeverisë (ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe akte tjera ligjore) si dhe Parlamentit,
- **Planin e punësimit** të nevojshëm për zbatimin e agjendës së integriteteve evropiane dhe zbatimin e akteve të harmonizuara ligjore,
- **Planin për ndërtimin institucional** dhe trajnimin e personelit (nevojat për trajnime të përgjithshme dhe specifike),
- Planin për **investime** e sidomos për ndërtimin (avancimin) e **rrjetit të TI** në lidhje me Acquis.

**Tutje, Plani i Veprimit mund/duhet të shfrytëzohet në komunikimin e brendshëm,**

- Në harmonizimin e raporteve mes **Kryeministrit dhe bashkësisë ndërkombëtare** (bazë e qartë për t'u fokusuar në çështjet kryesore dhe më të rëndësishme),
- **Kryeministrit dhe anëtarëve të qeverisë** (mirëkuptimi i përbashkët i agjendës qeveritare dhe rezultateve që duhen arritur),
- **Ministrat dhe stafin e tyre** (udhëzime të qarta me caqe të matshme),
- Marrëdhëniet **mes organeve qeveritare** (një plan dhe të njëjtat afate),
- **Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve socialë** (mekanizëm paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe do të prekin komunitetin afarist dhe partnerët socialë),
- Marrëdhëniet me **sektorin e OJQ-ve** (baza për ndërtimin e partneritetit)
- Komunikimin me **media** (agjendë e qartë e qeverisë që mund të matet edhe nga mediat)
- Si dhe me publikun e gjerë, **gjithë qytetarët**, (qytetarët që duan mund të masin në çdo kohë se sa e suksesshme ka qenë Qeveria)

**... si dhe për komunikim të jashtëm,**

- Komunikim me **bashkësinë ndërkombëtare** dhe për kuptim më të mirë të prioritetëve të Kosovës (prioritete dhe agjendë qeveritare të qartë dhe të paraqitur publikisht)
- Marrëdhëniet me **Komisionin Evropian** dhe shërbimet e tij (gjithmonë e nevojshme për qëllime të monitorimit dhe paraqitjes së pasqyrës së qartë për përparimin e arritur)
- Me të gjitha **shtetet anëtare të BE-së** (të mos harrohet që të gjitha vendimet e rëndësishme merren nga ato)
- Me **fqinjët e Kosovës** (të gjithë në rajon janë dhe do të ndjekin shumë afërsisht atë që Kosova bën, planifikon dhe arrin)
- Me **sektorin akademik dhe joqeveritar evropian** dhe publikun e gjerë (Kosova ka nevojë për gjithë mbështetjen që mund ta marrë nga një mjedis sa më i gjerë që është e mundur).

## 1.4 Përmbajtja e Planit të Veprimit

Programi ndjek strukturën e **Partneritetit Evropian për Kosovën 2007** si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit, duke përfshirë kështu këto pjesë:

- Kriteret politike
- Kriteret ekonomike,
- Standardet evropiane
- Reformat e administratës publike dhe kapacitetet administrative,
- Përkthimi i Acquis në gjuhët zyrtare të Kosovës
- Informatat dhe komunikimet
- Shtojcat, si dhe
- Monitorimi dhe raportimi në bazë të PVPE-së dhe Revizionit të Programit.

Përmbajtja dhe struktura e pjesës mbi **Kriteret Politike** – është paraqitur në renditjen si në vijim:

- **Kushtet ekzistuese** (aktet ligjore që definojnë fushën, nivelin e përafrimit të legjislacionit vendor me Acquis dhe politikat e Bashkimit Evropian, institucionet në krye të implementimit të legjislacionit dhe kapacitetit të tyre);
- **Reformat e planifikuara:**
  - **Korniza ligjore** (përshkruan cilat akte vendore ligjore duhen përafruar me ato të Bashkimit Evropian, cili institucion është në detyrën e përgatitjes së atyre akteve ligjore dhe afatin e propozuar për miratimin e tyre);
  - **Korniza institucionale** (përshkruan domosdoshmërinë për riorganizimin e institucioneve ekzistuese apo themelimin e institucioneve të reja, nevoja për mundësi të reja punësimi në institucione, nevojat për trajnime);
  - Shqyrtimi i **përforcimit profesional** të institucioneve,
  - **Ndihma e jashtme**

Aktivitetet janë ndarë në **prioritete afatshkurtra** (1-2 vite) dhe **prioritete afatmesme** (3-4 vjet apo më gjatë).

Përmbajtja dhe struktura e pjesës së dytë – **Kriteret ekonomike** – vlerësojnë të gjitha kriteret ekonomike, reformat e planifikuara ekonomike dhe dinamikën e tyre.

Përmbajtja dhe struktura e pjesës së tretë – **Standardet evropiane** janë të organizuara në pajtim me kapitujt e Partneritetit Evropian. Struktura e brendshme e secilit kapitull është identike me strukturën e elaboruar në pjesën e Kritereve Politike.

**Reformat e administratës publike dhe kapacitetet administrative**, ose aftësia për zbatimin e Acquis në pajtim me standardet apo praktikën më të mira në Shtetet Anëtare, përmban një pasqyrë të përgjithshme të reformës së administratës publike (përshkrimi i kornizës ligjore me shqyrtimin e akteve të reja ligjore si dhe një shqyrtim të politikave dhe strategjive për përmirësimin e kapaciteteve administrative);

Një pjesë e veçantë e Programit i kushtohet **procesit të përkthimit të Acquis Komunitare në gjuhët zyrtare të Kosovës**, ku është përshkruar zhvillimi i sistemit të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe ndërtimit të kapaciteteve dhe resurseve.

Së fundmi, por me mjaft rëndësi, është edhe pjesa që përshkruan aktivitetet e Qeverisë së Kosovës në lidhje me implementimin e **Strategjisë për informim dhe komunikim** mbi procesin e integrimi

evropiane, duke synuar grupet kryesore të publikut brenda dhe jashtë Kosovës, metodat dhe mënyrat e qasjes së politikanëve, vendim-marrësve, administratës, studentëve, gazetarëve si dhe publikut më të gjerë të mundshëm si konsumues të informatave.

## 1.5 Shtojcat/Llojet e Aktiviteteve

Shtojcat përmbajnë të dhënat e pranuar nga institucionet kompetente gjatë përgatitjes së Planit dhe reflektojnë nivelin aktual të njohurisë së administratës dhe shkallës së kuptimit të procesit kompleks të integritetit evropian dhe Acquis Communautaire si dhe pasojat e tyre ligjore. Lëvizjet pozitive janë evidente kur krahasohen Planet e mëparshme të Veprimit të përgatitura nga e njëjta administratë në Kosovë.

### a. Tabela e Shpenzimeve

Ky është viti i parë që Kosova ka kalkuluar dhe specifikuar edhe aspektin financiar të Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian. Procesi i hartimit të buxhetit është koordinuar dhe menaxhuar nga Agjencia për Integritet Evropian dhe ka përfshirë shumë institucione, agjenci e organe të Republikës së Kosovës. Vetë procesi ka kaluar nëpër disa faza: **Së pari**, ministritë gjegjëse dhe institucionet tjera kanë vendosur veprime të specifikuar dhe implikimet financiare të veprimeve të parashikuara. **Së dyti**, pasi AIE-ja pranoi kontributet e domosdoshme, krijoi një ekip të posaçëm veprimi, detyra kryesore e të cilit ishte analizimi i të dhënave financiare në PVPE. **Përfundimisht**, Matrica e PVPE-së iu dërgua Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, zyrtarët e të cilës bënë krahasimin e tërthortë të aspektit buxhetor të PVPE-së dhe përputhshmërisë së tij me dokumentet tjera financiare.

**Dhënat financiare të prezentuara në PVPE nuk janë finale për shkak se këto të dhënat do të kalojnë ndryshime dhe korrigjime në vazhdimësi duke i përcjellur ndryshimet e Buxhetit dhe KASH-it. Dy elemente të rëndësishme të cilat kanë ndikuar më tutje dinamiken e dhënave financiare në PVPE janë: konferenca e Donatorve, të rejat e të cilës do të inkorporohen në PVPE, si dhe, diskrepanca procedurale kohore të përgatitjes së PVPE-së dhe buxhetit dhe KASH-it.**

Identifikimi financiar i veprimeve në PVPE, bashkë me ndarjen e tij buxhetore, do të ofrojë shumë përparësi dhe dobi:

1. Do të ofrojë një **pasqyrë financiare** të qartë të PVPE-së dhe veprimeve të tij.
2. Do të ndihmojë në **procesin e planifikimit të ardhshëm** të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të tij.
3. Do të ndihmojë në planifikimin e ardhshëm dhe **alokimin e donacioneve**.
4. **Do t'i ofrojë qytetarëve**, publikut të gjerë dhe palëve të interesuara një **pasqyrë të qartë** mbi atë se sa dhe nga cilat resurse shpenzon Qeveria e Kosovës për procesin e integriteteve evropiane.
5. Së fundmi, ekziston një besim i fuqishëm dhe logjika ekonomike që me arritjen e identifikimit financiar të veprimeve, **do të sigurohet dhe kontribuohet në realizimin, monitorimin dhe kontrollimin** e veprimeve të parapara.

Aspekti financiar i PVPE-së është i formësuar në atë mënyrë që të ofrojë një pamje të qartë dhe një shpjegim të financimit të veprimeve të parapara. Struktura dhe shpërndarja e financimit në PVPE paraqitet përmes 4 kolonave të veçanta, mbi të cilat jepen këto shpjegime:

**Kostoja totale:** Në këtë kolonë shkruhet shuma financiare që definon shumën e plotë financiare të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të veprimit të parashikuar.

**Buxheti i Konsoliduar i Kosovës:** Në këtë kolonë shkruhet shuma financiare që definon shumën e plotë financiare e cila ndahet nga BKK-ja për veprimin e paraparë.

**Donacionet:** Në këtë kolonë shkruhet shuma financiare që definon shumën e plotë financiare e cila ofrohet nga donacionet e ndryshme për veprimin e paraparë.

**Mungesa:** Në këtë kolonë shkruhet shuma financiare që definon shumën e plotë financiare e cila mungon për të siguruar mbështetjen e plotë buxhetore për veprimin e paraparë.

## Statistikat Financiare për Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian 2008

|                                        |                      |                |
|----------------------------------------|----------------------|----------------|
| <b>Kostoja totale e PVPE-së</b>        | <b>€ 760,660,763</b> | <b>100.00%</b> |
| <b>Buxheti i Konsoliduar i Kosovës</b> | <b>€ 266,595,618</b> | <b>35.05%</b>  |
| <b>Donacionet</b>                      | <b>€ 148,700,479</b> | <b>19.55%</b>  |
| <b>Mungesa</b>                         | <b>€ 345,364,666</b> | <b>45.40%</b>  |

***Përqindja e veprimeve të PVPE-së me dhe pa buxhet të specifikuar (gjitha veprimet me dhe pa implikime financiare) në %,***

Numri i veprimeve me buxhet të specifikuar **(736)** / Gjithsej veprime të PVPE-së **(1502)** X 100 = **49%**. Kjo do të thotë që **49%** të veprimeve të PVPE-së **kanë** buxhet të specifikuar, që do të thotë se **51%** e veprimeve **nuk kanë** buxhet të specifikuar.

Numrat dhe dhënat e paraqitura në Tabelë kanë natyrë dinamike, pra mund të priten ndryshime. Arsyet pse disa veprime nuk janë kalkuluar janë si në vijim:

- Veprimet nuk kanë implikime financiare;
- Veprimet janë shumë të vështira apo të pamundura të llogariten;
- Implikimet financiare janë plotësisht të mbuluara nga donatorët, por të dhënat konkrete financiare nuk janë dhënë për arsye të ndryshme; dhe
- Veprimet buxhetet e të cilave janë mbuluar me shumën e veprimeve tjera. Kështu, për të mos dyfishuar të njëjtën shumë, kemi vënë komentin për t'iu referuar veprimet konkret për informata mbi aspektin financiar të veprimit të parashikuar.

### **b. Tabela e Legjislacionit të Ri për Harmonizim**

Kjo Tabelë ofron një pasqyrë të rregulloreve ligjore vendore që duhen harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe përmban ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe institucionin që është përgjegjës për përgatitjen e aktit, duke përfshirë institucionet tjera që marrin pjesë në përgatitjen e akteve ligjore.

Afati për miratimin e rregulloreve nga Qeveria e Republikës së Kosovës është dhënë, bashkë me afatin për miratim nga Kuvendi i Kosovës.

### **c. Tabela e Ndryshimeve Institucionale dhe Nevojave për Punësim**

Këto tabela ofrojnë një pasqyrë të ndryshimeve të nevojshme institucionale (themelimi i institucioneve të reja, riorganizimi i atyre ekzistuese, Departamente të reja, Njësi të reja), ose përforsim institucional i institucioneve (punësime të reja), të paraqitura në kapituj standardë evropianë dhe sipas viteve (kudo që është e mundur).

#### d. Tabela e Trajnimeve të Nevojshme

Kjo Tabelë përmban një pasqyrë të identifikimit preliminar të rregulloreve ligjore sipas kapitujve dhe institucioneve që kanë nevojë për kurse trajnimi, ekspertizë, studime dhe analiza, në pjesën për harmonizim të legjislacionit të BE-së si dhe pjesën për zbatimin e tij. Kjo Tabelë është baza fillestare për analiza të mëtutjeshme për hartimin e planeve dhe programeve precize të trajnimit.

#### e. Tabela e Nevojave për Sistemet e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK)

Kjo shtojcë ofron një pasqyrë të nevojave për sisteme të TIK-ut (harduer, softuer, rrjete, aplikacione programore dhe infrastrukturë TI) sipas kapitujve dhe institucioneve.

#### f. Tabela e Investimeve Kapitale

Kjo tabelë paraqet investimet kapitale (projektet infrastrukturore, ndërtimi i ndërtesave, blerja e ndërtesave, etj.) sipas projekteve, të ndara sipas strukturës së PVPE-së.

### 1.6 Monitorimi dhe Raportimi Sipas PVPE-së dhe Rishqyrtimit të Programit

Pas miratimit fillestar të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian nga Qeveria e Kosovës, ai **do t'i paraqitet për komentim** organeve kompetente të Komisionit Evropian. Komentet e pranuar duhen përfshirë në versionin përfundimtar të dokumentit i cili do të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajve qershor/korrik 2008.

**Monitorimi i Planit të Veprimit** do të jetë shumë striktë dhe rigjido,

- Secili veprim/zbatim/përparim duhet raportuar tek AIE-ja të njëjtin moment (automatikisht) ose së paku **dy herë në muaj** – rregullisht (edhe nëse nuk ka asnjë veprim), para vendosjes së plotë të Mekanizmit Përcjellës për Raportimin e Cilësisë (MIS).
- AIE-ja duhet të përgatisë **një herë në muaj** (në fillim deri në mes të muajit) një raport të shkurtër për Kryeministrin (dhe Qeverinë). Kjo duhet konsideruar si sistem i paralajmërimit të hershëm nëse implementimi po shkon mirë apo ka nevojë për intervenim nga ana e Kryeministrit.
- Raporti i shkurtër duhet të përgatitet nga AIE-ja **çdo tremujor** (në tabela) për Qeverinë (sa më i hollësishëm që është e mundur, duke u përqendruar në fushat problematike me rekomandime për qasjen ndaj tyre me përpjekje të shtuara) si dhe për Komisionin Evropian (dhe aktorë tjerë ndërkombëtarë) në mënyrë më të gjerë (jo aq të hollësishëm) të përqendruar rezultatet e arritura dhe duke theksuar fushat ku nevojitet ndihmë/intervenim më i madh nga ana e komunitetit ndërkombëtar.
- **Çdo gjashtë muaj** (në qershor dhe shtator për shkak të Raportit të Progresit nga KE), AIE-ja duhet të përgatisë, ndërsa Qeveria të shqyrtojë dhe miratojë, një Raport më të gjatë dhe më të hollësishëm (me përshkrime e bashkë me tabela të hollësishme) për Progresin në implementimin e rekomandimeve të Partneritetit Evropian.
- Mekanizmi monitorues dhe Raportet mund të jenë shumë të dobishme për të përgatitur më mirë të gjitha **takimet me Komisionin** si dhe aktorët tjerë ndërkombëtarë dhe për të shfaqur përparimin në arritjen e qëllimeve (në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt).

PVPE-ja do të shqyrtohet çdo vit, me qëllim të azhurnimit dhe avancimit të tij, në pajtim me Raportet Vjetore të Progresit të Kosovës nga Komisioni Evropian.

## 2 KOMPONENTI NARRATIV I PVPE-SË 2008

### 2.1 Kriteret Politike

#### 2.1.1 Demokracia dhe Sundimi i Ligjit

##### a. Kushtetuta

Procesi i përgatitjes së Kushtetutës së Kosovës është vazhduar përgjithësisht. Kushtetuta e Kosovës është miratuar nga Komisioni Kushtetues dhe është certifikuar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil në Kosovë. Parlamenti i Kosovës ka miratuar Kushtetutën në një seancë të veçantë më 9 prill dhe ajo do të hyjë në fuqi më 15 qershor 2008.

Kushtetuta e Kosovës konsiderohet të jetë një nga kushtetutat më të avancuara demokratike, e cila përfaton në kapitujt e saj të drejtat themelore dhe të drejtat e komuniteteve e anëtarëve të tyre. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga kapitujt që përfshijnë: Preambulën, Dispozitat Themelore, Të drejtat dhe liritë themelore, Të Drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Parlamenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Sistemi Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Marrëdhëniet Ekonomike, Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial, Sektori i Sigurisë, Institucionet e Pavarura, Dispozitat Përfundimtare, si dhe Dispozitat Kalimtare.

Komisioni Kushtetues ishte themeluar nga Presidenti i Kosovës në pajtim me rekomandimet e Raportit të të Dërguarit Special të OKB-së mbi Statusin e Ardhshëm të Kosovës, të dorëzuar tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, me mandatin e përpilimit të draftit të parë të Kushtetutës së Kosovës. Komisioni përfaqëson larminë e Kosovës dhe është përgjegjës për hartimin e Kushtetutës e cila përfaqëson interesat më të mira të gjithë njerëzve në Kosovë si dhe konsiderohet si një nga kushtetutat më të avancuara, me të gjitha vlerat demokratike. Komisioni Kushtetues më pastaj themeloi 10 nëngrupe punuese, me fokus në fushat e veçanta të Kushtetutës.

Gjatë fazës së dytë të debateve mbi Draft Kushtetutën e Kosovës të mbajtur më 25 shkurt në Prizren, Kapitulli mbi të Drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre ishte tema më e diskutuar. Aty u theksua rëndësia e themelimit të institucioneve transparente dhe të paanshme, si Ombudspersoni dhe Këshilli Konsultativ për Komunitete, si dhe përfaqësimi i anëtarëve të shoqatave të bashkësive pakicë në këto organe.

##### b. Parlamenti

Në procesin e përafrimit të Republikës së Kosovës me anëtarësimin në BE dhe përafrimin e legjislationit me *Acquis communautaire*, Parlamenti, në kapacitetin e tij si pushtet legjislativ, përfaqëson një faktor të rëndësishëm në përcaktimin e dinamikës së përmbushjes së standardeve të domosdoshme për hyrje në BE.

Rregullorja e Punës së Kuvendit e datës 20 maj 2005, e ndryshuar më 1 qershor 2006 përcakton hollësisht procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve dhe akteve tjera. Rregullorja e Punës gjithashtu përcakton instrumentet dhe procedurën përmes të cilës Kuvendi ushtron kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi veprimet e organeve të pushtetit ekzekutiv, si dhe çështjet tjera që dalin nga kompetencat e Kuvendit, siç janë emërimi dhe shkarkimi i Presidentit të Kosovës, miratimi i gjykatësve dhe prokurorëve, etj. Për të siguruar funksionimin efektiv të këtij rendi ligjor parashikohet fuqizimi i plotë i Rregullores së Punës së Kuvendit.

Koncentrimi i veprimtarisë së Kuvendit në Komisione siguron diskutime gjithëpërfshirëse eksperte në legjislaturë. Dy Komisione kryesore dhe disa funksionale shqyrtojnë mocionet për miratimin e ligjeve, drafteve dhe propozimeve, si dhe akteve tjera të përgjithshme të propozuara për miratim nga Kuvendi, si dhe çështjet tjera brenda fushëveprimit të Parlamentit. Komisionet sigurojnë përfaqësim të barabartë të anëtarëve të Kuvendit nga grupet parlamentare, si dhe të atyre deputetëve që nuk janë të organizuar nëpër grupe. Sipas Rregullores së Punës në fuqi, seancat plenare dhe seancat e komisioneve janë të hapura për publikun. Megjithatë, procesi i rishqyrtimit të transparencës së Kuvendit për të siguruar përgjegjshmërinë dhe hapjen e tij është në agjendë, duke vënë raportet tremujore mbi shpenzimet e Kuvendit dhe publikimit të konkludimeve nga takimet e Komisioneve Parlamentare.

Brenda kornizës së procesit të integriteteve evropiane, Kuvendi ka funksionin e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv, përmes raporteve tremujore mbi aktivitetet e ndërmarra brenda procesit të integriteteve evropiane që Qeveria i paraqet Kuvendit. Bashkërendimi mes këtyre dyjave do të përforcohet edhe më shumë duke vendosur persona kontakti dhe duke vendosur kontaktet e rregullta të Kryeministrit dhe Ministrave.

Me qëllim të ofrimit të mbështetjes aktive ndaj procesit të integriteteve evropiane të Republikës së Kosovës, në shkurt 2008, Kuvendi ka themeluar Komisionin për Integritete Evropiane (KIE), i cili ka mbajtur seanca të rregullta qysh prej themelimit të tij. KIE përbëhet nga përfaqësues të gjitha partive politike parlamentare, duke reflektuar strukturën e Kuvendit me qëllimin e sigurimit të mbështetjes së plotë mbi vendimet në lidhje me BE-në.

KIE është pararojë e respektimit të *Acquis* nga momenti i hyrjes së projekt-ligjeve në Kuvend. Komisioni diskuton çështjet në lidhje me:

- Përpunueshmërinë e propozimeve për miratimin e ligjeve, pra projekt-ligjeve me legjislacionin evropian;
- Monitorimi i procesit të harmonizimit të legjislacionit kosovar me *Acquis communautaire*;
- Shqyrtimi i projektligjeve të iniciuara për miratim nga Kuvendi në kuptimin e përafrimit të legjislacionit me *Acquis communautaire*;
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me institucionet e BE-së në kuptimin e integritetit dhe anëtarësisë në BE;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me shtetet anëtare të BE-së.

Kapaciteti administrativ i Kuvendit është adekuat për sfidat aktuale. Megjithatë, angazhimi i vazhdueshëm i personelit shtesë si dhe trajnimit të tij vazhdon të mbetet prioritet.

### c. Zgjedhjet

Sipas marrëveshjes së Paketës së Ahtisaarit, si dhe duke marrë parasysh statusin sovran të Republikës së Kosovës, Kuvendi ka marrë përsipër miratimin e legjislacionit plotësisht të ri mbi zgjedhjet, duke u bazuar në tri ligje bazë: Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjin mbi Komisionin Qendror Zgjedhor, thjesht sepse këto ligje janë tanimë në fuqi, si dhe sepse zgjedhjet e 17 tetorit janë organizuar në pajtim me këto ligje.

Në bazë të propozimit të Ahtisaarit mbi Zgjedhjet e Statusit, Republika e Kosovës parashikohet të mbajë zgjedhje nëntë muaj pas periudhës kalimtare, ndërsa zgjedhjet vijuese do të varen shumë nga pajtueshmëria mes partive politike në Kosovë.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/9, është përgjegjës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ-së është të rregullojë procesin zgjedhor përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore, si dhe të mbikëqyrë të gjitha aspektet e procesit për të siguruar që zgjedhjet të plotësojnë standardet ndërkombëtare. KQZ-ja mbetet i aftë të ndërmarrë aktivitetet e tij në

aspektin e organizimit të përgjithshëm të zgjedhjeve në Kosovë, duke u përqendruar në certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve në procesin e zgjedhjeve, akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje, emërimin dhe trajnimin e Këshillave të vendotimeve si dhe certifikimin e rezultateve. KQZ-ja është i përkushtuar të themelojë Këshillat e veta mbi buxhetin, prokurimin, personelin dhe procedurat zgjedhore, udhëzimet dhe procedurat administrative.

#### d. Qeveria

Qeveria e Republikës së Kosovës është organi kompetent për koordinimin e autoriteteve të administratës publike dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre. Qeveria dhe anëtarët e saj janë të përgjegjshëm për veprimet e tyre para Kuvendit.

Qeveria i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të menaxhimit dhe bashkërendimit të procesit të integritetit evropian. Bashkërendimi i çështjeve të BE-së zhvillohet me ndarjen e përgjegjësisë politike dhe administrative. Organi kryesor vendim-marrës – Kabineti i Ministrave, nën udhëheqjen e Kryeministrit, takohet një herë në muaj për të diskutuar çështjet evropiane. Agjencia për Integritet Evropian në Zyrën e Kryeministrit monitoron dhe zhvillon procesin me të cilin legjislacioni përafrohet me ligjin e BE-së. Personeli përgjegjës për implementimin dhe koordinimin e politikave të BE-së është emëruar dhe vepron në secilën ministri të linjës, në kontakt të ngushtë me Agjencinë për Integritet Evropian.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin për integritet evropian 2008-2010. Në bazë të këtij plani, Qeveria e Kosovës do të marrë vendim për emërimin e autoritetit përgjegjës që do të bëjë harmonizimin e gjitha akteve legjislative me Acquis. Avancimi i mëtutjeshëm i ministrive të linjës dhe ndërtimi i kapaciteteve do të jetë prioritet i këtij dokumenti.

#### e. Administrata Publike (AP)

Kosova seriozisht është duke punuar në përmirësimin e kapaciteteve të administratës së shtetit. Reformimi dhe avancimi i Administratës publike konsiderohet se është nevojë e domosdoshme për plotësimin e kërkesave aktuale dhe për më tepër për përmbushjen e obligimeve që kërkon krijimi dhe funksionimi i një shteti demokratik, që t'u shërbejë në mënyrë adekuate qytetarëve të saj, si dhe të jetë e aftë për të përmbushur obligimet e tashme dhe të ardhshme ndërkombëtare.

Reforma e Administratës Publike bazohet në tri dokumente strategjike:

1. Raporti për gjendjen e Administratës Publike në Kosovë,
2. Strategjia për Reformën e Administratës Publike në Kosovë si dhe
3. Plan i Veprimit të Reformës së Administratës Publike në Kosovë

Për të realizuar Reformën e Administratës Publike janë përcaktuar tetë objektiva strategjike:

1. Administratë Publike e depolitizuar dhe profesionale, e zhvilluar duke u bazuar në politika dhe në praktikat më të mira evropiane të menaxhimit të burimeve njerëzore;
2. Strukturë dhe organizim i efektshëm horizontal dhe vertikal i institucioneve të AP në pajtim me kompetencat e tyre;
3. Menaxhim cilësor, transparent, i efektshëm dhe i përgjegjshëm në vendosjen dhe realizimin e synimeve;
4. Komunikim efektiv i ndërsjellë me qytetarë, si pjesë përbërëse e procesit të hartimit të politikave dhe të ofrimit të shërbimeve;
5. E-qeverisje në funksion të avancimit të proceseve të punës brenda AP dhe të ofrimit të shërbimeve për qytetarë, institucioneve dhe bizneseve;

6. Sistem funksional, i efektshëm dhe transparent i planifikimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve të AP;
7. Sistem funksional për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe për rritjen e përgjegjshmërisë në AP;
8. Avancim i hartimit, harmonizimit e zbatimit të politikave dhe të legjislacionit në pajtim me standardet e BE-së, që parashikohet të arrihet përmes hartimit të planit nacional për përafrimin e legjislacionit me *Acquis communautaire*, standardizimin e formatit të hartimit legjislativ, zhvillimit të një programi gjithëpërfshirës për hartimin e politikave legjislative, funksionalizimi i mekanizmave për monitorimin e zbatimit të legjislacionit, si dhe planit të veprimit për eliminimin e kolizioneve ligjore, rrjedhimisht promovimi dhe përforcimi i zyrave ligjore në ministri e institucione është një nga prioritetet.

Për koordinimin e punës në zbatimin e planit të veprimit për RAP është themeluar Grupi Punues në bashkëpunim hierarkik me Nën-grupet Punuese, të cilat janë formuar në bazë të fushave si në vijim: 1. Burimet Njerëzore, Struktura Organizative e Institucioneve dhe Menaxhimi i Administratës Publike, 2. Komunikimi me qytetarë, 3. E-Qeverisja, 4. Financimi i Administratës Publike, 5. Kundërkorrupsioni dhe 6. Politikat dhe Legjislacioni.

Që nga fillimi i zbatimit të Planit të Veprimit të Reformës së Administratës Publike ka një sërë të arriturash si në vijim:

*Në fushën e burimeve njerëzore, strukturës organizative dhe menaxhimit të administratës publike të Planit të Veprimit për Reformën e Administratës Publike në Kosovë është duke u punuar intenzivisht në draftimin e Projekt-ligjit për Shërbimin Civil, Projekt-ligjit për Pagat dhe Projekt-ligjin për Qeverinë. Finalizimi dhe aprovimi i tyre pritet të bëhet në përputhje me afatet kohore të PVPE-së dhe Strategjisë Legjislative 2008. Në ndërkohë, Grupi punues ministror i MSHP-së ka filluar punën në hartimin e draftit fillestar për projekt-ligjin për Institutin e Kosovës për Administratën Publike (IKAP). Drafti është duke u debatuar në IKAP.*

Në përputhje me Rregulloren Nr 2008/12 mbi ndryshimin e Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, të datës 27 shkurt 2008, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës (BPM) është shndërruar në organ të pavarur që i raporton Parlamentit të Republikës së Kosovës. Aktualisht, Bordi financohet nga BKK dhe në përputhje me Nenet 7.3 dhe 7.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/12, Bordi ka linjën e vet buxhetore brenda BKK-së dhe ka të drejtë të kërkojë donacione në funksion të përmbushjes së përgjegjësisë të parapara me Ligj.

Buxheti aktual i BPM-së është €8500 të llogaritura vetëm për paga dhe shërbime, përderisa përlllogaritjet për shërbime operationale nuk janë përfshirë. Në këtë kontekst, Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Bordit dhe MSHP-së është nënshkruar, ku MSHP merr përgjegjësinë për caktimin €14.500 për Bordin për mbulimin e shpenzimeve operationale, por kjo shumë akoma nuk i është alokuar Bordit.

Gjatë kësaj periudhe, nga MSHP janë nxjerrë disa Udhëzime Administrative: UA nr. 01/2008-MSHP për kartelat identifikuese për zyrtarët e institucioneve të Republikës së Kosovës; UA nr. 02/2008-MSHP për regjistrimin e dhuratave në katalogun e dhuratave në institucionet e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës; UA nr. 03/2008 -MSHP për mbishkrime në ndërtesa të institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës; UA nr. 04/2008-MSHP për veshjen dhe paraqitjen e nëpunësve civilë; UA Nr. 05/2008-MSHP për forumin e menaxherëve të personelit; UA nr.01/2008 për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për zyrtarët e institucioneve të Qeverisë së Kosovës; UA nr.02/2008 për përcaktimin për një page të të emëruarve politikë; UA nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës; UA nr.04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e

Kosovës; UA nr.07/2008 për vula në institucionet e Qeverisë të Republikës së Kosovës. Për shkak se kanë munguar aktet për hartimin e procedurave disiplinore, është miratuar UA Nr. 11/2008 mbi zbatimin e procedurave për Funksionimin e KELP-it, ku janë përcaktuar rregullat praktike dhe procedurat (përfshirë ato disiplinore dhe për performancë të dobët) për funksionimin efektiv të Këshillit.

Në pajtim me mandatin e tij, IKAP-i vazhdon me trajnimin e gjithë shërbimit civil, pra komunave, agjencive dhe ministrive, me module trajnimi mbi të gjitha çështjet. IKAP-i ofron trajnime për hartimin e ligjeve, teknologji informative, administratë të përgjithshme, menaxhim të përgjithshëm, menaxhim të resurseve njerëzore dhe çështje të veçanta komunale. Për më shumë, programi trajnues afatmesëm për periudhën 2007-2009 është përgatitur, ndërsa paralelisht, hartimi i Udhëzimit Administrativ për politikat e trajnimit është në proces, bashkë me një strategji të veçantë për trajnimin e shërbyesve civilë që është në fazë përgatitore, ashtu siç është parashikuar me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike si një nga veprimet prioritare, hartimi i një strategjie për trajnimin e shërbyesve civilë.

Projekti për Rishikimin funksional horizontal dhe vertikal të institucioneve në nivel qendror ka filluar. Grupi i ekspertëve nga “Functional Review and Institutional Design of Ministries” (FRIDOM) ka hartuar Planin e Punës dhe termet e referencës, të cilat janë aprovuar nga Komisioni ndërmintor për Reformën e Administratës Publike, dhe të cilat janë miratuar nga Qeveria më 30. 05. 2008. Ky grup ka pasur disa prezantime në MSHP dhe në Komisionin ndër-ministral për RAP dhe në Bordin e Sekretarëve të Përhershëm të ministrive, në lidhje me projektin. Rishikimi i tërë Qeverisë është në proces ku janë duke u rishikuar funksionet dhe organizimi i të gjitha institucioneve qeveritare (ministritë dhe agjencitë qeveritare duke përfshirë edhe zyrën e Kryeministrit). Ka përfunduar faza e parë e mbledhjes së të dhënave në vendet evropiane, të cilat janë zgjedhur si shembuj dhe po përpunohen, duke i krahasuar më të dhënat e mbledhura për Kosovën. Ka filluar pilot rishikimi i MSHP-së. Fillimisht është duke u bërë rishikimi i përgjegjësiave dhe funksioneve të MSHP dhe agjencive të saj përfshirë rishikimin krahasues me shtatë vende Evropiane (Lituania, Letonia, Estonia, Irlanda, Sllovenia, Finlanda dhe Sllovakia). Po ashtu ka filluar rishikimi i disa funksioneve horizontale që hyjnë nën portofolin e MSHP-së ku janë mbajtur edhe një varg takimesh me zyrtarë të ndryshëm për marrjen e informatave me anë të intervistave.

*Për sa i përket komunikimit me qytetarë*, pikat kontaktuese janë themeluar (zyrtarë për komunikim me publikun) për njësitet buxhetore, që do jenë përgjegjës për komunikim me publikun dhe versioni i parë i strategjisë për komunikim me qytetarët tashmë ka filluar të draftohet. Që të ketë një bazë për komunikim me qytetar është hartuar rregullorja për veprimtarinë e shërbimit të përhershëm të komunikimit në Qeverinë e Kosovës dhe në paketë me datën 16 nëntor 2007 kabineti qeveritar ka miratuar rregulloren dhe Kodin e Mirësjelljes. Institucionet vazhdimisht i mirëmbajnë dhe azhurnojnë web-faqet e tyre. Janë dhënë rekomandimet e duhura në këtë drejtim. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i faqeve zyrtare është një segment në konsolidim e sipër, që pak a shumë, mbetet të mbikëqyret dhe të hulumtohen vështirësitë eventuale, ndërsa aty ku vërehet çalimi do të rekomandohen hapat e mëtejshëm. Grupi hulumtues do të themelohet së shpejti.

Në funksion të avancimit të Administratës Publike të Kosovës dhe për ofrimin sa më eficient të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, në kuadër të **e-Qeverisjes** MSHP-ja ka iniciuar draftimin e Strategjisë për e-Qeverisje 2009-2015. Hartimi i kësaj strategjie ka filluar në prill 2008, ndërkohë që draftimi i Ligjit për Agjencinë qeveritare që ka të bëjë me çështjet e qeverisjes elektronike dhe të teknologjisë së informacionit është në fazën përfundimtare. Një grup ministral ka finalizuar draftin fillestar të projekt-ligjit për Agjencinë e Shoqërisë Informative.

Janë identifikuar shërbimet qeveritare të cilat mund të ofrohen për qytetarë dhe për biznese nëpërmjet internetit. Për disa nga këto shërbime ka filluar edhe zhvillimi i aplikacioneve në bazë të projekteve të hartuara nga DTI/MSHP. Nga shërbimet qeveritare të cilat ofrohen për qytetarë dhe biznese nëpërmjet internetit deri me tani janë vetëm ato të karakterit informativ dhe ato që ofrohen në formën e të dhënave të publikuara në ueb-faqet e institucioneve përkatëse.

Lidhur me organizimin e trajnimeve të vazhdueshme të personelit deri me tani gjatë vitit 2007 dhe 2008 janë organizuar trajnime për punonjës të AP dhe zyrtarë të TIK-ut nga MSHP dhe institucione të tjera qeveritare, të cilat trajnime kanë qenë të ndara në disa cikle. Trajnimet janë zhvilluar në Slloveni dhe Prishtinë në bashkëpunim me Qendrën për Perspektivë Evropiane (CEP) me qendër në Lubjanë të Sllovenisë, dhe në Estoni në bashkëpunim me Akademinë për e-qeverisje (EGA) me qendër në Talin të Estonisë.

*Përkitazi me **financimin e administratës publike***, janë miratuar nga Kuvendi, Ligji për Menaxhimin e Financave publike dhe Ligji për Financat e Administratës Lokale. Njësitë Qendror për Harmonizimin e Rishikimit të Brendshëm ka filluar monitorimin e implementimit të rekomandimeve të organeve rishikuese. Me vendim nr. 05/6 të datës 07.02.2008 në Qeverinë e Kosovës është aprovuar dhe është në zbatim e sipër Strategjia Legjislative për vitin 2008. Sistemi informativ për menaxhimin e financave të Kosovës (SIMFK), shfrytëzohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore (OB). OB i regjistrojnë të gjitha transaksionet e tyre financiare në SIMFK sipas planit kontabël të Qeverisë së Kosovës. Më tutje këto të dhëna barazohen me ekstrakte bankare dhe librin e përgjithshëm në SIMFK. Kjo ka mundësuar që raportimet nga Thesari të përpilohen në kohë sipas të dhënave të Librit të përgjithshëm që të janë të konsoliduara për të gjitha OB-të.

*Në fushën **kundër korrupsion***, është hartuar Udhëzimi Administrativ nr. 02/2005 për të drejtat dhe detyrat e të emëruarve politik dhe Kodi i Mirësjelljes së tyre, i cili ka për qëllim përcaktimin e rolit dhe funksioneve të stafit politik. Po ashtu në vitin 2006, është aprovuar nga Qeveria Kodi i Mirësjelljes për nëpunësit civil, i cili është tërësia e parimeve dhe normave, mbi bazën e të cilave duhet të veprojnë të gjithë nëpunësit civilë. Të gjithë nëpunësit civilë pajisen me kontratat e punës si dhe zbatimi i këtyre kontratave bëhet në mënyrë rigoroze. Në kuadër të promovimit të transparencës së administratës publike, behet zbatimi i Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare që d.m.th që të gjithë qytetarët kanë qasje në dokumentet që me ligj nuk janë konfidenciale. Nga Agjencia Kundër-Korrupsion (AKK) është kërkuar deklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë të Institucioneve dhe shumica prej tyre iu kanë përgjigjur kësaj kërkesë, ndërsa AKK i ka publikuar emrat në mediat e shkruara dhe elektronike të atyre zyrtarëve që nuk kanë bërë deklarimin e pasurisë. Tashmë AKK-ja e ka të hapur linjën telefonike ku të gjithë qytetarët mund të denoncojnë aktet e korrupsionit të personave zyrtarë.

*Në fushën e **politikave dhe legjislacionit***, është hartuar drafti i parë i koncept dokumentit për organizimin e këshillit të ekspertëve në shkallë vendi për politika dhe legjislacion. Është bërë avancimi i zyrave ligjore të ministrive të linjës në departamente ligjore. Në mbledhjen e datës më 17.10.2007 sipas vendimit nr.04/276 Qeveria e Kosovës ka miratuar UA për veprimtarinë e shërbimeve ligjore në degën e ekzekutivit i paraparë si aktivitet. Është hartuar drafti i parë i Udhëzimit administrativ për standardizimin e formatit të hartimit të legjislacionit. Është propozuar që Departamentet Ligjore të Ministrive të Linjës të bëjnë transpozimin e akteve të BE-së qysh në fazën fillestare të draftimit të projektligjeve si dhe ato të jenë përgjegjëse për lëshimin e Deklaratës fillestare të Pajtueshmërisë dhe Tabelës së Pajtueshmërisë. Ndërkaq Zyra për Ndihmë dhe Shërbime Juridike (ZNSHJ)/ZKM propozohet të jetë përgjegjëse për verifikimin e pajtueshmërisë së legjislacionit me BE duke bërë verifikimin e tabelës së pajtueshmërisë. Me vendimin e Qeverisë nr. 06/6 datës 07.02.2008 është themeluar grupi punues për eliminimin Kolizionit Ligjor dhe njësimin e legjislacionit në fuqi. Komisioni për eliminimin ligjor në planin e veprimit ka parapare afatet e organizimit të tryezave të

rrumbullakëta për identifikimin dhe më pas eliminimin e kolizionit ligjor nga fushat përkatëse dhe tryeza e parë nga fusha e financave publike do të mbahet me datën 29.05.2008. Ka filluar puna në analizimin e legjislacionit në fuqi dhe me datën 29.05.2008 do të mbahet tryeza e parë nga fusha e financave publike për analizimin e legjislacionit nga kjo fushë. Me Vendimin e Qeverisë nr. 07/06, 07.02/2008 është themeluar Komisioni për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve. Janë caktuar pikat e kontaktit nga secili institucion për bashkëpunim me mekanizmat mbikëqyrës të zbatimit të ligjeve.

#### f. Vetë-Qeverisja Lokale/Decentralizimi

Qeverisja lokale në Kosovë administrohet në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme që rregullojnë përgjegjësitë e autoriteteve lokale dhe qendrore. Baza ligjore për pushtetin lokal është Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2007/30 mbi vetë-qeverisjen komunale në Kosovë, duke zëvendësuar Rregulloren Nr. 2000/45. Në pajtim me Kartën Evropiane për Vetë-Qeverisjen Lokale përmes Rregullores 2007/30, parashihen një numër përgjegjësish në menaxhim dhe rregullativë. Konkretisht, synimet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë: rritja e kapaciteteve fiskale, konsolidimi i kornizës afatmesme dhe strategjia për zhvillimin e qeverisjes lokale, rritja e kapaciteteve komunale përmes koordinimit të ndihmës së donatorëve si dhe përmes definimit të kompetencave për shërbime publike komunale.

Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së tashme të Kosovës është reforma e vetë-qeverisjes lokale. Në këtë aspekt, hartimi dhe miratimi i një serie ligjesh, si Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, Ligji mbi Kufijtë Komunalë, Ligji mbi Financat Lokale si dhe Ligji mbi Qytetin e Prishtinës, është sfida më madhore për momentin. Paralelisht, implementimi i Pilot-Njësive Komunale me përforcimin e kapaciteteve njerëzore, administrative dhe teknike, si dhe transferimi i kompetencave tek Pilot-Njësitë Komunale, janë procese në vazhdim e sipër.

Plani i Veprimit për Decentralizim ka parashikuar Këshillin Ndërkomunal me kompetenca në themelimin e grupeve punuese sektoriale me përgjegjësi të qarta që do të merren me reforma legjislative, financa lokale dhe institucionet komunale, duke marrë parasysh tri ligjet bazë që do të miratohen për të rregulluar përgjegjësitë në nivelin lokal, politikat fiskale dhe institucionet e reja komunale, sipas propozimit të Ahtisaarit. Në drejtimin e themelimit të komunave të reja, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 14 milionë euro sipas parashikimit të Paketës së Ahtisaarit.

#### g. Sistemi Gjyqësor

Sistemi i gjykatave të rregullta të Kosovës përbëhet nga 24 gjykata komunale dhe 2 degë të gjykatave komunale, 5 gjykata qarku, Gjykata Komeriale e Kosovës, si dhe Gjykata Supreme.

Sistemi i gjykatave për kundërvajtje përfshin 25 gjykata komunale për kundërvajtje, si dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje. Sipas statistikave të 2007-ës nga KGjK, gjyqësori ka pasur 322 pozita gjykatësish me 301 gjykatës në shërbim, duke përfshirë 13 në Gjykatën Supreme, 4 në Gjykatën Komeriale, 5 në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje, 49 gjyqtarë në gjykatat e qarkut, 141 në gjykatat komunale, si dhe 89 gjyqtarë në gjykatat për kundërvajtje.

Gjykatat komunale janë gjykata që zgjidhin lëndë në shkallën e parë. Kompetencat e gjykatave komunale në zgjidhjen e lëndëve janë të parapara me ligj. Gjykatat komunale përgjithësisht gjykojnë me panele prej 1 profesionisti dhe 2 gjykatësve laikë. Veprat penale që dënohen me gjobë apo me burgim më pak se 3 vjet merren parasysh nga një gjyqtar i vetëm.

Gjykatat e qarkut janë të vendosura në secilin prej kryeqyteteve rajonale (Prishtina, Gjiłani, Peja, Prizreni dhe Mitrovica). Ato zgjidhin ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale. Ato gjithashtu

shërbejnë si gjykata të shkallës së parë për vepra penale të dënueshme me burgim me më shumë se 5 vjet, konteste madhore pronësore, konteste në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale, si dhe çështje tjera të shumta. Panelet e shkallës së parë përgjithësisht përbëhen nga një gjyqtar profesional dhe 2 laikë. Panelet prej 2 profesionistëve dhe 3 laikëve zgjidhin rastet që dënohen me burgim me më shumë se 15 vjet, si dhe apelet nga gjykatat komunale.

Gjykata Komeriale është e vendosur në Prishtinë, dhe ka juridiksion mbi gjithë Kosovën për shkallën e parë të kontesteve mes subjekteve afariste private, procedurat e bankrotimit, si dhe disa vepra penale komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës është organi më i lartë në sistemin e gjykatave të rregullta. Ajo funksionon si gjykatë apeli e shkallës së tretë në një numër të caktuar rastesh penale: zgjidh ankesat kundër vendimeve nga gjykatat e qarkut prej ankesave të gjykatave komunale. Ajo gjithashtu zgjidh ankesat direkte në rastet që dalin nga gjykatat e qarkut, si dhe shërben si gjykatë e shkallës së parë për çështje të jashtëzakonshme dhe çështje tjera sipas ligjit (p.sh. konteste administrative). Më herët është themeluar një Odë e Posaçme e cila përbëhet nga 2 gjykatës vendorë si dhe tre gjyqtarë ndërkombëtarë, për të zgjidhur ankesat ndaj vendimeve të privatizimit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit..

Me qëllim të shpejtimit të procedurave gjyqësore, si veprim më urgjent është paraparë rritja graduale e gjyqtarëve (deri në 70) si dhe punësimi i personelit shtesë administrativ në gjykata për të zvogëluar rastet e mbetura dhe vonesën e lëndëve.

Me qëllim të modernizimit të procedurave gjyqësore, planifikohet të implementohet një sistem i automatizuar i menaxhimit të rasteve në gjykata deri në fund të vitit 2008. Mbështetja shtesë për shfrytëzuesit e softuerit do të ofrohet, bashkë me rritjen e personelit të TI.

Procesi i reformës gjyqësore në bazë të Planit Strategjik të Ministrisë së Drejtësisë 2006-2011 si dhe Planit të Veprimit, por edhe me Planin Strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Gjyqësorin e Kosovës 2007-2012, sapo është nisur. Reforma përmban disa qëllime thelbësore strategjike, si themelimi i një kornize të fuqishme ligjore dhe administrative për organizimin dhe funksionimin e gjykatave, zhvillimin dhe implementimin e procedurave efektive për emërimin, zhvillimin, ngritjen në detyrë dhe disiplinimin e gjyqtarëve, duke vendosur procedura efektive dhe praktika për menaxhimin buxhetor dhe financiar në dhe për gjykatat, eliminimin e rasteve të mbetura në gjykata, implementimin e sistemeve moderne të komunikimit dhe menaxhimit të informatave në gjykata, etj., për të krijuar një gjyqësor efikas dhe modern.

Hapi qenësor për vendosjen e sistemit stabil dhe të qëndrueshëm gjyqësor do të merret me përpjekjet për hartimin e Ligjit mbi Gjykatat, ku do të përcaktohen atributet kryesore të sistemit gjyqësor. Vendimi mbi sistemin e gjykatave administrative ka rëndësi të veçantë, pasi që funksionimi i një qeverisjeje efikase do të varet shumë nga ai. Me këtë ligj do të përcaktohen edhe rregullat mbi emërimin dhe ri-emërimin e gjyqtarëve. Për më shumë, parashihet edhe legjislacion specifik mbi emërimin, vlerësimin dhe ngritjen e tyre në detyrë.

Veprimet parashohin plotësimin e mëtutjeshëm të kornizës legjislative mbi gjyqësorin – Ligji mbi Prokurorinë, Ligji mbi Ndërmjetësimin, Ligjin mbi mjekësinë ligjore, miratimi i të cilave parashihet në vitin 2008.

Sa i përket trajnimeve të gjyqtarëve – Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK), do të vazhdojë të implementojë sistemin e trajnimit fillestar, trajnimet e avancuara dhe trajnimet për jurinë dhe personelin profesional të gjykatave dhe prokurorive.

IGJK do të transformohet në një shkollë studimesh post-diplomike për profesionistët. Trajnimet e tij mbulojnë një gamë temash, duke përfshirë kodin drejtësinë dhe procedurat penale, zbatimin e vendimeve, etikën gjyqësore dhe trajnimet mbi të drejtat e pronësisë intelektuale.

#### h. Politika Anti-Korrupsion

Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar të luftojë korrupsionin me mekanizmat tashmë të vendosur. Qeveria e Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë dhe përforcojë partneritetin me shoqërinë civile dhe mediat me synim të përforcimit të rolit të tyre në zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e reformave për luftimin e korrupsionit, si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare në Kosovë.

Agjencia Anti-Korrupsion i ka paraqitur raportin e saj të parë vjetor Kryetarit të Kuvendit të Kosovës më 3 mars 2008. AAK-ja vazhdimisht ndërmerr hetime administrative në rastet e pohuara për korrupsion dhe i procedon rastet e kompletuara tek prokuroritë, duke bërë zbulimin dhe kontrollimin e pronave të zyrtarëve të lartë publikë në institucionet publike, duke ndërmarrë masa në parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe monitorimin e rasteve të pranimit të dhuratave nga zyrtarët publikë në pajtim me Ligjin Anti-Korrupsion nr. 2004/34.

AAK-ja ka iniciuar procesin e ndryshimit të legjislacionit aktual me synim të qartësimit të mëtutjeshëm të kornizës aktuale ligjore mbi anti-korrupsionin, duke ofruar kështu projektligje të reja në fushën e kontrollimit të pronësisë dhe konfliktit të interesave. Projektligji i ri mbi deklarin e pasurive rrit afatin për paraqitjen e deklaratës në fillim të mandatit në dy muaj, si dhe vendos dy kërkesa tjera: deklarin me kërkesë të Agjencisë si dhe deklarin në fund të mandatit publik (brenda 30 ditësh pas përfundimit). Për më shumë, do të vendosen edhe disa masa sanksionimi në projektligjin e ri mbi deklarin e pasurisë, ndërsa këto sanksione mund të aplikohen direkt nga Agjencia tek zyrtarët publikë që refuzojnë të deklarojnë pasuritë e tyre.

Projektligji mbi parandalimin e konfliktit të interesave zbaton standardet ndërkombëtare dhe paraqet një pjesë shumë të hollësishme legislative, me dispozita të qarta për mandatin dhe pas periudhës së emërimit. Projektligjit gjithashtu ofron mundësinë e zyrtarit publik që të kërkojë këshillim tek menaxhmenti i lartë apo Agjencia në rast se ai/ajo nuk është i/e sigurt nëse gjendja konkrete kualifikohet si konflikt interesash apo jo.

Përveç atyre që janë implementuar deri tani, Republika e Kosovës vazhdon, me intensitet të njëjtë, luftën e saj kundër korrupsionit. Me përfundimin e Planit të Veprimit Anti-Korrupsion, AAK-ja është aktualisht në fazën e hartimit të një Strategjie dhe Plani Veprimi që do t'i dorëzohet për miratim Qeverisë dhe Parlamentit në fund të vitit 2008. Plani i ri i Veprimit Anti-Korrupsion do të përfshijë planet sektoriale për luftimin e korrupsionit brenda administratës publike dhe shoqërisë civile.

Për shkak të definimit të paqartë të përgjegjësisë mes AAK-së dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM)/ZKM, do të nënshkruhet një Memorandum Mirëkuptimi mes dy palëve, për ta definuar AAK-në si institucion përgjegjës për luftimin e korrupsionit në nivelin nacional, derisa ZQM-ja do të hartojë politikën në nivelin qeveritar.

Buxheti i Agjencisë Anti-Korrupsion për 2008 është rritur, derisa buxheti i vitit 2008 është 456,400 Euro, në krahasim me 300,000 Euro për vitin 2007. Për më shumë, Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës janë zotuar të ndajnë burime të mjaftueshme financiare për sigurimin e funksionimit efikas dhe të pavarur të AAK-së.

### 2.1.2 Të Drejtat Njerëzore dhe Mbrojtja e Pakicave

Të drejtat dhe liritë themelore njerëzore dhe qytetare që janë të njohura me të drejtën ndërkombëtare janë direkt të zbatueshme në Kosovë, dhe pas deklarimit të pavarësisë, nënshkrimi i këtyre ligjeve është një nga prioritetet më të larta për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës është në procesin e themelimit të Komisionit Parlamentar për të drejtat njerëzore, barazinë gjinore, personat e zhdukur dhe peticionet, me qëllim të monitorimit të përputhshmërisë së projektligjeve për miratim me legjislacionin evropian në lidhje me fushën e të drejtave të njeriut.

Zyra e Qeverisjes së Mirë është aktualisht në fazën e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut, duke synuar që ta prezantojë në Konferencën e Donatorëve për financim të mundshëm si të tillë.

Aktualisht, posti i Ombudspersonit është duke u ushtruar nga ish-Zëvendës-Ombudspersoni, i cili është Ushtrues Detyre, pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka emëruar Ombudspersonin e ri. Më 21 shkurt, Kryesia e Kuvendit të Kosovës vendosi të rishpallë konkursin për këtë pozitë. Amendamentet në Ligjin mbi Avokatin e Popullit janë vendosur në agjendën Legjislative për 2008, ndërsa periudha e prituri e miratimit nga Parlamenti është fundi i vitit 2008. Amendamentet do të avancojnë më tutje pozitën e Ombudspersonit në kuptimin e pjesëmarrjes në të gjitha seancat e gjykatës dhe monitorimit të procedurave të gjykatës në rastet e mundshme të shkeljes së legjislacionit për të drejtat e njeriut.

#### a. Të Drejtat Civile dhe Politike

Sistemi i burgjeve në Kosovë në përgjithësi është në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, vendimi për ndërtimin e një burgu të ri të sigurisë së lartë dhe standardeve të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut është në proces. Sa i përket Burgut të Dubravës, do të bëhen një numër përmirësimesh: instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë dhe sistemit kundër stuhive dhe përmirësimi i mundësive të punësimit gjatë periudhës së burgimit. Implementimi i Kodit të Mirësjelljes nga personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe raportimi mbi ankesat e të burgosurve është hap i rëndësishëm i përcaktuar me këtë dokument për të garantuar mirëqenien e të burgosurve dhe të drejtave të tyre me standarde ndërkombëtare. Programet speciale të ri-integritimit, sidomos në bujqësi, në burgjet e Dubravës dhe Lipjanit do të zhvillohen në periudhën afatshkurtë.

Liria e shprehjes është e garantuar me ligj në Kosovë. Komisioni i Pavarur i Mediave të Kosovës do të rrisë kapacitetet njerëzore me synim implementimin e legjislacionit sekondar të lëshuar nga Komisioni i Mediave.

#### b. Të Drejtat Ekonomike dhe Sociale

Mbrojtja e të drejtave të grave në Kosovë dhe barazia gjinore ka marrë konturë institucionale me implementimin e Ligjit mbi Barazinë Gjinore, edhe pse programi për barazinë gjinore dhe adaptimi i mëtutjeshëm i legjislacionit me gjendjen aktuale kanë nevojë për harmonizim. Në këtë kuptim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka definuar politikat e saj për të përmirësuar fushën e barazisë gjinore, përmes ndërtimit të mekanizmave për implementim dhe politikave të monitorimit dhe masave afirmative për çështjet gjinore në fushën e arsimit, shëndetësisë, mediave, ndërmarrësisë dhe kujdesit

shëndetësor. Përkushtimi i Qeverisë për pjesëmarrje të rritur në mjediset menaxhuese dhe vendim-marrëse ka rëndësi esenciale.

Përpjekjet në kuptimin e miratimit dhe zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë në proces e sipër me themelimin e një Grupi Ndërmnistror të Punës për identifikimin dhe implementimin e legjislacionit të duhur për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe për të iniciuar Kornizën Strategjike për të Drejtat e Fëmijëve.

Vëmendje e veçantë në PVPE-në 2008 i kushtohet përmirësimit të pozitës së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Themelimi i një grupi punues ndërmnistror është paraparë në vitin 2008 si mekanizëm institucional që do të iniciojë procesin e hartimit të strategjisë nacionale për persona me aftësi të kufizuara. Për më tepër, funksionalizimi i Këshillit Nacional për Persona me Aftësi të Kufizuara, duke përfshirë miratimin e Planit të tij të Punës 2008-2009 do të vazhdojë deri në fund të vitit 2008. Një raport i përgjithshëm mbi rrethanat aktuale për persona me aftësi të kufizuara do të përgatitet për t'u përdorur si kornizë themelore për hartimin e politikave të ardhshme në këtë fushë.

Ligji Anti-diskriminim do të monitorohet, ndërsa në afatin e shkurtër, Qeveria e Kosovës do të bëjë hulumtime për implementimin e Ligjit kundër Diskriminimit nga zyrtarët në administratë publike në nivelin qendror dhe hulumtimin mbi përcëptimin e qytetarëve mbi diskriminimin dhe zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit, si dhe do t'i publikojë këto hulumtime pas kryerjes së tyre.

Funksionalizimi i plotë i Njësitë për të Drejtat e Njeriut në ministritë e linjës, në bazë të Udhëzimit Administrativ 2007/04 mbetet sfida për Qeverinë që do të trajtohet me këtë dokument në periudhë afatshkurtër. Për të avancuar bashkëpunimin dhe implementimin e rekomandimeve të Ombudspersonit, do të mbahen takime të rregullta mujore mes ZQM/ZKM dhe Ombudspersonit.

#### c. Të Drejtat e Pakicave, të Drejtat Kulturore dhe Mbrojtja e Pakicave

Të drejtat e pakicave në Kosovë kryesisht janë të rregulluara me ligj. Një hap i madh është bërë me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës më 9 prill, ku nenet 57, 58, 59, 60, 61 dhe 62 të Kushtetutës rregullojnë të drejtat e komuniteteve, themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete, përfaqësim në institucione publike dhe institucionet vetë-qeverisëse.

Ligji mbi të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008. Ky Ligj gjithashtu ka parashikuar themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës, i cili do të ketë një rol të madh në organizimin dhe artikulimin e qëndrimeve të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet me rëndësi të veçantë për ta. Në bazë të Ligjit për të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim të afërt me Këshillin Konsultativ për Pakica do të përgatisë, miratojë dhe publikojë një herë në vit një strategji gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 korrik 2006, ndërsa është shpallur nga PSSP-ja më 20 tetor 2006. Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve është i zbatueshëm bashkë me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/51. Ai garanton të drejtën e barabartë të përdorimit të gjuhëve për të gjitha komunitetet në Kosovë dhe në gjitha institucionet qendrore të Kosovës, ndërsa me rëndësi shumë të madhe është përdorimi i barabartë i të gjitha gjuhëve në Kuvendin e Kosovës dhe Komisionet e tij. Në nivelin lokal, Ligji garanton që në të gjitha komunat ku komuniteti përfaqëson më shumë se 3% në atë komunë të caktuar, gjuha e caktuar e komunitetit do të përdoret me gjuhët tjera zyrtare. Sfida kryesore e Qeverisë së Kosovës është implementimi i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve në nivelin qendror dhe atë lokal. Në këtë kuptim, monitorimi i implementimit do të ndërmerret nga

MSHP-ja dhe MAPL-ja në dy nivelet, ndërsa raportet e përmuajshme me rekomandime për shërbimet e përkthimit në gjuhët zyrtare do t'i paraqiten Komisionit të Gjuhëve për shqyrtim.

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar të përmirësojë kushtet e jetesës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) deri në fund të 2008-ës, finalizimi i Strategjisë për RAE është i parashikuar, bashkë me implementimin e projektit për zhvillimin e komunitetit RAE. Këto veprime synojnë të përmirësojnë kushtet dhe ri-integrojnë komunitetin RAE në Kosovë.

Ligji për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 9 tetor 2006 dhe është shpallur nga PSSP-ja më 6 nëntor 2006. Në fazën aktuale, Ministria e Kulturës është në procesin e hartimit të legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit mbi Trashëgiminë Kulturore, duke udhëhequr drejt një reforme të institucioneve të trashëgimisë kulturore në bazë të Ligjit të ri, si dhe fillimi i një politike të integruar të trashëgimisë kulturore në nivelin nacional.

Ligji për Themelimin e Zonave Speciale të Mbrojtura është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe pret shpalljen nga PSSP-ja. Ky ligj për ligj mbrojtjen e kishave dhe manastireve të Kishës Ortodokse Serbe dhe zonat historike të rëndësisë së veçantë për Komunitetin serb në Kosovë dhe komunitetet tjera, përmes krijimit të zonave të mbrojtjes së veçantë.

### 2.1.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Përfshirja e Kosovës në çështjet rajonale në pjesën më të madhe të kohës ka marrë formën e pjesëmarrjes në një numër të caktuar iniciativash të bashkëpunimit rajonal. Kështu, e nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës, Marrëveshja Rajonale për Tëgti të Lirë (CEFTA) u ratifikua nga Kuvendi. Për më shumë, Republika e Kosovës në mënyrë aktive ka qenë e përfshirë në tranzicionin e Paktit të Stabilitetit në një kornizë bashkëpunimi rajonal. Në përputhje me këtë, Kosova ka marrë pjesë në takimin e fundit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-lindore (SEECP) në Sofje. Për më shumë, Kosova merr pjesë edhe në Observatorin e Transportit të Evropës Jug-lindore (SEETOEJL), Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), si dhe vazhdon të zbatojë dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Partneriteti Evropian kërkon që aktivitetet të zhvillohen në përforsimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, pjesëmarrje aktive në iniciativa rajonale si dhe bashkëpunim të ngushtë rajonal në fushën e zbatimit të ligjit.

Ky Plan trajton përforsimin e bashkëpunimit rajonal përmes parashikimit të ndryshimeve institucionale, si në rastin e strukturave të reja që duhen formuar për bashkëpunim ndërkufitar, nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fusha të ndryshme, si me Shqipërinë, Turqinë, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi, si dhe zgjidhjen e çështjeve të mbetura siç është rasti me demarkimin e kufirit me IRJM-në. Kërkesat për pjesëmarrje aktive në iniciativat rajonale trajtohen me aktivitete që parashikojnë vazhdimësinë e angazhimit në anën e Institucioneve Kosovare. Për më shumë, parashikohen ndryshime legjislative dhe institucionale kur vjen tek zbatimi i CEFTA-s. Përforsimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit rajonal në fushën e zbatimit të ligjit parashikohet me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë.

Një nga sfidat madhore në përgatitjen e kësaj pjese të Planit ka qenë mungesa e rregullimit lokal institucional për t'u marrë me këto çështje. Megjithatë, zgjidhja e statusit politik, angazhimi i vazhdueshëm nga ana e Qeverisë së Kosovës për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe kalimi i kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës pritet të mundësojë në një shkallë

më të madhe implementimin e aktiviteteve në lidhje me çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare, siç është paraparë me këtë plan.

## 2.2 KRITERET EKONOMIKE

Bashkë me implementimin e aktiviteteve për të siguruar një kornizë solide ligjore dhe institucionale dhe funksionim efektiv të shtetit të sapondërtuar, Qeveria është gjithashtu e përkushtuar të zbatojë aktivitete që do të mundësojnë zbatimin e prioritetëve afatshkurte dhe afatmesme ekonomike. Kapitulli i PVPE-së mbi Kriteret Ekonomike përfshin aktivitete që synojnë arritjen e stabilitetit makroekonomik, si dhe zhvillimin e ekonomisë së Kosovës për të krijuar kushte për zhvillimin e afarizmit, gjë që do të sigurojë në anën tjetër rritjen graduale të prodhimtarisë. Ekziston një pajtueshmëri e gjerë mes partive politike dhe faktorëve tjerë në sferën politike të Kosovës kur vjen tek a) integrimi në strukturat euro-atlantike; b) implementimi i decentralizimit në bazë të Planit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së, Marti Ahtisaari; c) intensifikimi i zhvillimit ekonomik, zvogëlimi i papunësisë dhe varfërisë; d) implementimi i reformave gjyqësore që ndihmojnë mjedisin afarist dhe luftojnë krimin, ekonominë e hirtë dhe kontrabandën; si dhe e) intensifikimin e skemave rajonale të bashkëpunimit ekonomik.

### 2.2.1 Ekzistimi i Ekonomisë Funksionale të Tregut

Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut arrihet kur ka një shkallë pajtueshmërie mbi themelet e shtetit, politikën ekonomike, kur baraspesha e tregut arrihet nga konkurrenca e lirë e forcave të tregut, kur sektori privat mbështetet nga një treg financiar i zhvilluar, si dhe kur qeveria ndërton kapacitetet e domosdoshme për të korrigjuar dështimet e caktuara të tregut, pra duke mbështetur bizneset me ndërtimin e një kornize të fuqishme rregullative të hyrjes dhe daljes nga tregu.

#### a. Thelbi i Politikës Ekonomike

Informatat më të reja mbi aktivitetet vjetore ekonomike tregojnë për një dinamikë më të shpejtë të rritjes në krahasim me atë të vitit 2006. Kjo rritje është mbështetur nga përmirësimet e kërkesës vendore dhe asaj të jashtme. Ekziston një deficit i lartë i ekonomisë, edhe pse ekonomia është ende në procesin e zhvillimit të shpejtë, me investime dhe eksporte në shpejtim, gjë që në anën tjetër kërkojnë rritje tjera në importe.

Gjatë vitit 2007, Kosova përjetoi një rritje të BPV-së prej rreth 5.0%. Kontributi më i madh në këtë rritje është dhënë nga eksportet, gjë që në anën tjetër ka përmirësuar balansin tregtar dhe llogaritë rrjedhëse. Investimet kanë qenë një faktor tjetër që kanë dhënë një kontribut të madh në rritjen reale të BPV-së më 2007, ndërsa importet, pas rritjes së madhe të eksporteve dhe investimeve, paksa ngadalësojnë kontributin pozitiv në rritjen reale të BPV-së. Megjithatë, më 2008, rritja është projektuar të jetë rreth 6.0%, e udhëhequr kryesisht nga përmirësimi i eksporteve neto dhe rritjes së investimeve.

Sa i përket zhvillimeve të çmimeve, sipas Entit Statistikor të Kosovës, inflacioni mesatar nga viti në vit ka arritur në 4.3%, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe naftës gjatë gjysmës së dytë të vitit. Në veçanti gjatë gjysmës së dytë të vitit, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit me 6.7% në krahasim me rritjen prej 0.6% në të njëjtën periudhë të vitit 2006. Rritja vjetore e IÇK-së, duke përfshirë çmimet e ushqimit dhe naftës, gjatë gjysmës së dytë të 2007-ës ishte 0.5% në krahasim me rënien prej 0.6% gjatë periudhës së njëjtë më 2006. Kjo tregon që pas rritjes së çmimeve të ushqimit dhe naftës, çmimet e mallrave tjera janë rritur pak.

Një burim i rëndësishëm i informatave të **tregut të punës** janë Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, duhet theksuar që të dhënat e regjistruara mbi punësimin nuk janë indikator i saktë i punësimit të përgjithshëm në Kosovë, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e punësimit bëhet jashtë këtyre premisave. Në anën tjetër, regjistrimi si i papunë për të marrë qasje ndaj skemave sociale është gjithashtu fenomen i njohur. Numri i punësimeve përmes këtyre zyrave është rritur në krahasim me 2006-ën. Kjo mund të jetë rezultat i punës më të mirë ekonomike dhe zhvillimit të sektorit privat pas privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike. Një numër i konsiderueshëm i punësimeve (32%) është absorbuar nga sektori i tregtisë, kryesisht për shkak të ringjalljes së ngadalshme të sektorit prodhues. Përveç kësaj, punësimet në sektorët e financave dhe arsimit janë duke treguar shenja përmirësimi. Ky trend tregon që pjesa më e madhe e rritjes së mundësive aktuale të punësimit është kryesisht e koncentruar në sektorin terciar, me disa shenja të përmirësimeve në sektorin sekondar, me favorizimin e më të arsimuarve. Femrat përbëjnë më shumë se 46% të papunësisë së regjistruar, edhe pse kjo mungesë është ngushtuar paksa në gjysmën e dytë të 2007-ës.

Sipas të dhënave të regjistruara mbi **papunësinë** numri kumulativ i të papunëve të regjistruar në fund të 2007-ës u ngrit në 334,595, gjë që në krahasim me vitin e kaluar është më i lartë. Kjo tregon që papunësia vazhdon të mbetet sfidë madhore edhe gjatë vitit 2008. Në kuptimin e strukturës së arsimit, shumica e personave të papunë të regjistruar i përkasin kategorisë së njerëzve të pakualifikuar, që përbëjnë rreth 60% të të papunëve. Këta pasohen nga shkollimi i mesëm (26%) dhe kategoria e kualifikuar, që përbën rreth 9%. Përmirësimet e mëtutjeshme në arsim janë të dëshirueshme pasi që ka një marrëdhënie direkte mes cilësisë së arsimit dhe mundësive të punësimit.

**Shërbimi financiar** i Kosovës është i vogël por po rritet shpejt në disa fusha. Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK) ka autoritetin për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare. Sektori financiar dominohet nga bankat komerciale, të cilat kanë qenë stabile, edhe pse ka nevojë për zgjerim të mëtutjeshëm të shërbimeve financiare, e sidomos furnizimin e ekonomisë me hua afatgjate me kosto më të ultë.

Shuma e **deficitit tregtar** të Kosovës në vitin 2007 arriti 1.4 miliardë euro, ose 40% të BPV-së. Kjo përqindje është më e lartë sesa mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore, si dhe tregon që ekonomia e Kosovës është e hapur dhe mirë e integruar në ekonominë globale. Importet e mallrave gjatë 2007-ës shkuan në 1.5 miliardë euro, një rritje prej 20.2% në krahasim me 2006-ën, derisa eksportet shkuan në 146 milionë euro, pra një rritje prej 31.9 % në krahasim me vitin e kaluar. Mbulimi i importeve me eksporte është përmirësuar në 9.7% në krahasim me 8.8% më 2006 dhe 5.1% më 2005.

#### b. Stabiliteti Makroekonomik

Përgjegjësia për **çështje ekonomike, financiare, fiskale dhe buxhetore** është e mveshur në institucionet e Kosovës. Menaxhimi i shpenzimeve publike është i rregulluar me Ligjin mbi Menaxhimin e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërinë 2003/2. Në mungesë të instrumenteve dhe politikave monetare, politika fiskale mbetet instrumenti kryesor makroekonomik përmes të cilit Qeveria e Kosovës ndikon në ekonomi. Kështu, kufizimi dhe përgjegjësia në dimensionin e politikës fiskale janë thelbësore për arritjen e synimeve qeveritare. Politika aktuale mbahet përmes kufijve mbi shpenzimet rrjedhëse dhe diversifikimin e resurseve drejt shpenzimit kapital. Sistemi tatimor është i bazuar në bazën uniforme dhe të gjerë tatimore, me shumë pak përjashtime. Shkallët tatimore janë përgjithësisht të ulta dhe mundohen të adresojnë çështjet e efikasitetit dhe t'i mundësojnë autoriteteve të gjenerojnë të hyra të mjaftueshme për financimin e shpenzimeve thelbësore pa iu kthyer huamarrjes. Të ardhurat buxhetore kanë treguar një rritje të konsiderueshme në tri vitet e fundit, derisa shpenzimet kanë mbetur relativisht konstante.

Korniza ligjore për menaxhimin e shpenzimeve publike është mjaft solide, por problemet shtrihen në implementimin e saj, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative dhe njohjes së legjislacionit të miratuar. Këto në shumë raste krijojnë probleme me ekzekutimin e buxhetit në gjysmën e parë të vitit. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh) dhe iniciativat e Programit të Investimeve Publike janë duke kontribuar në një menaxhim më transparent fiskal, edhe pse planifikimi strategjik dhe analiza e propozimeve të buxhetit mbeten të zhvillohen. Aktivitetet dhe reformat në lidhje me procesin e statusit janë projektuar të krijojnë presione mbi kufizimet fiskale dhe menaxhimin e buxhetit. Asistenca e jashtme ka qenë qenësore për përf forcimin e kapaciteteve ligjore dhe institucionale. Megjithatë, struktura institucionale dhe planifikimi i çintegruar i asistencës së donatorëve krijon probleme me transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin. Ekzistojnë plane për të riorganizuar strukturën institucionale qeveritare të koordinimit me donatorë, ku Zyra e Koordinimit të Donatorëve dhe Zyra e Koordinimit të Asistencës nga BE-ja brenda Agjencisë për Integritet Evropian do të bashkohen.

Qeveria është e përkushtuar të ushtrojë përmbajtje dhe përgjegjësi në çështjet fiskale. Ajo ka miratuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për 2008 sipas domosdoshmërisë së ndjekjes së politikave të shëndosha fiskale, sidomos duke theksuar nevojën për të siguruar që politikat sociale të jenë në përputhje me qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike.

Për të siguruar vazhdimësinë e vendimeve qeveritare, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh) do të shqyrtohet dhe azhurnohet për të qenë në gjendje të harmonizojë prioritetet, me qëllim të elaborimit të buxhetit të ndryshuar 2008 dhe projektbuxhetit të vitit 2009. Ligji mbi Menaxhimin e Financave publike do të ndryshohet për t'iu përshtatur dinamikës së reformave qeveritare dhe për të shmangur mospërputhjeve ligjore dhe institucionale. Një punë e rëndësishme parashikohet në kuptimin e vlerësimit të politikave fiskale dhe legjislacionit rrjedhës me synim të sigurimit të përputhshmërisë së tyre me *Acquis communautaire* si dhe për të krijuar një ambient më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, duke promovuar kështu zhvillimin e biznesit në Kosovë dhe për të rritur prodhimtarinë. Për arritjen e synimit të qeverisë dhe implementimit të prioritetit, masat për përf forcimin e kapaciteteve administrative në elaborimin e buxhetit dhe planifikimin strategjik janë të parapara në nivelet qeveritare dhe ato komunale.

Ndryshimet ligjore që synojnë përmirësimin e menaxhimit të financave publike në përputhje me praktikën më të mira dhe në përputhje me ato të BE-së janë tanimë të vendosura. Janë miratuar disa ligje dhe urdhëresa ekzekutive deri tani, ose janë në fazën përfundimtare të përgatitjes: i) Projektligji mbi Buxhetin 1 janar – 31 dhjetor 2008, ii) Projektligji mbi financat lokale; iii) Projektligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërisë; iv) Projektligji për ndryshimin e Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat; si dhe v) Projektligji mbi Huazimet Financiare.

Qeveria, përmes amendamenteve në buxhetin e vitit 2008, mori parasysh nevojën për investime kapitale në ekonominë e Kosovës. Një rritje cilësore e shpenzimeve është e paraparë, sidomos rritja e investimeve kapitale nga 155.3 milionë euro gjatë 2007-ës në 404.8 milionë euro më 2008. Korniza e shpenzimeve e Qeverisë për 2008 gjithashtu ka përligjur kërkesat dhe përgjegjësitë pas zhvillimeve të reja politike. Paketa e shpenzimeve të pas-statusit në pajtim me Planin e Ahtisaarit kërkon shpenzime të tjera për themelimin e strukturave të reja institucionale, kompetencat e reja, përfaqësimi diplomatik, forca e sigurisë, decentralizimi dhe borxhi i jashtëm. Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, është duke punuar për vlerësimin e shpenzimeve pas-statusore, të cilat priten të finalizohen shpejt. Në anën tjetër, Qeveria do të ndërmarrë hapa të tjerë në përgatitjen për anëtarësim dhe bashkërendim me institucionet financiare rajonale dhe ndërkombëtare.

c. Bashkëveprimi i Forcave të Tregut

Liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë (ekuilibri i kërkesës dhe ofertës) arrihet me ndërveprimin e lirë të forcave të tregut. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve përcaktohen lirisht sipas kushteve të tregut, ku monopolet veprojnë për shkak të mungesës së konkurrencës. Rregullatorët e pavarur janë themeluar me sukses dhe janë në fazën e konsolidimit. Sa i përket tregtisë, Kosova është e përkushtuar për liberalizim për shkak të ekonomisë së saj të vogël. Qeveria po ndërmerr hapa të tjerë në implementimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe fitimit të qasjes ndaj regjimeve tjera ndërkombëtare të tregtisë.

d. Hyrja dhe Dalja në Treg

Ekonomia e Kosovës karakterizohet me mungesë të barrierave të rëndësishme ndaj hyrjes në treg (themelimi i firmave të reja) dhe daljes (bankrotimet, likuidimet). Një qëllim i rëndësishëm i Qeverisë është përforcimi i mjedisit afarist për t'i mundësuar firmave kosovare të konkurrojnë në tregjet rajonale dhe globale. Mungesa e qartësisë së legjislacionit dhe kornizës rregullative ekzistuese, si dhe korrupsioni në sektorin publik konsiderohen disa nga pengesat kryesore në ekonominë në tranzicion, derisa Qeveria është zotuar të eliminojë këto mungesa dhe të ndërtojë një mjedis të shëndoshë biznesi. Rregulloret e mangëta në lidhje me fillimin e bizneseve dhe funksionimin e tyre janë përkthyer në stimuj të fuqishëm për të mbetur në ekonominë joformale dhe atraktivitetin e Kosovës për investime të huaja direkte. Pra, Qeveria është zotuar të eliminojë barrierat ndaj hyrjes dhe procedurave të bankrotimit dhe likuidimit të kompanive.

Sa i përket përmirësimit të mjedisit të biznesit dhe kapacitetit institucional për t'u përballur me nevojën për reforma, është arritur një përparim i konsiderueshëm në miratimin e praktikave më të mira të BE-së mbi Ligjet për Kompanitë dhe sistemin e regjistrimit të bizneseve. Këto reforma janë arsyeja kryesore e ndryshimit të numrit, strukturës si dhe rolit e pozitës së ndërmarrjeve në ekonomi. Kosova ka disa nga indikatorët më të mirë në rajon në lidhje me regjistrimin e bizneseve (1-3 ditë pune). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), me mbështetjen e komunitetit donator, vazhdimisht ka përmirësuar sistemin e saj elektronik të regjistrimeve. Faktet nga MTI-ja tregojnë që shumica e regjistrimeve janë bërë brenda një dite të vetme, me kohë të përgjithshme të regjistrimit 0.7 ditë. MTI-ja me sukses ka aplikuar një numër skemash si "One Stop Shop" për të mundësuar iniciativat e reja afariste.

Dalja nga tregu rregullohet me Ligjin e Bankrotimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2007. Legjislacioni përafron direktivat e BE-së për procedura të forta të daljes dhe likuidimit. Harmonizimi i procedurës së bankrotimit, shpejtimi, lirimi, efikasiteti në kosto dhe drejtësia e saj për kreditorët dhe palët e përfshira, si dhe ndërtimi i organeve efikase të monitorimit dhe implementimit, janë disa nga synimet kryesore të Qeverisë.

Qeveria është gjithashtu duke shqyrtuar politikat e saj fiskale dhe tatimore për të siguruar një sistem më stabil, atraktiv dhe efikas të qeverisjes.

e. Sistemi Ligjor

Qeveria është zotuar të përforcojë më tutje të drejtat pronësore, sundimin e ligjit dhe qasshmërinë e gjykatave me qëllim të promovimit të një mjedisi miqësor për bizneset. Reformat në sektorin gjyqësor, sidomos në lidhje me operimin e bizneseve, janë gjithashtu të synuara të plotësojnë aktivitetet ekzistuese në sferën e mjedisit biznesor. Sigurimi dhe implementimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme është theksuar gjithashtu si pengesë e mundshme ndaj operimit të bizneseve në Kosovë, e kështu Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka vendosur një sistem të avancuar të menaxhimit të pronave, kadastrit, lejeve të ndërtimit dhe administratës gjyqësore. Mbështetja e mëtutjeshme do t'i

jepet AKP-së për të themeluar një mekanizëm koordinues mes Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunave, në mbrojtje të të drejtave pronësore. Përforcimi i kapaciteteve të implementimit për ndarjen dhe administrimin e pronave do të jetë hap i vlefshëm për sigurimin e një mjedisi stabil të bizneseve.

#### f. Zhvillimi i Sektorit Financiar

Sektori i bankave komerciale përbëhet nga pesë banka me kapital të huaj dhe dy banka me pronësi vendore. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007, pasuritë totale të bankave komerciale u rritën me 15.9% si rezultat i themelimit të bankave të reja. Kreditë gjithashtu janë rritur në krahasim me 2006. Kjo mund të shpjegohet me rritjen e depozitave amvisnore dhe korporatat publike jo-financiare. Kjo tregon që amvisnitë, si depozitues kryesorë, po fitojnë më shumë besim në sektorin bankar, gjë që është hap i rëndësishëm në procesin zhvillimor. Sektori tregtar mbetet përfituesi më i madh i kredive të dhëna për ekonominë në Kosovë. Megjithatë, një rritje e konsiderueshme vërehet edhe në sektorin bujqësor, edhe pse nga një bazë e ultë. Trende të ngjashme mund të regjistrohen në kreditë e dhëna për industri dhe ndërtim. Kjo tregon që tregtia vazhdon të dominojë ekonominë, derisa sektorët prodhues dhe bujqësorë po tregojnë shenja përmirësimi, derisa aktiviteti ndërtimtar është në vazhdim.

### 2.2.2 Kapaciteti për t'u përballë me presionin konkurrent dhe forcat tregtare të Bashkimit

#### a. Kapitali Njerëzor dhe Fizik

Reforma e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë është një parakusht i rëndësishëm për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate për zhvillim ekonomik të Kosovës. Qeveria është zotuar të implementojë politikat e përshtatshme për një rritje të sasisë dhe cilësisë së arsimit në gjitha nivelet. Adaptimi i kurrikulumeve në arsimin para-universitar dhe profesional drejt kërkesave të tregut është në vazhdim. Në këtë kuptim, Qeveria i kushton vëmendje të veçantë elaborimit dhe implementimit efektiv të Planeve të Veprimit për gjitha nivelet arsimore në Kosovë, duke përfshirë aftësimin profesional, përmirësimin e cilësisë mësimdhënëse si dhe sigurimi i pajisjeve adekuate për shkolla, me fokus të posaçëm në komunitetet RAE. Aktivitetet në shtyrjen e të rinjve të marrin pjesë në programet e Komunitetit do të implementohen duke ofruar informata mbi programet gjegjëse të Komunitetit.

Masat për zvogëlimin e papunësisë janë tejet të rëndësishme për Kosovën. Qeveria do të bëjë një analizë mbi tregun joformal të punës në Kosovë, duke identifikuar arsyet kryesore dhe duke ofruar rekomandime dhe veprime që duhen ndërmarrë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë masave që duhen ndërmarrë për të lehtësuar transferimin nga punësimi i paregjistruar në atë të regjistruar. Krijimi i një tregu funksional të punës kërkon përfshirje të nivelit qeveritar dhe atij lokal. Qeveria është e përkushtuar të punojë në zbatimin e Projekt-Strategjisë së Punës dhe Planit të Veprimit për Punësimin e Rinisë. Hartimi dhe zbatimi i politikave aktive të tregut të punës, në bashkëpunim të afërt me komunitetin lokal të biznesit, me qëllim të avancimit të procesit në tregjet e punës, si dhe rritja e përqindjes së fuqisë së kualifikuar punëtore në fuqinë e përgjithshme të punës, janë në vazhdim e sipër. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore me rekrutimin dhe trajnimin e Sektorit të Dizajnit të Politikave të Punësimit, me synim të përgatitjes së planeve dhe projekteve konkrete të punësimit. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore përmes rekrutimit dhe trajnimit për sektorin e Statistikave Informuese dhe Analizave të Tregut të Punës. Hartimi i projekteve për përmirësimin e shkallës së punësimit të disa kategorive: rinia, grup-mosha 18-39 vjet, punëkërkimi për më shumë se 12 muaj, personat me aftësi të kufizuara. Hartimi i një strategjie afatmesme sektoriale për rikualifikimin e fuqisë punëtore. Ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimit dhe përmirësimit të kushteve të punës në Qendrat e Trajnimit

Profesional. Bashkëpunimi me trajnuesit e jashtëm me qëllim të rritjes së numrit të personelit të kualifikuar.

b. Struktura e Sektorit dhe Ndërmarrjeve

Përmirësimi i infrastrukturës themelore është thelbësor për promovimin e zhvillimit të bizneseve. Zhvillimi i rrjeteve të transportit me vendet fqinje dhe sigurimi i furnizimit me energji do të përmirësojnë konkurrencën kosovare me tregjet rajonale dhe globale, si dhe të bëhet atraktive për zhvillimin ekonomik. Reformat e reja institucionale, gjegjësisht paraqitja e partneriteteve publiko-private në termocentralet e Kosovës janë të planifikuara për afatin e shkurtë dhe të mesëm. Këto masa afatshkurtra do t'i sigurojnë furnizim të mjaftueshëm të energjisë Kosovës. Shpenzimet qeveritare të ofruara për këtë sektor në formë e subvencioneve do të planifikohen për investime kapitale të ardhshme në përmirësimin e infrastrukturës së energjisë. Në afat të gjatë, në pajtim me politikat e hartuara në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Agjencinë Evropiane për Rindërtim dhe USAID-in, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për investime të mëtutjeshme në sektorin e energjisë, gjegjësisht ndërtimin e termocentralit të ri – Kosova C, si dhe shfrytëzimin e resurseve tjera energjetike miqësore për mjedisin.

Mungesa e investimeve në projekte të infrastrukturës kapitale kanë qenë mangësi të Kosovës në kuptimin e sigurimit të një mjedisi konkurrent të biznesit. Kështu, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ka paraqitur planet për disa investime kapitale në infrastrukturën rrugore. Dy magjiistralet kryesore, Prishtinë-Shkup dhe Merdarë-Vermicë janë tenderuar apo janë në fazën përfundimtare të përgatitjeve. Këto projekte të rëndësishme si dhe investimet në infrastrukturën rajonale dhe lokale synojnë të përmirësojnë rrjetet e transportit me vendet fqinje. Kjo do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në atraktivitetin për investime të huaja direkte, si dhe avancimin e tregtisë brenda rajonit.

Privatizimi i ekonomisë së Kosovës është bërë nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Kjo ka qenë në krye të menaxhimit të ndërmarrjeve publike dhe ristrukturimit të tyre qysh prej themelimit të saj në bazë të Rregullores së UNMIK-ut të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Deri në fund të shkurtit 2008, shumica e ndërmarrjeve shoqërore janë privatizuar. Numri i përgjithshëm i kontratave të nënshkruara dhe atyre që presin nënshkrimin është 450, ndërsa fondet e përgjithshme të privatizimit të pranuar dhe të siguruar është 378,124,228 €. Sipas rregullores së punës, 20 % e shumës totale i është ndarë për mbulimin e detyrimeve ndaj ish-punëtorëve.

Për të avancuar me procesin e privatizimit do të elaborohet një Plan Veprimi në bazë të vlerësimit dhe analizimit të planit ekzistues të biznesit të Fondit të Mirëbesimit. Shqyrtimi i planit ekzistues të privatizimit të Ndërmarrjeve Publike (NP) synon të adresojë nevojat për efikasitet dhe efektivitet të ndërmarrjeve publike. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), Kompleksi i Trepçës, do t'i nënshtrohen studimeve të fizibilitetit për privatizim me synim të promovimit të PPP-ve dhe elaborimit të ristrukturimit strategjik. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) po kalon një fazë transformimi, ku një pjesë e kompetencave, sidomos ato në lidhje me Ndërmarrjet Publike (NP) do t'i transferohen institucioneve të Kosovës, derisa Ndërmarrjet e mbetura Shoqërore (NSh) do të administrohen nga një organ i veçantë nën mbikëqyrjen e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Procesi i likuidimit të NSh-ve do të vazhdojë sipas parashikimit të ish Planit të Veprimit të AKM-së, edhe pse faza e transformimit pritet të krijojë një vakum të përkohshëm operativ.

Përkundër aktiviteteve të ristrukturimit dhe privatizimit, si dhe përkundër faktit që ekonomia është kryesisht pronë private dhe tregjet janë përgjithësisht të liberalizuara, ekonomia ende përballlet me sfida të shumta që dalin nga jostabiliteti politik rajonal, si dhe mangësitë në nivel vendi. Këto

përfshijnë sektorin e dobët gjyqësor, dështimi në tërheqjen e investitorëve strategjikë për privatizimin e ndërmarrjeve publike, si dhe dështimi i pronarëve të ndërmarrjeve të privatizuara që të bëjnë reforma e zbulime të reja. Të gjithë këta faktorë kanë zhvlerësuar përpjekjet e Qeverisë dhe kanë parandaluar arritjen e shkallëve më të larta të rritjes ekonomike dhe punësimit në rritje. Kjo kërkon reforma më mirë të hartuara dhe përmirësime të mëtutjeshme të mjedisit afarist. Kjo është arsyeja pse Qeveria është duke vazhduar me përkushtimin e saj ndaj reformave strukturale të cilat janë hartuar në detaje në disa projekte shtesë.

Për shkak të zhvillimeve të reja politike, Qeveria në bashkëpunim me praninë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, ka iniciuar dy ndryshime të rëndësishme ligjore e institucionale, i) Ligji mbi Trashëgimtarin e AKM-së dhe ii) Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Në afat të mesëm, Qeveria do të kërkojë të përmirësojë menaxhimin dhe qëndrueshmërinë financiare të NP-ve. Do të merren masa që do të përmirësojnë shkallën e inkasimit të faturave të ndërmarrjeve publike, përmes rishikimit të planeve të biznesit dhe elaborimit të planeve të veprimit për arritjen e synimeve vjetore për inkasimin e faturave. Gjithashtu, pritjet të ndërmerret një fushatë e gjerë e vetëdijesimit publik. Shturja funksionale dhe ristrukturimi në NP në pajtim me Udhëzimet e OECD-së për Menaxhimin e Korporatave do të adresojë parametrat e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë. Asistenca teknike e huaj parashikohet për mbështetje dhe përforsim të qeverisjes së ndërmarrjeve publike. Mbështetja e NP-ve përmes kredive të jashtme bankare do të sigurojë fonde për zhvillimin e shpejtuar të NP-ve.

Qeveria po bën përgatitjet e duhura për diskutim mbi Raportin e Misionit Vlerësues të KE-së për Rregullatorët në Kosovë, me synim të ndërmarrjes së masave të domosdoshme për të siguruar pavarësinë operative dhe financiare të rregullatorëve. Korniza ligjore për funksionimin e rregullatorëve do të avancojë pavarësinë funksionale dhe financiare deri në kufijtë ku transparenca dhe përgjegjshmëria të mos rrezikohen. Deri sa ka pasur përparim të dukshëm në këtë fushë, themelimi i Autoriteteve Rregullative për Hekurudhat e Kosovës, Autoritetin e Aviacionit Civil dhe ndërtimi i kapaciteteve për personelin e Rregullatorëve përmes trajnimeve dhe rritjen graduale të pagave janë të parashikuara në afat të mesëm. Një analizë e kolizioneve të ndryshme mes Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë dhe pavarësinë operative të rregullatorëve është e nevojshme për të siguruar qeverisjen efikase dhe efektive.

#### c. Ndikimi i Qeverisë mbi Konkurrencën

Mjedisi i parashikueshëm dhe stabil i biznesit do të mundësojë zhvillimin stabil ekonomik, rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e kushteve të tregut të punës. Kështu, qeveria do të shqyrtojë legjislacionin tatimor, sidomos akcizën, tatimet doganore, me synim të krijimit të kushteve më të mira për IHD-të. Reformat strukturore do të zbatohen për të përmirësuar mjedisin e bizneseve dhe për të zhvilluar konkurrencën e ndërmarrjeve, derisa ruhet stabiliteti makroekonomik. Në këtë kuptim, do të themelohet një strukturë e mbikëqyrjes së tregut. Masa të reja do të ndërmerren për përforsimin dhe fuqizimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale, në pajtim me strategjinë afatmesme. Qeveria është gjithashtu e përkushtuar të vazhdojë implementimin e Strategjisë Afatmesme për Krijimin e Sistemit të Mbrojtjes së Pronës Industriale. Fushatat e vetëdijesimit publik mbi të drejtat pronësore industriale priten të ndodhin.

Kosova është duke punuar në një mënyrë shumë aktive dhe do të vazhdojë implementimin e masave për inkurajimin e zhvillimit të bizneseve. Themelimi i një Agjencie për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) është një hap i rëndësishëm. Ndërtimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve për personelin dhe trajnimet e ofruara për ndërmarrjet janë të parashikuara (inkubatorët e biznesit). Masa të tjera institucionale do të merren për të siguruar një nivel të kënaqshëm të implementimit të Kartës

Evropiane për NVM-të. Strategjia e re për Zhvillimin e NVM-ve do të iniciohet, për t'iu referuar dhe për të plotësuar Strategjinë Zhvillimore të Kosovës (SZhK). Përveç këtyre, implementimi i një strategjie afatmesme për mbështetjen e NVM-ve, duke përfshirë përforsimin e agjencisë së mbështetjes së NVM-ve, si dhe përforsimin e agjencisë për promovimin e investimeve do të përmirësojë tutje mjedisin ku funksionojnë NVM-të. Pritet një rritje graduale e personelit të Agjencisë për Promovimin e Investimeve, në pajtim me rregullat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe strukturës organizative të Agjencisë. Për më shumë, Ministria e Tregtisë do të përmirësojë qasjen elektronike duke implementuar Projektin e “Teknologjisë Informative të Ndërmarrjeve”.

#### d. Integrimi Ekonomik me BE-në

Kosova ka prioritetizuar kontributin e saj në implementimin e **CEFTA-s**, duke qenë mes vendeve të para për të përmbyllur procedurat dhe obligimin e marrë përsipër me nënshkrimin e marrëveshjes. Tregtia me anëtarët e CEFTA-s përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimit tregtar të Kosovës, 38.6%. Kjo tregon që ekonomia e Kosovës është mirë e integruar në ekonominë rajonale. Eksportet në vendet e CEFTA-s është rritur me 34.3% në krahasim me 2006-ën. Shuma e eksporteve ka arritur 47.6 milionë Euro ose rreth 49% të eksporteve totale. Importet nga vendet e CEFTA-s kanë arritur 569 milionë euro me një rritje vjetore prej 7.4%, që përbën rreth 38% të totalit të importeve. Struktura e eksporteve të Kosovës tregon një përmirësim të vogël të sektorit industrial dhe ushqimor. Një analizë e trendëve të importit tregon që rritja e vitit 2007 ka ardhur kryesisht për shkak të produkteve të përdorura për investime kapitale, pajisje e makineri dhe materiale ndërtimore.

## 2.3 STANDARDET EVROPIANE

### 2.3.1 Tregu i Brendshëm

#### a. Lëvizja e Lirë e Mallrave

Kosova është tani në procesin e hapjes së dosjes së plotë të Tregut të Brendshëm, si dhe do të sigurojë që secili akt relevant i BE-së do të transpozohet në mënyrë korrekte në mjedisin ligjor të Kosovës, duke themeluar strukturën e fuqishme e të aftë të implementojë atë legjislacion, në pajtim me praktikën më të mira të Shteteve Anëtare të BE-së. Kosova është në procesin e themelimit të kornizës ligjore horizontale mbi lëvizjen e lirë të mallrave. Ligji mbi Metrologjinë, si dhe Ligji mbi Inspektoratin e Tregut janë hartuar në frymën e legjislacionit evropian. Gjithashtu, një pjesë e standardeve evropiane tanimë është transponuar, bashkë me transpozimin e disa Direktivave të Qasjes së Re: Direktiva 98/37/EC mbi Makinat që është transpozuar përmes UA Nr. 2007/16 mbi Rregullat Teknike për Makineri dhe elementet e tyre të sigurisë; Direktiva 73/23/EEC mbi Pajisjet elektrike me presion të ultë, e transpozuar si UA Nr. 2005/28 për Rregullat Teknike për Pajisjet Elektrike të dizajnuara për përdorim në disa presione. Për më shumë, konsolidimi i Divizionit për Rregulla Teknike brenda MTI-së (për momentin ka vetëm 2 zyrtarë), zhvillimi i kapaciteteve institucionale përmes rekrutimit dhe trajnimeve për implementimin e legjislacionit në këtë nën-fushë, janë procese në vazhdimësi.

Prioritetet e Partneritetit Evropian në lidhje me Lëvizjen e Lirë të Mallrave përfshijnë: miratimin e kornizës legjislative horizontale e cila siguron funksionimin e duhur në Fushën Rregullative, Standardizim, Metrologji dhe Mbrojtje të Tregut. Për më shumë, kërkohet vazhdimi i transpozimit të Direktivave të Qasjes së Re dhe asaj të Vjetër Globale. Tutje, Partneriteti Evropian përfshin edhe miratimin e standardeve evropiane, si dhe themelimin e konsolidimin e strukturës së mbikëqyrjes së tregut.

Prioritetet e lartshënuara synohen të arrihen përmes miratimit të disa ligjeve, akteve nënligjore si dhe duke krijuar e konsoliduar infrastrukturën institucionale. Në afat të shkurtë, konsolidimi i infrastrukturës ligjore do të vazhdojë me miratimin e Projektligjit mbi Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, ndryshimin e Ligjit mbi Produktet dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë (konformitetit), Ligjin mbi Konsumatorët dhe Ligjin mbi Akreditimin, si dhe lëshimin e akteve nënligjore për implementimin e Ligjit mbi Metrologjinë Nr. 2006/02-L34, miratuar më 19 janar 2006 dhe Ligjin mbi Standardizimin Nr. 2004/12, miratuar më 29 prill 2004.

Në afat të mesëm, konsolidimi i infrastrukturës legislative do të përfshijë, mes tjerash, edhe transpozimin përmes akteve nënligjore, të Direktivave të Qasjes së Re Globale: Direktiva 2000/9/EC mbi Instalimet rrugore kabllorike (teleferikë) të dizajnuara për bartjen e personave, Direktiva 95/16/EC mbi Rregullat Teknike për Ashensorë dhe elementet e tyre të sigurisë; Direktiva 88/378/EEC mbi Sigurinë e Lodrave; Direktiva 89/686/EEC dhe Direktiva 93/95/EEC mbi Pajisjet për Mbrojtje Personale; Direktiva 89/106/EEC mbi Produktet Ndërtimore; Direktiva 89/336/EEC mbi Përputhshmërinë Elektro-Magnetike, si dhe direktiva tjera në lidhje me çelikun, asfaltin, teleferikët. Për më shumë, veprimet afatmesme parashikojnë vazhdimësinë e miratimit të standardeve evropiane.

Sa i përket infrastrukturës institucionale, me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes së tregut, synimi është themelimi dhe funksionalizimi i Inspektoratit Qendror të Tregut dhe inspektorateve tjera, përmes rekrutimit të personelit të ri, si dhe trajnimit të stafit ekzistues. Është parashikuar të rekrutohen 2 inspektorë të rinj për industri, 2 për metrologji dhe 2 për ndërtimtari, si dhe rritja e numrit të inspektorëve në Inspektoratet Komunale. Këto masa do të sigurojnë efikasitetin në mbikëqyrjen e tregut.

#### b. Lëvizja e Lirë e Kapitalit

Institucioni përgjegjës në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit është Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK). AQBK-ja, trashëgimtar i Autoritetit Bankar dhe Pagesave të Kosovës, është subjekt i veçantë publik me autoritetin e licencimit, mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare në Kosovë. AQBK-ja ishte themeluar në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, shpallur më 15 nëntor 1999 (ndryshuar më 1 tetor 2001) “mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës”. Tutje, më 24 gusht 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka nënshkruar një Rregullore të re mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, duke transformuar kështu Autoritetin e Bankave dhe Pagesave në Autoritet Qendror Bankar të Kosovës, ndërsa ndërkohë janë miratuar disa rregullore tjera të UNMIK-ut, si Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Luftimin e Shpëlarjes së Parave dhe Veprave tjera Penale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/26 mbi Transaksionet e Pagesave, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësit e Sigurimeve.

Qysh prej fillimit, përpjekjet e AQBK-së janë mbështetur nga një komponent i rëndësishëm i ndërtimit të kapaciteteve dhe asistencës teknike, të ofruar nga institucione e partnerë të ndryshëm.

Në fund të vitit 2005, Menaxhmenti vendosi të adresojë atë që ndoshta është një nga sfidat më të vështira: ofrimi i një shikueshmërie më të madhe për AQBK-në dhe personelin e saj në kuptimin e synimeve, përgjegjësi dhe roleve të tij të ardhshme. Vijimisht, menaxherët elaboruan një “Plan Biznesi 2006”, i cili mbulonte synimet kryesore të Institucionit për këtë periudhë. Në fund të vitit 2006, si dhe në bazë të këtij dokumenti, rezultatet e secilës njësi të punës u vlerësuan së bashku dhe u krahasuan me synimet fillestare. Më 2007, është përgatitur plani i Biznesit për AQBK-në për periudhën 2007 – 2009 i cili tani është dokumenti themelor i punës së tij.

Asetet e sektorit financiar kanë arritur në shifrën 1.4 miliardë euro në qershor 2007, kryesisht të përbëra nga kreditë për ekonominë vendore. Asetet e sektorit bankar mbeten elementi kryesor i aseteve totale financiare, duke marrë 88.6% në qershor 2007. Numri i bankave komerciale që punojnë në Kosovë ka mbetur konstant, 6, por struktura e pronësisë ndryshoi kur banka sllovene Nova Ljubljanska Banka (NLB) bleu shumicën e aksioneve të dy bankave vendore, Kasabank dhe Banka e Re e Kosovës. Kështu, nga gjashtë banka komerciale funksionale në Kosovë, vetëm dy mbetën me pronësi të plotë vendore. Sektori bankar në Kosovë ka rritje të vazhdueshme. Kjo shprehet me asetet totale të sektorit bankar që arrijnë në 1.2 miliardë euro, gjë që përbën rreth 50% të BPV-së. Kreditë e dhëna nga sektori bankar kanë shënuar një rritje vjetore prej 27.1%. Korporatat jo-financiare (KJF) vazhdojnë të thithin pjesën më të madhe të kredive, ndërsa maturimi i kredive vazhdon të zgjatet. Edhe depozitat në sektorin bankar kanë shënuar rritje në krahasim me qershorin e vitit 2006 (16.1%). Burimi kryesor i depozitave vazhdon të jetë amvisëria, derisa maturimi mbetet kryesisht afatshkurtër. Sektori bankar ka shënuar performancë të mirë, me indikatorë të fuqishëm të fitimprurjes, derisa kanë mirëmbajtur likuiditetin dhe solvencën e tyre.

Nëntë kompani sigurimi që veprojnë në treg përbëjnë rreth 5% të aseteve të përgjithshme të sektorit financiar. Si në sektorin bankar, pronësia e huaj dominon këtë sektor, me 6 kompani të huaja të sigurimeve. Në kuptimin e totalit të aseteve, kompanitë e sigurimeve janë rritur me 29.5% në baza vjetore, derisa Sigurimi i Palës së Tretë (TPL) mbetet aktiviteti kryesor i kësaj industrie.

Përveç tregut të sigurimeve, korporatat tjera financiare përfshijnë 2 fonde pensionale, 16 ndërmjetës tjerë financiarë, si dhe 27 institucione përcjellëse financiare, të cilat veprojnë si agjenci këmbimi dhe disa si agjenci të transferimit të parave. Shuma totale e fondeve pensionale të akumuluar në skemën e detyrueshme të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) ka regjistruar një rritje vjetore prej 48.5%. Aktiviteti i rritur shënohet gjithashtu tek Ndërmjetësit Tjerë Financiarë (OFI) që kanë rritur vëllimin e kredive të dhëna me 24.9% në baza vjetore. Për më shumë, transferimi i parave përmes Agjencive Përcjellëse Financiare (FA) ka shënuar rritje vjetore prej 11.1%, kryesisht me transferet nga Diaspora e Kosovës.

Korniza ligjore e ndërtuar nga UNMIK-u dhe AQBK-ja është e zhvilluar mirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Si rezultat, industria financiare ka kapacitet për të mbështetur zhvillimin ekonomik në mënyrë të shëndoshë dhe të sigurt, në bazë të një tërësie gjithëpërfshirëse dhe moderne të Rregulloreve (ligjeve) dhe rregullave.

Zgjidhja e statusit do të mund të ndikonte në sektorin financiar dhe AQBK. Mjedisi i ri mund t'i ofrojë më shumë mundësi për avancimin e integritetit të Kosovës në grupin rajonal dhe të hapë rrugën për lidhje më të afërta me Bashkimin Evropian. Tanimë, sektori financiar në Kosovë përfshin praninë e aktorëve nga rajoni i Ballkanit dhe BE-ja. Megjithatë, ende ka hapësirë për integrim më të gjerë ndërkombëtar të sektorit financiar të Kosovës, gjegjësisht përmes lidhjeve të avancuara kapitale dhe operacionale me aktorët financiarë nga rajoni, gjegjësisht nga vendet më të zhvilluara. Zgjidhja e statusit do të lehtësojë integrimin e Kosovës në rrjetet ndërkombëtare si SWIFT ose Green Card.

Në bazë të vlerësimit të Komisionit Evropian, një kërkesë imediate në këtë nën-fushë është unifikimi i mjeteve monetare të pagesës për gjithë tregun e vendit, respektivisht mundësimi i një transferimi më transparent të valutës së Republikës së Serbisë në Republikën e Kosovës.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, veprimet e parapara, mes tjerash, do të përforcojnë mbikëqyrjen e sektorit financiar përmes implementimit të politikave të institucioneve gjegjëse vendore, që do të përqendrohet në përmirësimin e strukturës dhe operacioneve të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës si institucion rregullator. Përbrenda këtij konteksti, AQBK-ja do të rrisë numrin e punëtorëve, do të analizojë tregjet

bankare dhe jo-bankare me synim të krijimit të një baze shënimesh për themelimin e një “Sistemi të Paralajmërimit të Hershëm”, por edhe në përmirësimin e kapaciteteve monitoruese dhe mbikëqyrëse mbi bankat komerciale. Në aspektin legjislativ, kjo do të arrihet përmes rishikimit të kornizës ekzistuese ligjore, me qëllim të sigurimit të një mbikëqyrjeje efektive dhe permanente, si dhe menaxhimit të ankesave në sektorin e sigurimeve, fondeve pensionale dhe institucionet tjera financiare jo-bankare.

### c. Dogana dhe Tatimet

Shërbimi Doganor u krijua më 1999 si pjesë e UNMIK-ut dhe deri në fund të vitit të kaluar, Shërbimi Doganor ka qenë organ i UNMIK-ut, gjegjësisht fushë e rezervuar e politikave për PSSP-në. Në prill 2007 i është transferuar autoriteteve vendore. Kodi Doganor i UNMIK-ut ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2004, përgjithësisht në pajtim me legjislacionin evropian. Dispozitat e reja kanë hyrë në fuqi mbi fushat si kufizimet tregtare për armë dhe produkte të mbuluara me Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare me Qenie të Rrezikuara (CITES), regjimi i ri i dënimeve administrative dhe Kodi i Etikës është implementuar (63 procedura disiplinore janë iniciuar apo janë në vazhdim e sipër, ndërsa Njësia e Standardeve Profesionale mbikëqyr aplikimin e dispozitave të këtij Kodi).

PSSP-ja emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Doganor, i cili ka përgjegjësi statusore për ushtrimin e funksioneve dhe pushteteve kryesore të Doganave të UNMIK-ut, të cilat dalin nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/1 (Kodi Doganor). Korniza aktuale legjislative përbëhet nga një numër Rregulloresh të UNMIK-ut, mes tjerash më kryesore janë 2007/31, 2006/2, 2004/1 dhe 2003/32.

Shërbimi Doganor është organizatë buxhetore për qëllimet e Buxhetit të Kosovës dhe plotësisht i financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Derisa nuk është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm, në ushtrimin e pushtetit të tij statusor, kërkon të inkorporojë praktikat e mira të shërbimit civil dhe procedurave në administrimin e Doganave.

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është Shërbimi doganor më i ri në botë, i cili është zhvilluar vazhdimisht me të gjitha elementet e një Shërbimi modern Doganor, me kontrollin e të hyrave, avancimin dhe zhvillimin e sistemeve, promovimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve, avancimin dhe profesionalizimin e burimeve njerëzore, inteligjencës, hetimeve dhe elementeve anti-kontrabandë, njësitë e politikave dhe ligjeve bashkë me funksionet e Selisë Qendrore. Përkundër të mos qenurit në gjendje për anëtarësim të plotë në organizatat ndërkombëtare, ai merr pjesë në iniciativat ndërkombëtare dhe rajonale nën programin CARDS dhe Iniciativën e Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SECI). Gjithashtu, është në gjendje të përfitojë nga Organizata Botërore e Doganave (WCO) dhe ka paraqitur kërkesën për status vëzhguesi. Në këtë mënyrë, Doganat e UNMIK-ut përfitojnë nga asistencë bilaterale ndërkombëtare dhe ajo ligjore, si dhe nga shkëmbimi i praktikave dhe procedurave të mira.

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut hyri në vitin 2007 me numër punëtorësh prej 563 nga kufiri i përcaktuar buxhetor prej 567. Në fund të vitit 2006, kishte 567 punëtorë në veprim, prej të cilëve 18% nga grupet pakicë dhe 24% femra.

Organizimi dhe struktura e Doganave u rishikua gjatë vitit 2005 për një strukturë të re për vitin 2006, e cila u miratua nga Zëvendës PSSP-ja për Rindërtim Ekonomik, pas konsultimit me Qeverinë. Bordi i ri Menaxhues hyri në fuqi më 16 janar 2006, me përbërje: Drejtori i Përgjithshëm (ndërkombëtar), Zëvendës Drejtori Gjeneral (Vendor), Drejtor i Zbatimit dhe Përputhshmërisë (Ndërkombëtar), Drejtor i Operacioneve të të Ardhurave (Vendor), Drejtor i Financave dhe Sistemeve (Vendor), si dhe Drejtor Ligjor (Vendor). Në pajtim me planet e Administratës së UNMIK-ut, transferimi i përgjegjësive tek

vendorët është në vazhdim: nga 1 janari 2007, Drejtori i Zbatimit të Ligjeve u bë një vendor, derisa nga 1 prilli 2007, edhe vetë pozita e Drejtorit të Përgjithshëm është plotësuar me vendor.

Qysh prej themelimit, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut ka marrë mbështetje të pafundme nga CAFAO-UNMIK (ish CAM-K) me misionin e asistencës teknike të Doganave (dhe së fundmi edhe tatimeve) me ekspertë të financuar nga Komisioni Evropian. Pa ndihmën e CAFAO-s, pjesa më e madhe e zhvillimit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut nuk do të ishte e mundur. Derisa programi CAFAO ka qenë në zvogëlim gradual, Programi për 2007 ka mbështetur ndihmën në zhvillimin e sistemit gjithëpërfshirës dhe stabil ligjor, i cili do të sigurojë implementimin e qartë dhe transparent të legjislacionit doganor dhe akcizës në pajtim me BE-në, duke krijuar kështu një bazë të barabartë për vlerësimin dhe inkasimin e tatimeve, duke respektuar plotësisht të drejtat e publikut, aktorëve ekonomikë dhe zyrtarëve tatimor. Është në vazhdim e sipër edhe përputhja e doganave dhe legjislacionit të tatimeve direkte dhe indirekte me EU *Acquis* dhe avancimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit dhe luftimit të korrupsionit, krimit ndërkufitar dhe evazionit fiskal.

Korniza Strategjike Operacionale e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut (SOF) 2007 – 2009 përcakton 7 synime kryesore të Shërbimit Doganor: (i) Vjelja e të ardhurave të duhura në kohën e duhur nga TVSH-ja në import, akciza dhe tarifa doganore; (ii) promovimi i komunikimit dhe bashkëpunimit brenda vendit me komunitetin afarist në Kosovë, shërbimet qeveritare dhe ndërkombëtarisht me administratat tjera doganore në rajon dhe më gjerë, duke kërkuar statusin e vëzhguesit në Organizatën Botërore të Doganave; (iii) Zhvillimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve brenda shërbimit për të nxitur integritetin, zhvillimin e resurseve njerëzore, politikave, kornizës ligjore, arritja e transparencës dhe vendosja e praktikave të mira; (iv) Zbatimi i fuqive dhe procedurave në Kodin Doganor dhe Kodin e Akcizave në mënyrën më të mirë për të përmirësuar përputhshmërinë dhe mundësimin e aktivitetit ekonomik në bashkëpunim me faktorët e të ardhurave. Arritja e balancit të duhur mes mundësimit të tregtisë dhe kontrollimit të saj, me anë të teknikave që shfrytëzojnë vlerësimin e rrezikut, profilizimin dhe selektivitetin; (v) Puna me faktorët e të ardhurave që dëshirojnë të përmirësojnë përputhshmërinë e tyre me anë të kompetencave të veçanta, si dhe ku është e mundur, krijimi i një baze për të lëvizur tutje me procedurat e një Kodi të ri Doganor; (vi) Zhvillimi i mëtutjeshëm i aftësive për zbatimin e ligjit për të: a) parandaluar dhe identifikuar mashtrimet në të ardhura, kontrabandimin e mallrave komerciale, drogave ilegale dhe mallrave tjera të ndaluara dhe të kufizuara; si dhe b) hetimi dhe ndjekja e shkeljeve nën drejtimin e prokurorisë publike; (vii) implementimi i rekomandimeve nga grupet punuese të ekspertëve të themeluar nga Konferenca e Nivelit të Lartë mbi Doganat dhe Bashkëpunimin Ndërkufitar në Evropën Juglindore.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, ShDU-ja, mes tjerash, do të rishikojë legjislacionin aktual, UA për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve doganorë do të hartohet dhe fuqizohet, disa veprime do të përqendrohen në bashkëpunimin rajonal, kapaciteti në TI do të përforcohet, kapacitetet institucionale do të përforcohen përmes trajnimeve, UA për implementimin e Kodit Doganor mbi Rregullat e Origjinës do të hartohet dhe të hyjë në fuqi, UA mbi sigurimin e Informatave Mandatore mbi Origjinën e Mallrave, si dhe Laboratori Doganor do të funksionalizohet.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, ShDU-ja, mes tjerash, do të fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve, do të vazhdojë me implementimin e Strategjisë Afatmesme për luftimin e korrupsionit, krimit ndërkufitar dhe evazionit tatimor, si dhe do të vazhdojë me përforcimin e bashkëpunimit rajonal.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është themeluar më 17 janar 2000, nën administrimin e UNMIK-ut. Më 18 shkurt 2003, autoriteti për administratën tatimore iu transferua MEF-it. Qysh prej

atëherë, ATK-ja ka funksionuar si organizatë e pavarur, menaxhuar plotësisht nga punëtorët vendorë, mbështetur nga këshillat e organizatave ndërkombëtare si USAID-i, Shtylla IV e BE-së dhe CAFAO-UNMIK nga BE-ja.

Gjatë historisë së saj të shkurtër, ATK-ja ka zhvilluar një strukturë funksionale organizative e cila në pjesën më të madhe është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ajo ka një qendër të centralizuar për procedimin e dokumenteve, përmes të cilës përpunohen gjitha deklaratimet. Një njësi për administrimin tatimor të ndërmarrjeve të mëdha është tanimë e themeluar. Legjislacioni tatimor është pranuar nga FMN-ja dhe Komisioni Evropian si transparent dhe cilësor. Legjislacioni i ATK-së në një masë të madhe është në përputhje me Direktivën e Gjashtë të BE-së. Në vitin 2006, inkasimi tatimor ka tejkaluar projeksionet për gati 18%. Vjeljet vjetore tregojnë rritje të konsiderueshme në krahasim me vitet e kaluara, edhe në një ekonomi me rritje të ultë ekonomike.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) funksionon në bazë të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/17 për Shpalljen e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 27 shtator 2004. Sipas këtij Ligji, ATK-ja ka statusin e Agjencisë Ekzekutive, e cila funksionon me autonomi të plotë operative brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Funksioni i ATK-së është të administrojë dhe zbatojë dispozitat e ligjit aktual dhe legjislacionit në fuqi në Kosovë që kërkon administrimin e çfarëdo tatimi. Është detyrë e ATK-së që të grumbullojë brenda kohës së caktuar të ardhurat më të larta të mundshme brenda ligjit, duke marrë parasysh: a) resurset në dispozicion të ATK-së; b) rëndësinë e promovimit të respektimit të ligjit, sidomos respektimit të vullnetshëm të gjithë tatimpaguesve kosovarë të legjislacionit tatimor; si dhe c) shpenzimet e këtij respektimi të shkaktuara nga tatimpaguesit. ATK-ja punëson 650 zyrtarë. ATK-ja është përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave të qeverisë qendrore, duke përfshirë: TVSH mbi furnizimin e brendshëm, Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Të Ardhurat mbi Punën dhe Kontributet Personale. Përveç këtyre, ajo është përgjegjëse edhe për lëshimin e licencave për Lojërat e Fatit, mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve të veprimtarive të lojërave të fatit, si dhe implementimi i rregulloreve për lojëra të fatit.

ATK-ja ka miratuar Planin e Veprimit Strategjik për Administratën Tatimore të Kosovës dhe Strategjinë 2007-2010. Qëllimet kryesore të Strategjisë janë: Përmirësimi i komunikimit me tatimpagues, themelimi i regjistrimit të biznesit në ATK, përmirësimi i procedurave për menaxhimin e borxheve, rritjen e deklaratimeve vullnetare, përmirësimi i identifikimit të evazionit tatimor, rritja e kapacitetit operativ të SIGTAS-it, zhvillimi i kapaciteteve për deklarim elektronik si dhe përmirësimi i infrastrukturës së TI.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, ATK-ja, mes tjerash, do të rrisë kapacitetin administrativ përmes trajnimeve, do të hartojë dhe zbatojë plane konkrete për inkasimin e borxheve, si dhe do të organizojë fushata vetëdijësimi në lidhje me politikat tatimore.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, ATK-ja, mes tjerash, do të shqyrtojë legjislacionin tatimor me synim të harmonizimit të tij me legjislacionin evropian në këtë fushë, do të avancojë sistemin identifikues të personave që nuk deklarojnë të ardhurat e tyre, do të avancojë sistemin e menaxhimit të informatave, si dhe sistemin e bazuar në rrezik. Përafrimi i legjislacionit, si dhe përforsimi i kapaciteteve legjislative dhe administrative në luftimin e korrupsionit, krimin ndërkufitar dhe evazionit fiskal, mbeten prioritetë edhe në afatin e mesëm. Për të adresuar këto çështje, MEF-i dhe agjencitë tjera planifikojnë të hartojnë, ndryshojnë dhe miratojnë një numër aktesh legjislative në fushën e doganave dhe tatimit.

Më me rëndësi, Ligji i ri mbi TVSh-në, i cili do të hyjë në fuqi gjatë vitit 2008, synon të krijojë një mjedis i cili mundëson grumbullim më të mirë dhe më efikas të tatimit. Përveç këtij, theksi do të vihet në fushën e bashkëpunimit institucional për të krijuar një sinergji me agjencitë dhe departamentet tjera përgjegjëse në fushën e Doganave dhe Tatimeve.

#### d. Prokurimi Publik

Më 15 janar 2004 u miratua Ligji mbi Prokurimin Publik (LPP) Nr. 2003/17. Më 8 shkurt 2007, u miratua Ligji për Ndryshimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 2007/02-L99. Ligji i ri, në pajtim me standardet evropiane dhe praktikën e mira ndërkombëtare, siguron ndryshimet e rëndësishme, mes të cilave, shkurtimin e gjitha afateve të prokurimit dhe zvogëlimin e procedurave të prokurimit nga shtatë në gjashtë. Më tutje, Ligji mbi Prokurimin Publik është thjeshtuar, derisa disa funksione të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe MEF-it i janë transferuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP). Autoritetet kontraktuese kanë fituar më shumë pavarësi në zgjedhjen e procedurave të prokurimit.

Në bazë të këtij Ligji, përveç kompetencave ekzistuese, KRPP-ja është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e rregullave të prokurimit dhe sistemit të prokurimit publik të Republikës së Kosovës. LPP-ja përcakton edhe themelimin e organeve të reja, si Organi Shqyrtues i Prokurimit, Agjencia e Prokurimit Publik, dhe organe tjera që sigurojnë implementimin e Ligjit. Për më tepër, LPP-ja parashikon hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar për zbatimin e plotë të këtij ligji. Megjithatë, organet e lartpërmendura nuk janë themeluar ende (Organi Shqyrtues i Prokurimit) apo ende nuk janë konsoliduar (tjerat). Gjithashtu, ka një mungesë të legjislacionit sekondar për zbatimin e plotë të LPP-së.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e prokurimit publik, mes tjerash, KRPP-ja do të synojë kompletimin e akteve nënligjore për zbatimin e LPP-së, duke përfshirë Udhëzimin për Implementimin e LPP-së, Dosjes së Tenderit dhe Udhëzimeve për Përdorim, miratimin e Rregullores për Prokurimin Publik, si dhe Udhëzimet për Kornizën e Kontratës. Në plotësimin e kornizës institucionale, parashikohet themelimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, anëtarët e të cilit do të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe zhvillimi i kapaciteteve administrative të këtij organi. Themelimi i një organi të tillë të pavarur do të ketë një ndikim në zbatimin e sigurt të rregullave të prokurimit dhe në luftimin e keqpërdorimeve.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e prokurimit publik, KRPP-ja, mes tjerash, do të synojë të sigurojë zbatimin e duhur të rregullave të prokurimit publik përmes mbikëqyrjes së autoriteteve kontraktuese. Veprimet tjera të rëndësishme përfshijnë ofrimin e rekomandimeve dhe masave të propozuara kundër autoriteteve në kundërshtim të dispozitave të LPP-së. Për më tepër, përmirësimi i efikasitetit në KRPP do të arrihet përmes rekrutimit të personelit të ri dhe trajnimit të personelit aktual në zbatimin e LPP-së. Gjitha këto veprime do të mundësojnë përmbushjen e prioriteteve për këtë nën-fushë dhe do të rrisin efikasitetin e organeve të prokurimit publik.

#### e. Të Drejtat e Pronësisë Intellektuale

Në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar katër ligje: Ligji mbi Patentat Nr. 2004/49 më 27 shtator 2004, Ligji mbi Markat tregtare Nr. 2006/02-L54 më 23 shkurt 2006, Ligjin mbi Dizajnin Industrial Nr. 2005/02-L45 më 21 nëntor 2005 si dhe Ligjin për Mbrotjtjen e të Drejtave Autoriale dhe të drejtave tjera të përafërta Nr. 2004/45 më 29 qershor 2006. Për zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve janë miratuar edhe këto akte nënligjore: UA “Për Procedurat e Regjistrimit të Patentave”, UA “Për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare”, UA

“Për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial”, UA “Për njohjen e të drejtave të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në ish-Jugosllavi”, UA “Për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale” dhe UA “Për Përfaqësuesit e autorizuar në Sferën e Pronësisë Industriale.

Për implementimin e legjislacionit të sferës së pronësisë industriale është themeluar Zyra e Pronësisë Industriale; zyra është mandatuar, brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Zyra deri në (Mars 2008) ka pranuar 600 kërkesa për mbrojtjen e të drejtave të pronës industriale.

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë ndarë në dy nën-fusha: pronësia industriale e cila përfshin zbulimet, markat tregtare, dizajnin industrial si dhe indikacionet gjeografike të burimeve; si dhe e drejta e kopjimit, e cila përfshin veprat letrare dhe artistike si novelat, filmat, veprat muzikore, pikturat, fotografitë dhe dizajnet arkitektonike.

Pronësia industriale është e rregulluar me tre ligje themelore: Ligji mbi Patentat, Ligji mbi Markat Tregtare dhe Ligji mbi Dizajnin Industrial. Zyra e Pronësisë Industriale është themeluar më 19 mars 2007; është mandatuar, brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për të mbikëqyrë implementimin e ligjeve të lartpërmendura. Zyra deri tani ka marrë 600 aplikacione në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale.

Në aspektin ligjor, Zyra e Pronësisë Industriale ka hartuar dhe miratuar aktet nënligjore për implementimin e këtyre Ligjeve: UA për Procedurat e Regjistrimit të Patentave, UA për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial, UA për Patentat, Markat Tregtare dhe Transferimin e Dizajnit Industrial, miratuar para hyrjes në fuqi të UA mbi Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale, UA për Përfaqësuesin e Sferës së Pronës Industriale. Ligji mbi të Drejtat Autoriale është miratuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat tjera të përafërta. Ky Ligj parashikon edhe themelimin e Zyrës për të Drejtat e Pronës Intelektuale.

Në afatin e shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, MTI-ja, MKRS-ja dhe IGjK-ja mes tjerash do të synojnë implementimin e masave që janë parashikuar për zhvillimin e kapaciteteve administrative/gjyqësore për luftimin e shkeljeve masive. Synimi është sigurimi i implementimit të ligjeve në fushën e pronësisë intelektuale, pasi që ka tanimë prapambetje të theksuar, përforcimi i kapaciteteve administrative përmes rekrutimit dhe trajnimeve, si dhe kapacitetit në IT, aktet nënligjore që sigurojnë të drejtat autoriale dhe të përafërta do të përgatiten, ndërtimi i kapaciteteve të Zyrës së Pronësisë Industriale (ZPI) është parashikuar përmes trajnimeve, themelimi i Zyrës për të Drejta Autoriale dhe ndërtimi i kapaciteteve administrative për këtë Zyrë, si dhe aktivitetet përgatitore për nënshkrimin e konventave/marrëveshjeve në nën-fushën e pronësisë industriale.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, mes tjerash, MTI-ja do të miratojë dhe zbatojë Strategjinë për Krijimin e Sistemit të Mbrojtjes së Pronës Industriale, do të implementojë fushata vetëdijesimi mbi të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta, si dhe do të përqendrohet në avancimin e kapaciteteve administrative.

#### f. Punësimi dhe Politikat Sociale

Qysh prej përfundimit të luftës më 1999, ringjallja ekonomike e Kosovës është nxitur nga ndihma e donatorëve në rindërtim, transferimet e parave nga prania e madhe ndërkombëtare, si dhe dërgesat nga punëtorët. Më 2002, resurset e donatorëve filluan të bijnë, u dobësua rritja ekonomike dhe u përkeqësua pozita fiskale.

Më 2006 rritja ekonomike tregoi disa shenja ringjalljeje, me rritje të konsiderueshme të numrit të bizneseve të reja të regjistruara, në të ardhura tatimore e tregtare, si dhe në dhënien e kredive për bizneset.

Sektori i jashtëm mbetet një nga sfidat më të mëdha për ekonominë e Kosovës: deficitit tregtar mbeti në vitin 2006 në 51% të BPV-së, derisa deficitit aktual i llogarive – pas ndihmës së huaj – ishte afër 15%. Në të njëjtin vit, eksportet ishin 14 herë më të ulta se importet. Duke marrë parasysh mungesën e investimeve të huaja direkte, financimi i deficitit të llogarive rrjedhëse mbështetet nga asistenca e huaj (21% e BPV-së më 2005) dhe nga transferimet e kapitalit privat (17%).

### Kosova: indikatorët kryesorë ekonomikë 2002-2006

|                                                        | 2002v | 2003v | 2004v | 2005v | 2006p |
|--------------------------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|
| <b>Llogaritë vendore</b>                               |       |       |       |       |       |
| Rritja reale e BPV-së                                  | -0.1  | -0.5  | 2.0   | -1.5  | 2.0   |
| Investimet (% BPV)                                     | 23.7  | 22.9  | 26.3  | 28.2  | 28.9  |
| Bruto kursimet vendore (% BPV)                         | -7.1  | -5.7  | -4.2  | -8.3  | -5.3  |
| <b>Buxheti i përgjithshëm qeveritar / <sup>1</sup></b> |       |       |       |       |       |
| Bilanci i përgjithshëm (milionë €)                     | 98    | 47    | -138  | -67   | -77   |
| Bilanci i përgjithshëm (% BPV)                         | 4.0   | 1.9   | -5.4  | -2.9  | -3.0  |
| <b>Llogaritë e jashtme</b>                             |       |       |       |       |       |
| Bilanci i llogarive rrjedhëse (%BPV)/ <sup>2</sup>     | -32.8 | -26.6 | -26.3 | -31.5 | -29.2 |
| Asistenca e huaj (milionë €)                           | 887   | 688   | 570   | 553   | 546   |
| Dërgesat e punëtorëve (milionë €)                      | 341   | 341   | 341   | 345   | 347   |
| <b>Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)</b>             | 3.6   | 1.2   | -1.5  | -2.1  | -1.8  |

v= vlerësim, p = projeksione; 1/ Përfshihet grantet e dhëna nga donatorët dhe shpenzimet jashtëbuxhetore të UNMIK-ut dhe donatorëve; 2/ para granteve të donatorëve

Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore dhe FMN-së (Banka Botërore, *Dokumenti i Strategjisë Kalimtare për Kosovën 2006-2007*)

Reformat e pasluftës në politika tatimore dhe administrim të tyre kanë gjeneruar të ardhura të konsiderueshme vendore: mes 2003 dhe 2004 rritja e shpenzimeve kapitale dhe pagave e rrogave publike rezultuan në një deficit fiskal prej 5.4 përqind të BPV-së.

Shërbimet e reja financiare dhe bankare gati kanë trefishuar vëllimin e kredisë në periudhën 2001-2005. Megjithatë, kushtet dhe afatet e kredive nuk i përgjigjen plotësisht nevojave të ndërmarrjeve. Përqindja e depozitave në BPV – pa anashkaluar rritjen prej 15.4% më 2006 – vazhdon të jetë më e ultë sesa në vendet fqinje.

Sektori i ndërmarrjeve në Kosovë dominohet nga mikro-ndërmarrjet që punësojnë më pak se pesë punëtorë dhe kryesisht të angazhuara në tregti dhe shërbime tjera. Bujqësia kontribuon rreth 25% të BPV-së në Kosovë, punëson më shumë se gjysmën e popullsisë rurale punëtore si dhe siguron rreth 11 % të vlerës totale të eksporteve. Prodhimtaria bujqësore mbetet shumë më e ultë sesa ajo e vendeve fqinje, derisa sektori përballet me një konkurrencë të fortë të produkteve të importuara.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI) i Kosovës është 0.734. Më 2005, përqindja e popullsisë që jetonte nën linjën e varfërisë ishte 37 përqind, derisa nën linjën e varfërisë ishin 11.4 përqind, ndërsa indeksi i varfërisë së skajshme ishte 4.9 përqind. Varfëria prek më së shumti amvisëritë e udhëhequra nga femrat, pakicat etnike jo-serbe, personat e papunë dhe punëmarrësit e pasigurt (kryesisht në ekonominë joformale). Papunësia dhe kualifikimi i ultë arsimor janë emëruesit më të rëndësishëm të varfërisë:

80% e të varfërve të skajshëm kanë arsim fillor apo më pak, derisa 15.6% të këtyre në varfëri të skajshme janë të papunë.

Popullsia e Kosovës është duke u rritur më shpejt sesa popullsia e vendeve fqinje: meshkujt dhe femrat e reja me më pak se 25 vjet janë 51.5 përqind të popullsisë (21.4% janë 15-24 vjet). Në pesë vitet e ardhshme, rreth 200,000 të rinj do të arrijnë në moshën e punës – dhe rreth 55.000 prej tyre do të hyjnë në tregun e punës – derisa numri i personave që arrijnë në moshën e pensionimit (65 vjet) do të jetë rreth 60,000.

Më 2002, vetëm 13% e popullsisë kishte arritur arsim të lartë (18% e meshkujve dhe 8% e femrave), si dhe 44% kishte përfunduar arsimin e mesëm. Tabela në vijim tregon që sistemi arsimor i Kosovës, përkundër përparimit, është ende i dobët në tejkalimin e përjashtimit, me rreth 36% të rinisë 15-24 vjetësh i përkasin komunitetit RAE që ka më pak se arsimi fillor më 2004.

### Vijimi shkollor i rinisë, sipas gjinisë, grup-moshës dhe etnisë

| Vijueshmëria më e lartë | Total | Meshkuj | Femra | 15-19 | 20-24 | Shqiptarë | Serbë | RAE  | tjerë |
|-------------------------|-------|---------|-------|-------|-------|-----------|-------|------|-------|
| Më pak se fillor        | 2.7   | 2.9     | 2.4   | 4.0   | 1.8   | 1.6       | 2.41  | 35.7 | 0.0   |
| Fillor                  | 9.7   | 11.3    | 8.2   | 10.9  | 8.2   | 9.1       | 8.43  | 30.9 | 10.7  |
| Profesional             | 16.5  | 16.7    | 16.2  | 19.8  | 16.2  | 17.9      | 4.82  | 4.8  | 3.6   |
| Shkolla e mesme         | 54.2  | 55.9    | 52.6  | 59.9  | 52.6  | 53.4      | 77.11 | 21.5 | 75.0  |
| Universitet e më lart   | 16.9  | 13.2    | 20.7  | 5.4   | 20.7  | 18.0      | 7.23  | 7.1  | 10.7  |
| Total                   | 100   | 100     | 100   | 100   | 100   | 100       | 100   | 100  | 100   |

Burimi: Corbanese, V., Rosas, G., *Tranzicioni i rinisë drejt punësimit të ndershëm: Fakte nga Kosova*, ILO Gjenevë 2007

Fuqia punëtore më 2004 përbënte 46.2% të popullsisë së moshës së punës (15 e më shumë), shkalla më e ultë në rajonin e EJK-së. Dallimi më i vrazhdë në kuptimin e shkallës së aktivitetit është në lidhje me gjininë. Derisa shkalla e aktivitetit tek meshkujt më 2004 ishte 68.1 përqind, vetëm 25.3 përqind e grave ishte ekonomikisht aktive, me pjesëmarrje prej 37 përqind më të ultë sesa mesatarja e BE-së. Në të njëjtin vit, më shumë se gjysma e njerëzve ekonomikisht joaktivë ishin në grup-moshën 25-39.

### Indikatorët kryesorë të tregut të punës 2001 – 2004

|                         | 2001   |      | 2002   |      | 2003   |      | 2004   |      |
|-------------------------|--------|------|--------|------|--------|------|--------|------|
|                         | Gjithë | Gra  | Gjithë | Gra  | Gjithë | Gra  | Gjithë | Gra  |
| Shkalla e pjesëmarrjes  | 47.0   | 27.0 | 52.8   | 34.5 | 50.3   | 29.5 | 46.2   | 25.3 |
| Shkalla e inaktivitetit | 53.0   | 73.0 | 47.2   | 65.5 | 49.7   | 70.5 | 53.8   | 74.7 |
| Shkalla e papunësisë    | 57.0   | 70.0 | 55.0   | 74.5 | 49.7   | 71.9 | 39.7   | 60.7 |
| Shkalla e punësimit     | 20.0   | 8.0  | 23.8   | 8.8  | 25.3   | 8.3  | 27.9   | 9.9  |
| Raporti i papunësisë    | 27.0   | 19.0 | 29.1   | 25.7 | 25.0   | 21.2 | 18.3   | 15.4 |

Burim: Adaptim në bazë të Hulumtimeve të Fuqisë Punëtore (2001-2004)

Mes 2001 dhe 2004, shkalla e punësimit nuk ka ndryshuar aq shumë, duke u ngritur me më pak se 8% në përgjithësi. Niveli absolut i punësimit në Kosovë, tek niveli 27.9 përqind i popullsisë në moshën e punës, është alarmues. Rritjet vjetore të punësimit më shumë prekin meshkujt sesa femrat (4%, respektivisht 1.6%), si dhe grup-moshën 25-39 vjet.

Pjesa e punësimit në sektorin privat është 40% të punësimit të përgjithshëm, derisa pjesa e mbetur kryesisht është e punësuar në sektorin publik dhe mbetja në ndërmarrjet shoqërore (49.1% dhe respektivisht 5.7%). Të dhënat paraprake për tremujorin e parë të vitit 2006 tregojnë që punësimi është në rritje në sektorin shtetëror dhe atë privat, si dhe duke u zvogëluar në ndërmarrjet publike dhe shoqërore. Megjithatë, trendi i rritjes së punësimit publik do të ndërpritet, pasi administrata shtetërore pritet të zvogëlohet. Zvogëlimi i fuqisë punëtore në fuqinë punëtore do të vënë presion shtesë në tregun e punës së Kosovës.

Përqindja e punësimit të përkohshëm (stinor) në punësimin e përgjithshëm u rrit në mënyrë dramatike në periudhën 2003-2004 (nga 14 në 65%), derisa puna me orar të përgjysmuar mbetet stabile në 30% të punësimit të përgjithshëm. Ministria e Ekonomisë dhe Financave raportoi më 2004 një rritje të punëtorëve të sapo-regjistruar në tregtinë e imtë dhe me shumicë (10%), shërbime (8 përqind) dhe bujqësi (1 %), si dhe një zvogëlim në industri (17.7 %), transport (2 përqind) dhe ndërtimtari (1 përqind). Procesi i rishpërndarjes së punës ka prekur në mënyrë disproporcionale sektorin e prodhimit, duke rezultuar në zvogëlimin e pjesës së punësimit në industri, derisa pjesa e sektorit shërbyes u zgjerua. Sektori prodhues ka filluar ringjalljen e tij në dy vitet e fundit, derisa zgjerimi i punësimit në bujqësi reflekton rishpërndarjen e fuqisë punëtore drejt një sektori ku prodhimtaria është më e ultë, por edhe lëvizjen nga papunësia drejt mbijetesës bujqësore.

Si në shumë vende në rajon, një burim i ri i punësimit në Kosovë ka qenë sektori në rritje i vetë-punësimit. Pjesa e vetë-punësimit tregon një rritje stabile – edhe pse të vogël (1.8% vjetore). Përqindja e të vetë-punësuarve në numrin total të punëtorëve është 25.6 përqind, derisa përqindja e femrave është dyfishuar në krahasim me vitin 2003 (prej 5.8 në 11.9 përqind). Ekziston një ndërlidhje pozitive mes arsimit dhe punësimit: shkalla e punësimit të punëtorëve me arsim të lartë është 50 përqind më e lartë se ajo e njerëzve me arsim të mesëm.

Ekonomia joformale luan një rol të rëndësishëm në tregun e punës, sidomos për punëtorët e rinj. Rreth 50% e gjithë punësimit në Kosovë ishte joformal më 2003. Kjo shifër konfirmohet nga të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, e cila raporton një numër të punëtorëve të regjistruar për shkak të tatimit në pagë me rreth 160.000 njësi, në krahasim me numrin e vlerësuar të punëtorëve nga LFQ-ja deri në 350,000.

Paga mesatare mujore në sektorin privat (në terme nominale) ishte €220 më 2003, €204 më 2004, €217 më 2005 dhe €236 më 2006. Punëtorët e arsimuar në profesione të kualifikimit të lartë (si shërbimet e sigurimit dhe ato financiare) fitojnë premium në rrogë, derisa disa grupe të caktuara të popullsisë – si njerëzit e rinj, gratë dhe pakicat etnike – përballen me mungesa thelbësore në paga.

Një nga atributet më problematike të tregut të punës në Kosovë është papunësia tejet e lartë dhe e vazhdueshme. Shkalla e përgjithshme e papunësisë më 2004 ishte 39.7%. Të rinjtë kanë gati dyfish më shumë mundësi të jenë të papunë sesa të moshuarit, si dhe kanë pasur më 2004 një shkallë papunësie prej 49.5 përqind (45.7 përqind të femrave dhe 52.8 përqind të meshkujve).

Një çështje tjetër brengosëse është kohëzgjatja e papunësisë (rreth 88 përqind të papunëve janë të papunë në afat të gjatë). Për të rinjtë, gjatësia e papunësisë, e kombinuar me faktorë tjerë kontribuon në mënyrë të dukshme në cënueshmërinë e tyre. Situata paraqitet si kritike për gjitha grupet e pakicave, por sidomos për të rinjtë e komunitetit RAE (72.2 përqind papunësi afatgjate) dhe për serbët e rinj (88.6 përqind).

Shumica e resurseve financiare në dispozicion të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale thithen nga sistemi i mbrojtjes sociale. Resurset publike më së pari u vunë në dispozicion për financimin e tregut aktiv të punës vetëm më 2005.

Korniza e legjislacionit të mbrojtjes së punësimit (LMP) përbëhet nga një numër Rregulloresh të UNMIK-ut dhe Ligjesh të Kuvendit të Kosovës, korniza e mbrojtjes së punësimit përfshin Rregulloren e UNMIK-ut mbi Ligjin Bazë të Punës 2001/27, Ligji mbi Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, Ligji për Sigurinë Profesionale, Shëndetin dhe Mjedisin e Punës Nr. 2003/19, Ligji mbi Metodologjinë e përcaktimit të nivelit të pensionit bazë Nr. 2002/1, Ligji mbi Skemën e Asistencës Lokale Nr. 2003/15, Ligji mbi Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar Nr. 2003/23, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17, Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Martirëve, Invalidëve të Punës, Invalidëve të Luftës dhe Veteranëve të UÇK-së Nr. 02/L-2.

Programet trajnuese të tregut të punës ofrohen përmes një rrjeti të tetë qendrave të trajnimit profesional dhe një numër institucionesh të trajnimit partnere me Ministrinë e Punës, veçanërisht me MASHT-in bazuar në studimin mbi qasjen ndër-sektoriale në arsim.

Vizioni i Qeverisë së Kosovës është i përqendruar në rritjen e cilësisë si dhe sasisë së punësimit dhe në luftimin e përjashtimit nga tregu i punës, në përputhje me *Udhëzimet e Integruara të BE-së për Rritje dhe Punësim*.

Prioritetet kryesore të Projekt-Strategjisë së Punësimit 2008-2013 janë: (i) implementimi i politikave ekonomike dhe sociale të përqendruara në punësim; (ii) implementimi i politikave arsimore dhe trajnuese për avancimin e punësimit dhe nxitjen e prodhimitarisë; (iii) implementimi i politikave të tregut të punës që përmirësojnë prodhimtarinë dhe adresojnë përjashtimin.

Projekt-Strategjia e Punësimit në Kosovë 2008 – 2013 përfaqëson një dokument qenësor dhe me rëndësi të madhe, me mision të definuar të përcaktimit dhe trajtimit të politikave, të cilat synojnë promovimin e një pjesëmarrjeje më të lartë të popullsisë së Kosovës në tregun e punës, si dhe njëkohësisht synon kontributin në theksimin e masave të tregut aktiv të punës që përcaktojnë tri synime kryesore në procesin e integritet: punësimi i plotë, përmirësimi i cilësisë dhe produktiviteti i cilësisë dhe kohezionit social si dhe përfshirjen sociale.

Projekt-Strategjia e Punësimit në Kosovë është dokument që do të integrohet brenda Strategjisë së Zhvillimit të Përgjithshëm të Kosovës, si dhe do të listohet në proceset buxhetore për ndarje të fondeve.

Implementimi i kësaj Strategjie nuk do të jetë përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, por përgjegjësia e implementimit do të shpërndahet gjithashtu tek Ministrinë tjera, si dhe në nivelin lokal.

Projekt-Strategjia e Punësimit në Kosovë përbëhet nga shtatë pjesë: (i) në pjesën e parë paraqitet konteksti ekonomik dhe social i Kosovës; (ii) në pjesën e dytë, ekziston analiza e tregut të punës, duke trajtuar trendet demografike, arsimore, tregut të punës, zhvillimi i punësimit, politikat institucionale dhe tregut të punës, legjislacionin për mbrojtjen e punësimit, programet e tregut aktiv të punës dhe problemeve kryesore për t'u adresuar; (iii) në pjesën e tretë janë paraqitur prioritetet e politikave me theks të veçantë në politikat sociale dhe ekonomike të drejtuara kah punësimi, politikat e trajnimit dhe arsimit për avancimin e punësimit dhe fuqizimit të prodhimitarisë, politikat e tregut të punës që përmirësojnë prodhimtarinë dhe trajtojnë përjashtimet; (iv) në pjesën e katërt trajtohen qëllimet, synimet dhe detyrat e politikave të punësimit, duke marrë parasysh synimet dhe qëllimet specifike të punësimit; (v) në pjesën e pestë paraqiten politikat vepruese dhe implikimet financiare të tyre, duke u përqendruar në zgjerimin dhe përmirësimin e investimeve në kapitalin njerëzor, sigurimin e tregut përfshirës të punës, zvogëlimin e shkallës së punësimit në ekonominë joformale, krijimi i një modeli për sistemin e sigurimit social; (vi) në pjesën e gjashtë trajtohet zhvillimi i mekanizmave të implementimit dhe koordinimit; (vii) dhe në pjesën e fundit (të shtatë), monitorimi dhe vlerësimi.

Strategjia është hartuar si rezultat i përkushtimit dhe kontributit të ekspertëve nga pesë (5) ministri, ekspertë të organizatave të punëtorëve dhe punëdhënësve, ekspertë të ILO-s, ekspertët e UNDP-së, propozimeve të ekspertëve të BE-së, ekspertët ndërkombëtarë, si dhe ekspertët e Entit Statistikor të Kosovës. Puna është menaxhuar dhe koordinuar nga ekspertët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe UNDP-ja.

Përpjekjet e Qeverisë në këtë nën-fushë janë prekur gjithashtu nga mjetet e kufizuara buxhetore si dhe presioni i kërkesës së ultë për punësim. Papunësia në Kosovë vlerësohet si një nga problemet kryesore të shoqërisë së Kosovës, gjë që sipas statistikave më të reja është rreth 39-42%. Kjo papunësi është sidomos e theksuar tek rinia, njerëzit me papunësi afatgjate, gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, në përgjithësi tek grupet e cënueshme. Infrastruktura aktuale ligjore që synon të trajtojë aspektin mbrojtës të punësimit në Kosovë ende nuk është e kompletuar. Ligji i punës dhe marrëdhënieve të punës edhe pse i miratuar, qëndron si bazik, siguron mbulim të kufizuar të disa fushave që në disa vende të Evropës tanimë është i fiksuar. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive që ishte nënshkruar më 2004 nga Sindikatat dhe Oda Ekonomike e Kosovës përcakton masat aktuale për mbrojtjen në punë, (pushimi vjetor dhe mbrojtja dhe sigurimi në vendin e punës), si dhe siguron normat që rregullojnë të ardhurat minimale dhe aktivitetet sindikale. Por pasi kjo Marrëveshje nuk ishte pranuar nga Qeveria më 2005, nuk ka filluar zbatimin e saj në përgjithësi.

Institucioni kryesor përgjegjës për politikën e punësimit në nivelin qendror është MPMS-ja, ndërsa ekzistojnë dy Departamente brenda MPMS-së të cilat merren kryesisht me politikën e punësimit. I pari është Departamenti i Punës dhe Punësimit, i cili ndahet në tre sektorë (divizione): Divizioni i Kualifikimeve Profesionale, Divizioni i Punësimit dhe Divizioni i Ligjit mbi Punën dhe Marrëdhënieve në Punë. I dyti është Agjencia Ekzekutive e Inspektoratit të Punës, i cili ka inspektorë pune edhe në nivelin komunal.

Brenda një kornize të qëndrueshme fiskale të paraqitur brenda KASH-it, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në zhvillimin dhe analizën e opsioneve për përmirësimin e kushteve për persona të përjashtuar. Siç është përmendur më herët, duke marrë parasysh ashpërsinë e problemit, ky është prioritet i përhershëm i Qeverisë në afat të gjatë. Ne synojmë të punojmë afërsisht me partnerët tanë në bashkësinë ndërkombëtare për zhvillimin e reformave strukturore për përmirësimin e indikatorëve të tillë.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë thith rreth 20 përqind të buxhetit total dhe përbën përfitimet e asistencës sociale, sistemin e pensionit bazë si dhe pensionin e paafëtisë, plotësuar me skema speciale për invalidë të luftës. Në krahasim me mesataren rajonale, shpenzimi publik në shëndetësi (4.5 përqind të BPV-së), mbrojtje sociale (5.8 përqind) dhe arsim (6.1 përqind të BPV-së) mbetet i ultë. Sigurimi i asistencës sociale është i kufizuar në kuptimin e shpenzimeve të përgjithshme publike, shumë e përfitimeve dhe mbulueshmërinë e varfërisë së skajshme, me gabime të mëdha të përjashtimit që reflektojnë kufizimin e parave të Qeverisë së Kosovës.

Sipas MPMS-së, 37 % e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri, ndërsa 12-15% e kësaj përqindjeje jeton në varfëri të skajshme. Megjithatë, Institucionet Kosovare qysh prej themelimit të tyre kanë bërë përpjekje për të krijuar një sistem të mirëqenies sociale, për të ndihmuar familjet dhe njerëzit e rrezikuar. Aktualisht, shërbimet sociale ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale (QPS) në nivelin lokal, por që menaxhohen ende nga MPMS-ja dhe nuk i përkasin komunave. Gjithashtu, një pjesë e shërbimeve ofrohen nga OJQ-të. *Në nivelin lokal paraqitet një sistem i dyfishtë të shërbimeve publike dhe mbrojtjes sociale:* 1) QPS -të që janë faktorët kryesorë, siç është përmendur më herët, nën administrimin e MPMS-së, si dhe 2) komunat (Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), që kanë vetëm rol anësor në ofrimin e shërbimeve. Duhet përmendur që brenda MPMS-së ekziston Departamenti i Mirëqenies Sociale me katër Divizione; Divizioni Analizave Buxhetore dhe Vlerësimit

të Varfërisë, Divizioni i Shërbimeve Sociale, Divizioni i Ndhimave Sociale dhe Divizioni i Perkuajdesjes Institucionale si dhe , Instituti i Politikave Sociale, me dy divizione: Divizioni i Këshilltarëve dhe Divizioni i Hulumtuesve.

Programet parësore që implementohen nga institucionet e Kosovës janë fokusuar në shpërndarjen e asistencës sociale, pagesat e pensioneve dhe shërbimet tjera profesionale sociale për individë dhe familje me probleme sociale (si mbrojtja e fëmijëve, delikuenca, jetimët, viktimat e dhunës në familje, njerëz me aftësi të kufizuar, të moshuar, etj.). Programet kryesore janë përfitimi me një cak të kufizuar të asistencës sociale, me rrjetin e Qendrave për Punë Sociale në secilën komunë, duke ofruar asistencë sociale dhe duke ofruar konsultime dhe shërbimi referimi për familjet nevojtare, si dhe Zyrat Rajonale të Administratës Pensionale që kanë rol të madh në këtë aspekt. Ato ofrojnë shërbime për realizimin e përfitimeve nga skemat pensionale. Programet e përfitimit në Kosovë (pensionet dhe asistencë sociale), sipas MPMS-së, mbulojnë përtej 325,000 persona, që do të thotë rreth 16% e popullsisë që kanë qasje në një nga skemat e lartpërmendura. Dërgesat nga jashtë kanë rol tejet të rëndësishëm për ekonominë familjare dhe ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e varfërisë.

Skemat e pagesave sociale në Kosovë – Synimi i përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është të zhvillojë dhe përmirësojë rrjetin e mbrojtjes sociale për më të varfrit e shoqërisë. Skemat e përfitimit janë në kesh, ose në të ardhmen mund të përfshihen në skemat e punës publike dhe programe që mund të prodhojnë të hyra, gjë që mund të krijojë asete. Përzgjedhja në programet e asistencës sociale është përcaktuar sipas kushteve të vendit, kushteve kulturore dhe socio-ekonomike, të ardhurave të vendit, si dhe burimet e mundshme për asistencë sociale, si dhe roli i shoqërisë civile që nënkupton rrjetin joformal (familja dhe të afërmit).

Skema e asistencës sociale – synon zvogëlimin e varfërisë. Kjo skemë është paraqitur për herë të parë në vitin 2000, si dhe është rishikuar në dhjetor të vitit 2003. Është publike, e përgjithshme dhe e financuar nga fondet publike. Skema ndërtohet me kontrollimin e nevojave (varfërisë dhe të ardhurave) dhe kriteret e aplikuar në aspektin thelbësor të familjeve. Ajo aplikohet për familje dhe individë me nevoja urgjente dhe speciale, duke u paguar në para të gatshme, në një pagesë. Skema përfshin dy lloje përfituesish: a) Kategoria e parë – synon të sigurojë mbështetje financiare për ato familje që nuk kanë asnjë anëtar të familjes në gjendje pune, apo nuk ka anëtar që pret të jetë në gjendje të punojë; b) Kategoria e dytë – synon t'i ofrojë mbështetje financiare familjeve që kanë anëtarë të familjes në gjendje të punës, por që nuk mund të gjejnë punësim. Shuma maksimale mujore e asistencës sociale është fiksuar sipas linjës së varfërisë së skajshme (shporta ushqimore) dhe përcaktohet në bazë të numrit të anëtarëve të familjes. Është miratuar çdo vit nga Qeveria, duke marrë parasysh ndryshimet e shpenzimeve të jetesës. Numri i përfituesve që marrin këtë skemë është mbi 37,000 familje, me mbi 162.000 anëtarë familjeje, ku mesatarja e shumës së përfituar për një familje është 52.00 euro në muaj. Gjatë dy viteve të fundit numri i përfituesve të skemës së asistencës sociale është zvogëluar për 4000 familje (2000 familje në vit), ndërsa zvogëlimi është më i theksuar në kategorinë e dytë.

Pensionet bazë (të moshës) – janë skemë e përgjithshme e financuar nga Qeveria. Ajo përbëhet nga një tarifë mujore bazë për gjithë qytetarët e Kosovës dhe refugjatët e Kosovës që janë 65 vjeç apo më shumë (pavarësisht nëse kanë punuar apo jo, dhe duke mos marrë parasysh a marrin pensione nga jashtë apo jo). Kështu, ky është program për të ndihmuar të moshuarit. Kjo skemë ka filluar aplikim në vitin 2002, si dhe është implementuar në linjë të barabartë me varfërinë e skajshme (shporta ushqimore). Në fillim skema ishte 28 euro/muaj dhe miratohet çdo vit për të reflektuar rritjen e kostos së jetesës. Më 2003, shumën u rrit deri në nivelin e 35 eurove, derisa për vitet 2004/05/06/07 ka qenë në nivelin prej 40 eurosh në muaj. Duke filluar nga ky vit (2008), shumën e pagesës do të ndryshojë, për pensionistët që kanë kontribuar dhe që mund të argumentojnë që përvoja e tyre e punës është më e gjatë se 15 vjet, si dhe që është 65 vjeç. Kjo kategori e njerëzve do të përfitojë 75 euro në muaj, ndërsa

numri i përfituesve mund të jetë deri në 30,000. Por, pagesa për ata që janë 65 vjeç e më shumë (përfituesit e skemës së pensionit bazë) do të mbetet e njëjtë – 40 euro në muaj. Numri i përfituesve të skemës së pensioneve bazë mbi 65 vjeç në janar 2008 ishte 132,421 pensionistë.

Skema e Invalidëve të Luftës dhe Familjeve të Martirëve të Luftës – kjo skemë ishte ngritur nga MPMS-ja me synim të ndihmës së invalidëve të luftës (duke përfshirë invalidët civilë të luftës), familjeve të martirëve të luftës, familjeve të personave të zhdukur, kujdestarëve të invalidëve të luftës, derisa aktualisht nga kjo skemë përfitojnë më shumë se 9500 individë. Skema ka qenë në implementim qysh prej vitit 2001, derisa aktualisht është në implementim në bazë të Ligjit mbi Përfitimet për Invalidët e Luftës dhe Familjet e tyre (2006). Shuma e përfitimit për një familje apo invalid mund të dallojë, në bazë të nivelit të invaliditetit dhe në bazë të numrit të personave të vrarë apo të humbur në një familje. Pagesa prej 54.60 eurosh është shuma minimale për përfituesin si invalid civil si dhe varet nga invaliditeti. Ekziston edhe shuma maksimale prej 351 eurosh për familje me 3-4 anëtarë të familjes të vrarë si ushtarë gjatë luftës.

Skema e personave me paaftësi – është e rregulluar me Ligjin mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (miratuar më 2004) dhe është zbatuar qysh prej vitit 2004. Ekzistojnë më shumë se 17675 përfitues dhe kufizimi i tyre i aftësisë së punës është 100%. Shuma mujore e pagesës për një përfitues ka filluar me 40 euro prej fillimit të vitit 2004 dhe ka mbetur e pandryshuar.

Sa i përket stimulimit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, MPMS ka hartuar Projektligjin për Aftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ky Projektligj është hartuar qysh në vitin e kaluar dhe është proceduar në Kuvend gjatë këtij viti. Ai parasheh aftësimin, trajnimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe punësimin e tyre. Projektligji është miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës, mirëpo i është kthyer Qeverisë për shkak të kostos tejet të lartë buxhetore. Aktualisht MPMS-ja dhe MEF-i janë duke rishikuar koston buxhetore të Projektligjit. Pritet që së shpejti të miratohen rekomandimet e dala nga të dy ministratë, dhe më pas do të procedohet për shqyrtim dhe miratim tek Komisionet përkatëse të Kuvendit të Kosovës.

Skema e pensioneve të Trepçës – Kjo skemë është e dedikuar vetëm për minatorët e minierave nëntokësore. Kjo skemë ka filluar funksionimin më 1 korrik 2003 dhe përfshin mëse 4642 minatorë të Kosovës. Shuma mujore për vitet 2003/04 ka qenë 40 euro, por është 50 euro prej vitit 2005.

Legjislacioni aktual që rregullon gjitha këto skema dhe që është ende në fuqi është: dy ligje nga koha e ish-Jugosllavisë, si Ligji për Mbrojtjen Sociale në Kosovë (1976) dhe Ligji mbi Martesat dhe Marrëdhëniet Familjare (1984), Rregullorja mbi Invalidët e Luftës dhe familjet e tyre (2000/66), Rregullorja Nr. 2001/35 për Ligjin mbi Pensionet Bazë (2002), Ligji mbi Asistencën Sociale (2003), Ligji mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (2004), Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare (2005), Ligji mbi Përfitimet për Invalidët e Luftës dhe Familjet e tyre (2006).

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e punësimit dhe politikave sociale, MPMS-ja, mes tjerash, do të miratojë Ligjet mbi Sigurimet Pensionale si dhe për Mbështetjen e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, si dhe ndryshimin e plotësimin e Ligjit për Vlerat e Luftës, do të themelojë njësi të reja në Inspektoratin e Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, bashkë me 10 inspektorë të rinj në këtë organ, do të rishikojë skemën sociale brenda aktiviteteve në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Skemat Sociale, si dhe do të hartojë dhe miratojë një Plan Veprimi për monitorimin e subjekteve që administrojnë këtë skemë. Për më tepër, do të miratohet Strategjia për Punësim dhe do të fillohet implementimi i saj, si dhe një numër aktiviteteve me synim të përfortimit të kapaciteteve administrative.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e punësimit dhe politikave sociale, MPMS-ja, mes tjerash, do të miratojë ndryshimet në Ligjin mbi Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9; do të fokusohet në përfundimin e kapaciteteve institucionale të inspektorateve të punës dhe rekrutimin e tyre, si dhe në përgatitjen e strategjisë afatmesme për rikualifikimin e fuqisë punëtore.

#### g. Arsimi dhe Hulumtimi

Parimi themelor në BE është që Shtetet Anëtare të jenë në krye të arsimit dhe trajnimit, ndërsa Komisioni Evropian punon bashkë me Shtetet Anëtare në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Arsimi për herë të parë është njohur formalisht në Traktatin e themelimit të Komunitetit Evropian të nënshkruar në Mاستriht më 1992. Traktati i Mاستrihtit hapi rrugën për arsim dhe trajnim profesional në BE, duke specifikuar në Nenin 149 (1), që " Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e arsimit cilësor duke inkurajuar bashkëpunimin mes Shteteve Anëtare dhe sipas nevojës, duke mbështetur dhe plotësuar veprimet e tyre, derisa respekton plotësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen e mësimdhënies dhe organizimin e sistemeve arsimore dhe larminë e tyre kulturore e gjuhësore."

Në fushën e arsimit, prioriteti i Qeverisë së Republikës së Kosovës është fokusuar në reformimin e sistemit arsimor, duke e kthyer atë në një sistem funksional që shërben shoqërinë e ndërtuar në njohuri, ekonomi dhe punësim. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të qeverisjes, udhëheqësisë dhe menaxhmentit në sistemin arsimor do të sigurojë mundësi të barabarta të përfshirjes së gjeneratave të reja në arsimin fillor dhe të mesëm, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm dhe të shëndoshë fizike për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Duke ngritur ura stabile mes arsimit dhe zhvillimit social e ekonomik, rëndësia e trajnimeve profesionale dhe arsimit të lartë do të ngritet në listën e prioriteteve të kërkesës së tregut të punës.

MAShT-i, përmes Departamentit për Arsim të Lartë, mbikëqyr dhe planifikon zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë në bazë të Ligjit Nr. 2002/03 mbi Arsimin e Lartë (2003). Kështu, është miratuar Strategjia Zhvillimore e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015 nga Qeveria e Kosovës, e cila është publikuar në shkurt 2008. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është zhvillimi i një sistemi efikas të arsimit të lartë, i cili do të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së shoqërisë së Kosovës, duke ofruar arsim dhe kërkim cilësor, me mundësi të barabarta për të gjithë.

MAShT-i tanimë ka filluar me implementimin e Strategjisë së Arsimit Para-Universitar 2007-2017. Kështu, Planet e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie janë hartuar, derisa po ndërtohen mekanizmat për kontrollimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin para-universitar dhe universitar për të siguruar avancimin e gjendjes materiale të arsimit, përmes zëvendësimit të sistemit aktual linear të pagave të mësimdhënësve me një sistem të diskriminimit pozitiv në paga, në pajtim me kriteret e licencimit. Në anën tjetër, krijimi i mekanizmave për sigurimin e menaxhimit efektiv të burimeve financiare për zhvillimin e arsimit të lartë do të mundësojë ndërtimin e një infrastrukture adekuate funksionale të arsimit të lartë, ndërtimit të kapaciteteve në punën kërkimore-shkencore dhe promovimin e trajnimeve profesionale dhe kërkesat e mësimit gjatë gjithë jetës. Kjo periudhë gjithashtu shënon edhe implementimin e Strategjisë së Arsimit për Komunitetin RAE. Vlen të përmendet që gjitha aktivitetet në lidhje me arsimin para-universitar MAShT-i i realizon përmes Departamentit për Arsim Para-Universitar, i cili mbikëqyr Zyrtat Rajonale të Arsimit dhe koordinon aktivitetet me Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Në aspektin e strukturës institucionale, është me rëndësi të përmendet edhe themelimi i Agjencisë së Akreditimit brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Përveç ligjeve dhe strategjive të lartpërmendura, masat legislative në vijim rregullojnë aktualisht sistemin e arsimit dhe kërkimit në Kosovë: Ligji Nr. 2002/02 mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Ligji Nr. 02/L-52 mbi arsimin parashkollor, Ligji Nr. 2004/42 mbi Veprimtarinë e Kërkimeve Shkencore, Ligji Nr. 2004/37 mbi Inspektimin e Arsimit në Kosovë, Ligji Nr. 02/L-24 për arsimin dhe trajnimin e të rriturve, Ligji Nr. 02/L-67 mbi Publikimin e Resurseve Mësimdhënëse, materialeve të leximit dhe dokumentacionit pedagogjik. Më 2006, MASHT-i miratoi 12 Aneksa për implementimin e UA Nr. 14/2006 i cili merret me organizimin dhe vlerësimin e provimit përfundimtar për arsimin e mesëm të lartë. Më 2007 MASHT-i miratoi 40 UA mbi kohëzgjatjen e programit arsimor parashkollor, Këshillin për Miratimin e Grantit të Arsimit, Licencimit të Mësimdhënësve, Institutin Pedagogjik të Kosovës, etj. Një numër i madh i këtyre Udhëzimeve merren me implementimin e kurrikulumit për aftësimin profesional (në fushat e ekonomisë, grafikë, administratës në nivel të parë, etj). Në janar 2008, MASHT-i miratoi UA Nr. 15/2007 mbi Kalendarin e Vitit Shkollor 2007/2008.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e arsimit dhe kërkimeve, MASHT-i, mes tjerash, do të mundohet të sigurojë rritje graduale të buxhetit të arsimit në pajtim me procedurat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe në implementimin strikt të strategjive të arsimit dhe projekteve në lidhje me Kornizën e rishikuar Afatmesme të Shpenzimeve 2008-2011. Tutje, MASHT-i ka planifikuar një studim fizibiliteti mbi të gjithë sektorët e arsimit, rekomandimet e të cilit do të trajtohen në rrugën e avancimit. Vlen të përmendet gjithashtu ofrimi i qasjes përfshirëse ndaj arsimit, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke trajnuar mësimdhënësit dhe duke siguruar infrastrukturën e nevojshme shkollore. Theksi do të vihet edhe në ndërtimin e hapësirave të reja shkollore dhe pajisja e tyre, Plani i Veprimit për implementimin e Strategjisë për Arsimin Para-Universitar do të hartohet, ndërsa Strategjia e Arsimit për Komunitetin RAE do të zbatohet.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e arsimit dhe kërkimeve, MASHT-i, mes tjerash, do të konsolidojë plotësisht Agjencinë Kosovare të Akreditimit, si dhe të themelojë Këshillin Nacional të Shkencës, duke shtruar kështu rrugën për procesin e hartimit të Strategjisë Nacionale të Shkencës. Në fushën legislative, MASHT-i parashikon ndërmarrjen e disa hapave të rëndësishëm, si: hartimi i udhëzimeve të reja administrative për implementimin e Ligjit mbi AAP-në, hartimin e udhëzimeve administrative për funksionalizimin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Gjithashtu, hartimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe miratimi i Udhëzimeve Administrative mbi monitorimin e kurrikulumeve, librave shkollorë, metodologjinë e mësimdhënies dhe notimit, janë të parashikuar si hapa në synimin e avancimit të aspekteve legislative të arsimit. MASHT ka përgatitur Projektligjin mbi Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, dhe pritet vetëm dekretimi i tij nga Presidenti i Republikës.

### 2.3.2 Politikat Sektoriale

#### a. Industria dhe NVM-të

Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare janë pajtuar mbi Kartën për Ndërmarrjet e Vogël për të përmirësuar mjedisin afarist për ndërmarrjet e vogla. Me inkurajimin e autoriteteve publike në gjitha nivelet për të shkëmbyer përvojat e punës së tyre mbi politikat e kësaj fushe, secili mund të mësojë nga shembujt të cilët kanë funksionuar për të tjerët, duke shpejtuar përmirësimin e tyre.

Përveç Shteteve Anëtare të BE-së, Karta gjithashtu është miratuar nga Norvegjia, shtetet Euro-Mesdhetare, shtetet në Ballkanin Perëndimor dhe nëntë rajonet evropiane. Karta është vërtetuar si vegël e suksesshme edhe për të ndihmuar Kosovën në politikat e saj në NVM në përgatitje për anëtarësim në BE.

Duke marrë parasysh që orientimi përfundimtar i Kosovës është Bashkimi Evropian, mbikëqyrja dhe organizimi i tregtisë, pronës industriale, ndërtimtarisë, hotelerisë, industrisë dhe turizmit janë fusha të përqendrimit special për Qeverinë. Kjo do të kërkojë zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve dhe garantimin e investimeve.

Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës fizike për zhvillimin e NVM-ve në Kosovë, punët kanë zënë vend në programimin e mjedisit të punës, që përfshin parqet industriale, zonat industriale dhe inkubatorët e biznesit.

Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve (si pjesë e MTI-së) ka arritur të krijojë një bazë të shënimeve me informata për më shumë se 100 kompani, si dhe ka përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme për emërimin e anëtarëve të Këshillit Konsultativ për NVM-të. Gjithashtu, kjo Agjenci është përgjegjëse për koordinimin e gjithë punës për implementimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme si dhe përparimit të tyre drejt linjave të veprimit të kësaj Karte.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e industrisë dhe NVM-ve, mes tjerash, MTI-ja do të implementojë strategjinë afatmesme për mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve, duke përfshirë përforcimin e Agjencisë për Mbështetjen e NVM-ve dhe Agjencisë së Promovimit të Investimeve, por edhe implementimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla. Ajo gjithashtu do të përforcojë kapacitetet institucionale dhe implementimin e strategji, planeve të veprimit dhe projekteve konkrete në promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Aspekti institucional përfshin trajnimet për personelin ekzistues, si dhe punësimin e mëtutjeshëm në këto agjenci, miratimi dhe implementimi i një strategjie zhvillimore të sektorit privat, si dhe një plan veprimi afatmesëm për mbështetjen e NVM-ve. Brenda kornizës së promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, aktivitetet përfshijnë: inkurajimi i shfrytëzimit të plotë të inkubatorëve të biznesit, themelimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e të dhënave, themelimin e Parqeve të Biznesit në qytetet e vogla, implementimi i vazhdueshëm i Skemës së Konsulencës dhe Trajnimit Voucher për biznese, promovimi i ndërmarrjeve, si dhe analiza e funksionimit të bizneseve dhe ofrimi i rekomandimeve.

#### b. Bujqësia dhe Peshkataria

Nga i gjithë territori i Kosovës prej 1.1 milionë hektarësh, 53% mund të kultivohet, derisa 41% janë toka bujqësore. Bujqësia është sektori dhe aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik, i cili siguron pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma të vogla, prodhimtari të ultë dhe mungesë të shërbimeve këshilluese. Bujqësia kontribuon rreth 25% të Bruto-Prodhitit Vendor dhe përfaqëson rreth 25% deri në 30% të punësimit total, kryesisht në sektorin joformal, si dhe përbën 16% të vlerës totale të eksporteve.

Vizioni i përgjithshëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Kosovë është “të sigurohet një kontribut i baraspeshuar në ekonomi, mjedis, shoqëri dhe mirëqenie kulturore në zonat rurale të Kosovës si e tërë, përmes partneritetit efektiv dhe fitimprurës mes sektorit privat, qeverisë qendrore dhe lokale dhe komunitetet lokale brenda kontekstit evropian”.

Më 4 prill 2007, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (PZhRB) 2007-2013, i cili përbëhet nga strategjitë sektorale.

Në aspektin e kompletimit të infrastrukturës legislative, MBPZhR ka identifikuar legjislacionin vendor që mundëson implementimin e këtij plani zhvillimor, legjislacionin e përafuar me *Acquis communautaire*. Njëzet e pesë (25) projektligje janë hartuar, prej të cilëve 18 janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe janë shpallur nga PSSP-ja. Shtatë projektligje tjera janë në

procedurën e shqyrtimit dhe miratimit. Disa nga ligjet më të rëndësishme janë miratuar, derisa disa projektligje që ende nuk janë shpallur janë si në vijim: Ligji mbi Peshkatarinë dhe Akuakulturën, për zbatimin e të cilit janë lëshuar dy UA. Ligji mbi Mbrojtjen e Bimëve dhe Ligji mbi Bujqësinë Organike janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe shpallur nga PSSP-ja. Projektligji mbi Mbrojtjen e Larmisë së Bimëve është miratuar nga Kuvendi dhe pret miratimin e PSSP-së, derisa Ligji mbi Ushqimin është në fazën e leximit të dytë në Kuvend, derisa është miratuar në parim gjatë leximit të parë më 29 shkurt 2008.

Në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve brenda Institutit Bujqësor të Kosovës, është pajisur me infrastrukturë moderne për sëmundjet virusale. Laboratori qendror i Institutit është pajisur edhe me aparatet moderne për kontrollimin ditor të analizave fiziko-kimike të ushqimit (njerëzor dhe shtazor) dhe inputeve bujqësore (farës, plehrave dhe pesticideve).

Në aspektin e kompletimit të kornizës institucionale, një Njësi e Implementimit të PZhRB-së 2007-2013 me 13 anëtarë është themeluar, për të mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor/rural në Kosovë, si dhe përafrimin e sektorit me standardet e BE-së. Tutje, është themeluar dhe aktivizuar një Laborator Bulmeti, si dhe Instituti i Vreshtarisë dhe Verës së Kosovës, ndërsa projektet janë iniciuar në rehabilitimin e sistemeve të ujitjes në Istog, Deçan, Viti, Gjakovë, Kaçanik dhe Prizren.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian, me përmirësimin e strukturës së brendshme të MBPZHR-së synohet të qartësohen kompetencat. Në këtë kontekst, UA mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës do të ndryshohet, si dhe do të nënshkruhet një numër Memorandumesh Mirëkuptimi me autoritetet e qeverisjes lokale për të qartësuar kompetencat mes nivelit qendror dhe atij lokal. Miratimi i Ligjit mbi Ushqimin dhe themelimi i Agjencisë gjegjëse për implementimin e tij janë gjithashtu të parashikuara. Përveç themelimit të agjencisë, ky Ligj do të zbatohet përmes një numri Udhëzimesh, një prej të cilëve është UA mbi Organizimin e Agjencisë.

Përveç këtyre, do të hartohet një plan për modernizimin e ndërmarrjeve të prodhimit ushqimor, që do të implementohet përmes një partneriteti të afërt me biznesin privat. Në këtë aspekt, do të ndërmerren aktivitete në ofrimin e ndihmës për këto ndërmarrje në modernizim. Në lidhje me funksionalizimin e Sistemit të Identifikimit të Kafshëve dhe Regjistrimit të Lëvizjes së Kafshëve, do të ndërmerret një fushatë mediatike për vetëdijësimin e bujqve për identifikimin e kafshëve dhe sistemin e regjistrimit. Për më shumë, do të bëhet licencimi për tregjet, subjektet që merren me transportin e kafshëve, si dhe përforcimi i inspektimit të thertoreve dhe funksionalizimi i PDA-ve.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian, do të ndërmerret një reformë e qëndrueshme e tokës dhe mbrojtjes së tokës pjellore nga zhvillimi i paplanifikuar urban, përmes një projekti gjithëpërfshirës. Veprimet e parashikuara përfshijnë hartimin e një strategjie për reformën e qëndrueshme të tokës, implementimi i Ligjit mbi Tokën Bujqësore dhe ndërlidhjen e tij me ligjet tjera relevante, implementimi i UA mbi Ndryshimin e Destinimit të Tokës, riaktivizimin e disa komisioneve qeveritare dhe një numër aktiviteteve informimi.

Në lidhje me modernizimin e ndërmarrjeve bujqësore/ushqimore në pajtim me kërkesat e BE-së, do të përgatitet një program i kësaj fushe për t'u implementuar në bashkëpunim me sektorët e linjës. Në fushën e kontrollit efektiv mbi prodhimin vendor të perimeve, do të vazhdojë zbatimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Bimëve, bashkë me hartimin dhe implementimin e akteve nënligjore, si UA mbi Listat I /A, II/ A dhe IV/ A të bimëve dhe produkteve bimore, sipas kërkesave specifike të BE-së, mbi përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave mbi prodhuesit, përpunuesit, importuesit, shpërndarësit dhe depozituesit, etj. Gjithashtu, do të zërë vend edhe përforcimi i kapaciteteve institucionale me trajnime dhe pajisje për Institutin Bujqësor të Kosovës.

Me synim të zhvillimit të strukturës adekuate për menaxhimin e pyjeve, sidomos në luftimin e prerjeve dhe zjarreve pyjore, parashikohet hartimi dhe implementimi i një Strategjie Zhvillimore të Pyjeve të Kosovës 2009-2013, bashkë me një plan veprimi për parandalimin e zjarreve pyjore. Më tutje, kompletimi i infrastrukturës legjislativ synohet të arrihet përmes hartimit të legjislacionit sekondar, themelimin e Departamenteve të Agjencisë Pyjore të Kosovës, si dhe implementimit të një plani veprimi për parandalimin e zjarreve pyjore, si dhe aktivitete tjera.

### c. Mjedisi

Mbrojtja e mjedisit dhe planifikimi hapësinor, duke përfshirë ajrin, ujin, tokën, etj., ka ndikim direkt në zhvillimin ekonomik dhe social. Një situatë e vështirë është trashëguar në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban, mjedisit, menaxhimit dhe mbrojtjes së resurseve ujore, shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, zhvillimin e pakontrolluar të kapaciteteve industriale dhe afariste, zbatimi i pamjaftueshëm i ligjit, etj. Qeveria do të përgatisë një kornizë ligjore, ndërsa në nivelin e implementimit, do të inkorporojë dhe zbatojë normat ndërkombëtare.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si institucion përgjegjës për çështjet mjedisore, ka shtatë departamente (Departamentin për Mbrojtjen e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor, Banimi dhe Ndërtimi, Ujërat, Administrata Qendrore, Prokurimi, si dhe Menaxhimi i Parqeve Nacionale) dhe dy Institute, si Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Instituti për Planifikim Hapësinor. Më 2006, Agjencia për Mbrojtjen Mjedisore është themeluar me detyrë themelimin e Sistemit Informativ Mjedisor. Është me rëndësi të përmendet që MMPH-ja ka edhe Inspektoratin Mjedisor. Ka edhe inspektorë mjedisorë në nivelin lokal.

Më 10 janar 2007, Qeveria e Kosovës miratoi Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis (PKVM), i cili u hartua në pajtim me Ligjin ekzistues për Mbrojtjen e Mjedisit (LMM), si dhe sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë për Mjedis dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. PKVM-ja përmban 50 projekte dhe dy projekte për shëndetin dhe mjedisin: 1) modernizimi i pajisjeve monitoruese për Institutin e Shëndetit Publik dhe 2) shqyrtimin e rregulloreve për standardet e cilësisë së ujit të pijes.

Deri tani, ligjet më të rëndësishme ekzistuese në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, që përfshijnë ajrin, ujin, tokën, etj., janë si në vijim: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 2002/08, shpallur në prill 2005, i cili synon themelimin e kornizës themelore ligjore për të promovuar një mjedis përditë e më të shëndoshë për popullin e Kosovës, përmes implementimit gradual të standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian, si dhe përmes caktimit të autoriteteve specifike publike që duhet të zbatojnë dispozitat e këtij Ligji (si dhe themelimin e autoriteteve të veçanta për implementim, si Inspektorati Mjedisor, Bordi Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit, etj.). Ligji mbi Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14, miratuar më 3 korrik 2003 rregullon planifikimin hapësinor mbi gjithë territorin e Kosovës. Sipas këtij Ligji, në nivel të Kosovës do të hartohet një Plan Hapësinor i Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta, ndërsa në nivelin komunal, do të hartohen planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregullative urbane. Institucioni përgjegjës për përgatitjen e këtyre planeve është MMPH-ja, por MMPH-ja mund t'i delegojë detyrat në lidhje me përgatitjen e planeve tek Instituti, komunat, si dhe agjencitë e ekspertët tjerë qeveritarë. Ligji mbi Ndërtimin Nr. 2004/15, miratuar më 27 maj 2004, synon të përcaktojë kërkesat kryesore për projektet, ndërtimin dhe shfrytëzimin e materialeve ndërtimore, procedurat e lejeve ndërtimore dhe lejeve të shfrytëzimit, si dhe inspektoratit të ndërtimit. Ligji mbi Mbeturinat Nr. 02/L-30, miratuar më 22 korrik 2005, rregullon të drejtat dhe obligimet e personave fizikë dhe juridikë në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Ky ligj vlen edhe për mbeturinat dhe materialet radioaktive, emetimet në atmosferë, ujërat e zeza, etj.

Për implementimin e këtyre ligjeve, MMPH-ja ka lëshuar disa Udhëzime Administrative. Në fushën e Mjedisit, MMPH-ja ka lëshuar 15 Udhëzime, 8 Udhëzime mbi Planifikimin Hapësinor, 13 UA mbi Ndërtimin, 1 UA për definimin e kriterëve dhe procedurave për realizimin e të drejtës së plotësimit të nevojave banesore për martirët e UÇK-së dhe familjeve me aftësi të kufizuara, si dhe 4 UA mbi ujërat.

Në afat të shkurtër, PVPE 2008 parashikon miratimin dhe zbatimin e Ligjit mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përmes implementimit të një UA mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe një plani veprimi për mjedisin, i cili do të adresonte në mënyrë specifike çështjet në lidhje me shëndetin publik. Kjo do të përfshijë: hartimin dhe zbatimin e një numri udhëzimesh administrative (mbi masat mbrojtëse kundër erozionit dhe për implementimin e Ligjit mbi Ujërat, etj.), hartimin e kushteve të referimit për mbrojtjen sanitare të burimeve ujore, rehabilitimin e deponive në disa komuna, themelimin e një rrjeti për monitorimin e cilësisë së ajrit, etj. Veprimet tjera të synuara drejt përafrimit të veprimeve për përafrimin e kësaj nën-fushe me standardet evropiane përfshijnë miratimin e disa akteve legjislative (Ligjin mbi Produktet Biocide, Ligjin për Mbrojtjen Mjedisore, UA për Cilësinë e Ajrit, etj.) dhe hartimin e një strategjie dhe plani veprimi për larminë biologjike.

PVPE 2008 parashikon edhe vetëdijesimin publik dhe përfshirjen e shoqërisë civile në çështjet mjedisore, përmes veprimeve si rritja e përfshirjes së lëndëve mjedisore në planprogramet e gjitha niveleve arsimore, bashkëpunimi i rregullt me OJQ-të dhe pushtetin lokal, si dhe publikimi i një reviste mjedisore.

Në afatin e mesëm, PVPE 2008 parashikon masa legjislative në përforcimin e planifikimit hapësinor, duke përfshirë hartimin e një Ligji mbi Zonat e Mbrojtjes së Veçantë, zbatimin e Ligjit mbi Ndërtimet, ndryshimin e UA mbi Ekzaminimin Profesional dhe Licencimin në fushën e Planifikimit Hapësinor, etj. Tutje, hartimi i Planit Hapësinor për Parkun Nacional “Malet e Sharrit” është paraparë bashkë me një plan nacional të veprimit për menaxhimin e mbeturinave. Në ndërtimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve, duhet përmendur themelimi i njësisë komunale të planifikimit, trajnimi i personelit ekzistues dhe punësimi i 20 punëtorëve të rinj në MMPH, por edhe një bashkërendim më i mirë dhe qartësim i kompetencave mes MMPH-së dhe komunave. Përfundimisht, PVPE 2008 parashikon bashkërendimin e çështjeve mjedisore me politikat sektoriale, sidomos energjinë dhe transportin. Kjo, mes tjerash, lidhet me zbatimin e Nenit 4 të Direktivës për Mbrojtjen së Zogjve të Egër 79/409/EEC, me transponimin e saj në Ligjin e ndryshuar dhe plotësuar mbi Mbrojtjen e Natyrës, por edhe duke ngritur grupe pune ndërsektorale me synim të implementimit dhe koordinimit të legjislacionit mjedisor me politikat tjera sektoriale.

#### d. Politikat e Transportit

Duke marrë parasysh gjendjen e vështirë të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si dhe duke marrë parasysh rëndësinë e shërbimeve të komunikimit, Qeveria e Kosovës synon të përmirësojë këtë infrastrukturë në pajtim me standardet evropiane për t’u bërë motor i zhvillimit ekonomik.

Republika e Kosovës merr pjesë aktive në zhvillimin e gjitha rrjeteve kryesore të transportit në Evropën Juglindore, si dhe është maksimalisht e angazhuar në përmirësimin e infrastrukturës së transportit brenda territorit vendor. Gjitha studimet e fizibilitetit, sipas të cilave janë hartuar politikat e transportit, janë inkorporuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Këto politika kanë adresuar rekomandimet e institucioneve relevante evropiane, si dhe janë në pajtim të plotë me prioritetet e Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO).

Transporti rrugor është në fazën e zhvillimit. Transporti rrugor ka rëndësi të veçantë në sistemin ekonomik të Kosovës. Rreth 90 % e transportit të mallrave dhe udhëtarëve në Kosovë kryhet përmes transportit rrugor. Transporti rrugor në Kosovë është kryesisht i privatizuar, gjë që karakterizohet me

cilësi të lartë të transportit, në Kosovë si dhe në rajon. Sipas shënimeve të MTPT-së, Kosova ka 8522 kilometra rrugë publike, pa llogaritur rrugët në qytete dhe zona rurale.

Gjatësia e rrugëve magjistrale: 647 km,

Gjatësia e rrugëve rajonale: 1304 km

Gjatësia totale e rrugëve kryesore dhe rajonale: 1951km

Gjatësia e rrugëve lokale: 6571 km.

Urat në rrugët kryesore dhe rajonale: 354

Gjatësia e tuneleve: 2081m.

Rrugët magjistrale dhe rajonale në Kosovë janë kryesisht me dy shirita. Vetëm disa pjesë të shkurtra rreth Prishtinës janë rrugë me 4 shirita. Komunikacioni rrugor në magjistralet kryesore, e sidomos përreth Prishtinës ka arritur dendësi shumë të madhe. Për shkak të kësaj, komunikacioni në këto rrugë ka pengesa të mëdha. Kosova nuk posedon autostrada. Ajo planifikohet të fillojë këtë vit me realizimin e segmentit I të autostradës Morinë – Merdar. Në vitin 2008 planifikohet të realizohen projektet në vijim (faqe 57):

Projektet e infrastrukturës rrugore që do të realizohen në vitin 2008

| <b>PROJEKTET E MTPT-SË PËR VITIN 2008 – INFRASTRUKTURA RRUGORE</b>                     | <b>Buxheti</b>    |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|
| <b>Mirëmbajtja e urave</b>                                                             | <b>3,400,000</b>  |
| <a href="#">Obligimet kontraktuale nga viti 2007</a>                                   | 23,000            |
| Mirëmbajtja dhe ndërtimi i urave                                                       | 3,377,000         |
| <b>Rehabilitimi i rrugëve</b>                                                          | <b>53,671,713</b> |
| <a href="#">Obligimet kontraktuale nga viti 2007</a>                                   | 70,000            |
| Ndërtimi i autostradës Morinë - Merdare, pjesa Morinë – Prizren                        | 10,500,000        |
| Rehabilitimi i magjistrales Prishtinë – Kaçanik                                        | 15,957,000        |
| Stabilizimi i pjesës së rrëshqitshme të magjistrales M2, pjesa Kaçanik - Hani i Elezit | 1,500,000         |
| Rehabilitimi i magjistrales Prishtinë-Pejë                                             | 13,900,000        |
| Zgjerimi i magjistrales M2 Mitrovice-Prishtinë, Pjesa Prishtinë – Shkabaj              | 8,000,000         |
| <b>Rehabilitimi i magjistrales Prishtine- Mutivode</b>                                 | <b>1,000,000</b>  |
| <b>Rehabilitimi i magjistrales Prishtinë - Gjilan</b>                                  | <b>1,044,713</b>  |
| <b>Rehabilitimi i rrugës rajonale Klinë – Turiqec</b>                                  | <b>1,700,000</b>  |
| <b>Sinjalizimi</b>                                                                     | <b>2,964,500</b>  |
| <a href="#">Obligimet kontraktuale nga viti 2007</a>                                   | 64,500            |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në magjistrale dhe rrugë rajonale                  | 2,900,000         |
| <b>Programi i bashkëfinancimit me komuna</b>                                           | <b>16,599,962</b> |
| <b>Programi i bashkëfinancimit me komuna</b>                                           | 14,099,962        |
| Implementimi i Planit të Ahtisaarit                                                    | 2,500,000         |
| <b>Ndërtimi i rrugëve të reja</b>                                                      | <b>13,320,000</b> |
| <a href="#">Obligimet kontraktuale nga viti 2007</a>                                   | 70,000            |
| Ndërtimi i Rrugës Kerpimeh-Kaçanoll                                                    | 2,200,000         |
| Ndërtimi i Rrugës Skenderaj-Vushtri                                                    | 3,000,000         |
| Ndërtimi i Rrugës Pejë-Kufiri me Malin e ZI                                            | 1,000,000         |
| <b>Rindërtimi i rrugës Hajkobill - Zajqec ( Zajqec - Tuxhec )</b>                      | <b>1,400,000</b>  |
| Rindërtimi i rrugës Dollce - Gjakove                                                   | 1,000,000         |
| <b>Rindërtimi i rrugës së Dushkajes</b>                                                | <b>1,900,000</b>  |
| Ndërtimi i rrugës Nerodime-Jezerc                                                      | 700,000           |
| <b>Kompletimi i pjesës Gjytet – Mramor</b>                                             | <b>500,000</b>    |
| Ndërtimi i rrugës rajonale Qeskove – Nepole                                            | 400,000           |
| Ndërtimi i rrugës tranzit në Shtime, pjesa e parë                                      | 500,000           |
| Hartimi i projekteve dhe konsultimi teknik                                             | 650,000           |
| <b>Vlera totale e projekteve të propozuara në vitin 2008</b>                           | <b>89,956,175</b> |

Në qershor 2003, Ligji Nr. 2003/11 mbi Rrugët ishte shpallur nga PSSP-ja, duke rregulluar statusin ligjor të rrugëve publike, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, masat për mbrojtjen e rrugëve, qeverisjen, financimin dhe mbikëqyrjen e rrugëve publike. Sipas këtij Ligji, MTPT-ja është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve kryesore dhe rajonale, derisa Komunitet janë përgjegjëse për rrugët lokale dhe lagjeve. Ligji Nr. 2004/1 mbi Transportin Rrugor, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 02/L-127, synon të rregullojë transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe mbulon transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në rrugët publike të Kosovës dhe jashtë Kosovës, nga operatorët e themeluar në Kosovë. Implementimi i Ligjit Nr. 02/L-70 mbi Sigurinë në Trafikun Rrugor (si prioritet afatmesëm) tanimë ka filluar, bashkë me mekanizmat e nevojshëm institucionalë për implementimin e tij. Për implementimin e këtyre ligjeve, MTPT-ja deri tani ka lëshuar nëntë Udhëzime Administrative dhe një Kod Mirësjelljeje për operatorët e autobusëve dhe personelit, nr. 2008/01.

Transporti hekurudhor – Hekurudhat e Kosovës ekzistojnë qysh prej vitit 1933, dhe menaxhohen nga Drejtori Menaxhues. Hekurudhat e Kosovës mbulojnë gjithë territorin e Kosovës me një rrjet me gjatësi prej 333,451 km. Vijat hekurudhore janë një lidhje mes gjitha qendrave të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Linjat hekurudhore në Kosovë kanë lidhje direkte me vendet fqinje si Maqedonia e Serbia, si dhe përmes tyre me vendet tjera. Megjithatë, infrastruktura hekurudhore (binarët, ndërtesat e stacioneve, sinjalizimi, telekomunikacioni dhe pajisjet elektrike), pastaj operacionet hekurudhore (lokomotivat, vagonët e udhëtarëve dhe mallrave), kërkojnë investime të mëdha. Më 1 tetor 2007, Hekurudhat e Kosovës inauguruan linjën hekurudhore Prishtinë-Pejë-Prishtinë për transport udhëtarësh, ndërsa që nga 2 tetori 2007, ka filluar lëvizja e rregullt në këtë linjë.

Në vitin 2007, Hekurudhat e Kosovës kanë transportuar 417.193 udhëtarë dhe 588.680 neto tonë mallra. Në pronësinë e tyre Hekurudhat kanë 4 lokomotiva të llojit Di3, 4 lokomotiva të tipit 661, 4 trena motorikë, 1 lokomotivë të re G1700, 10 vagonë udhëtarësh dhe 70 vagonë mallrash. Nuk ekziston ndonjë Ligj për hekurudhat; ende në fuqi është Rregullorja e UNMIK-ut 2006/56 e 6 dhjetorit 2006 mbi Hekurudhat.

Institucionet përgjegjëse për transportin hekurudhor janë MTPT-ja, si dhe UNMIK-u për pjesën e rezervuar.

MTPT-ja synon të hartojë Ligjin mbi Hekurudhat, anëtarësimin e Hekurudhave të Kosovës (HK) në Bashkimin Ndërkombëtar të Hekurudhave, po harton strategjinë zhvillimore të HK, si dhe përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore.

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit si autoritet përgjegjës ka një rol të rëndësishëm në krijimin e kornizës së domosdoshme legjislative dhe organeve rregullative për Hekurudhën. Themelimi i Autoritetit rregullativ mbi Hekurudhat është në fazën përfundimtare. Ky Autoritet do të mundësojë hapjen e tregut të hekurudhave për operatorë tjerë të hekurudhave, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore dhe operative, për të siguruar një zhvillim të shëndoshë të transportit hekurudhor.

Transporti ajror – ka shënuar përparim në Republikën e Kosovës. Kosova është anëtare e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) me të drejta të plota, qysh prej 2006-ës, kur shtetet anëtare të BE-së nënshkruan Marrëveshjen e ECAA-s me vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo Marrëveshje obligon Kosovën që të pasqyrojë gjithë legjislacionin evropian mbi aviacionin civil në legjislacionin vendor. Ligji i ri mbi Aviacionin Civil është hartuar në pajtim të plotë me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Ky Ligj pritet të hyjë në fuqi në qershor 2008, me parashikimin që të krijojë një bazë të mirë legjislative për aviacionin civil në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Zyra Rregullative e Aviacionit Civil (CARO) që është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/18 ka plotësuar një numër obligimesh sipas kërkesës së ECAA-s. MTPT-ja po ndërmerr

përgatitjen e nevojshme për funksionalizimin e Autoritetit Kosovar të Aviacionit Civil, i cili do të jetë përgjegjës për certifikimin e aeroporteve, për certifikimin dhe licencimin e kompanive ajrore të Kosovës, certifikimin e pilotëve, etj.

Ligji mbi Aviacionin është miratuar, ndërsa pret shpalljen e tij. Ligji parashikon (i) ndërtimin e Divizionit të Aviacionit Civil; (ii) Themelimin e Autoritetit të Aviacionit Civil; (iii) themelimin e Komisionit të Pavarur për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike si pjesë e Qeverisë; (iv) themelimin e Zyrës për Sigurinë e Aviacionit Civil si pjesë e MPB-së.

Institucionet përgjegjëse në fushën e aviacionit civil janë: Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, Autoriteti Kosovar i Aviacionit Civil, Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) vazhdon avancimin e tij, në aspektet teknike dhe të sigurisë, ndërsa MTPT-ja planifikon të ndihmojë në këtë drejtim. Aeroporti është ndërtuar në vitet e 60-ta dhe kryesisht është përdorur si bazë ajrore ushtarake, me komunikacion të kufizuar civil. U mbyll për trafik civil gjatë luftës, ndërsa u hap prapë si bazë ushtarake nën kontrollin e OKB-së më 16 janar 2000.

KFOR- transferoi përgjegjësitë e operacioneve të Aeroportit tek UNMIK-u më 1 prill 2004. Këto përgjegjësi iu dhanë ATCS-së dhe PEAP-së. ATCS dhe PEAP pastaj u shkrinë nën emrin Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Sh.A., më 30 qershor 2005. ANP-ja operon një pjesë të hapësirës ajrore mbi territorin e Kosovës në emër të KFOR-it.

Aeroporti gjatë vitit 2007 ka arritur numër rekord të fluturimeve dhe udhëtarëve. 4 316 fluturime me gjithsej 990.259 udhëtarë janë pranuar dhe përcjellur. Më 2008, gjatë periudhës janar-prill në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i fluturimeve dhe udhëtarëve është rritur për rreth 20%.

Aeroporti është në proces të finalizimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë dhe atij të Menaxhimit të Cilësisë, të cilët do të sigurojnë sigurinë dhe cilësinë në të gjitha aspektet. Aktualisht, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është duke punuar në projektet në vijim: (i) Rishtrësimi i pistës; (ii) zgjerimi APRON; (iii) sistemi i ndriçimit të pistës; (iv) zgjerimi i parkingut; (v) rrethoja perimetrike; (vi) modifikimi i terminalit.

Në afatin e shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian, MTPT-ja, mes tjerash, do të vazhdojë me përgatitjet e nevojshme në lidhje me projektet e identifikuara prioritare për drejtimet rrugore 6 dhe 7, linja hekurudhore 10 dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Plani shumëvjeçar i Veprimit për transportimin e udhëtarëve dhe mallrave do të hartohet dhe fuqizohet, do të përforcojë bashkëpunimin rajonal, do të themelojë Qendrën Trajnuese të Unionit Ndërkombëtar Rrugor për transport profesional, do të miratojë dhe zbatojë kartën mbi sigurinë në rrugë dhe planin shumëvjeçar të veprimit për sigurinë në rrugë, do të krijojë Këshillin për Sigurinë Rrugore, do të themelojë Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave, do të implementojë kornizën legjislative mbi kontrollimin dhe zvogëlimin e gazrave ndotëse të emetuara nga veturat, derisa harton strategjinë e transportit multi-modal, e cila pritet të kompletohet brenda periudhës afatshkurtër, si dhe të zbatohet pas finalizimit të saj.

Në afatin e mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian, MTPT-ja, mes tjerash, do të hartojë dhe implementojë strategjinë dhe planin e veprimit për rritjen e sigurisë rrugore, do të implementojë strategjinë e transportit multi-modal, si dhe do të implementojë programin e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të rrjetit rrugor në Kosovë.

#### e. Energjia

Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me energji paraqet një parakusht për zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik të Kosovës.

Ligjet dhe rregulloret në vijim përbëjnë kornizën menaxhuese të sektorit të energjisë në Kosovë:

- Ligji mbi Energjinë 2004/8;
- Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë 2004/9;
- Ligji mbi Energjinë Elektrike 2004/10;
- Ligji mbi Planifikimin Hapësinor (2003/4)
- Rregullorja e UNMIK-ut 2005/15, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19, për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes në Kosovë
- Ligji mbi Minierat dhe Mineralet (draft);
- Rregullorja mbi Minierat dhe Mineralet 2005/3;
- Rregullorja mbi Themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale 2005/3;
- Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9;
- Ligji mbi Tregtimin e Naftës dhe Produkteve të Naftës 2004/5;
- Ligji mbi Aktivitetet e kërkimit shkencor 2004/42;
- Rregullorja mbi shfrytëzimin afatgjatë të pronave shoqërore të menaxhuara nga Komunitet në Kosovë 2005/13;
- Vendimi qeveritar për ristrukturimin e KEK-ut (qershor 2005)
- Ligji mbi Investimet e Huaja 2005/02-L33

Ligjet e lartpërmendura janë në pajtim me Direktivat e BE-së dhe në pajtim me parimet e Procesit të Athinës për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë (REM).

Në nëntor të vitit 2002, UNMIK-u nënshkroi Memorandumin e Athinës për themelimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike për Evropën Juglindore. Në dhjetor 2003, UNMIK-u nënshkroi Memorandumin e dytë të Mirëkuptimit, duke përfshirë themelimin e tregut rajonal të gazit dhe propozimin për qasje të përbashkët ndaj mjedisit.

UNMIK-u, në emër të institucioneve të Kosovës, është gjithashtu i përfshirë në përgatitjen e Traktatit që është akti përfundimtar për themelimin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (KEEJL), dokument që pas nënshkrimit nga Ministrat e sektorit, si dhe pas ratifikimit nga Parlamentet e vendeve pjesëmarrëse, do të jetë obligativ për Qeverinë e Kosovës, në lidhje me themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe pjesëmarrjes aktive në të.

Traktati mbi Komunitetin e Energjisë kërkon implementimin e *Acquis communautaire* të Komisionit Evropian nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, në bazë të afateve të nevojshme për implementimin e reformave të kërkuara.

Shkurt, *Acquis communautaire* mbikëqyr përputhshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve të secilit vend me Direktivat e BE-së 2003/54/EC dhe 2003/55/EC, me Rregulloren e BE-së 1228/2003/EC, me Direktivën e BE-së 96/61/EC, me Direktivat e Këshillit të Evropës 1985/337/EEC dhe 1999/32/EC dhe Direktivat e BE-së 2001/80/EC dhe 79/409/EEC. Një vit pas implementimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, do të përcaktohet një tabelë afatesh për palët kontraktuese për përputhje të mëtutjeshme me Direktivat e BE-së 2001/77/EC dhe 2003/30/EC.

Në kontekstin e themelimit të kushteve për tregun e energjisë në rajon, Operatorët e Sistemit të Bartjes (TSO) të Evropës Juglindore (EJL), nën bashkërendimin e Operatorëve Evropianë të Sistemeve të Bartjes (ETSO) në korrik 2005 kanë implementuar sistemin e kompensimit brenda TSO-ve të EJL-së,

duke synuar kompensimin e shfrytëzimit të sistemeve shtetërore të bartjes përmes Tregtisë Ndërkufitare (CBT) në Evropën Juglindore. Përveç kësaj, procesi për implementimin e aktiviteteve të koordinuara për kapacitete interkonektimi është në vazhdim, mekanizmi i tregtisë ndërkufitare, janë çështje që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme në afat të shkurtër, me synim pjesëmarrjen e Kosovës në këto.

Në këtë aspekt, sektori i energjisë elektrike në Kosovë do të angazhohet në Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike të EJT-së. Për më tepër, zhvillimi i sektorit do t'i nënshtrohet konkurrencës rajonale, në kuptimin e tregut të hapur dhe standardeve më të larta mjedisore.

Sistemi elektro-energjetik i Kosovës ka linja direkte interkoneksioni me Shqipërinë, Malin e Zi, Serbinë dhe IRJ të Maqedonisë. Përveç Serbisë, gjithë këta sisteme janë importues të energjisë elektrike. Ky fakt paraqet mundësi për investime të mundshme në termocentrale të reja me linjit në Kosovë.

Pas transferimit të pjesshëm të “kompetencave të rezervuara” nga UNMIK-u tek IPVQ-të dhe nënshkrimit të Protokollit të Transferit në tetor 2004, kompetencat për politikën dhe strategjitë e sektorit të energjisë iu transferuan Ministrisë së Energjisë dhe Minierave (MEM). Kështu, MEM-i është përgjegjëse për politikë-bërjen energjetike dhe vendim-marrjen për sektorin e energjisë, për të promovuar reformat e tregut dhe qeverisjen e mirë. Ministria ka krijuar parakushtet organizative dhe institucionale për implementimin e këtyre kompetencave.

Legjislacioni i miratuar përcakton rolet dhe përgjegjësitë për rregullimin dhe qeverisjen e industrisë së energjisë, prej Parlamentit, Qeverisë, Rregullatorit të pavarur të Energjisë, prodhuesve publikë dhe furnizuesve dhe operatorit të sistemit të Bartjes. Është me rëndësi të dallohet funksionimi i hartimit të politikave mes rregullatorit dhe kompanive energjetike.

Sektori elektrik në Kosovë dominohet nga kompania e gjenerimit të energjisë, Korporata Energjetike e Kosovës – KEK, një sistem vertikalisht i integruar. Sistemi integral elektrik përbëhet nga dy miniera sipërfaqësore të linjtit në Bardh dhe Mirash, dy termocentrale Kosova A dhe B, me kapacitet të përgjithshëm efektiv prej 645 deri në 710 MW (nga kapaciteti i instaluar prej 1478 MW), rrjeti i bartjes dhe dispeçingu, rrjeti shpërndarës dhe furnizimi.

Resurset kryesore të energjisë në Kosovë gjenden në dy basene të mëdha të linjtit, të quajtura “Kosova” dhe “Dukagjini”, me rezerva linjiti të shfrytëzueshme me cilësi të mirë. Sasia e vlerësuar e linjtit është mes 11.55 - 14 miliardë tonë. Rezervat e linjtit kanë përmbajtje të ultë të sulfurit, koncentrim relativisht të mirë të gëlqeres (oksid i kalciumit) për thithje të pjesshme të sulfurit gjatë djegies. Proporcioni mes djerrinës dhe linjtit është shumë i favorshëm, fakt që i bën minierat shumë atraktive për eksplotim.

Qysh prej majit 2005, kapacitetet totale të sistemit gjenerues në Kosovë (B1+B2, A1+A5 dhe hidrocentrali në Ujman), janë në nivelin prej 585 – 745 MW me kapacitete të gjenerimit vjetor prej rreth 3,800 GWh. Duhet theksuar që gjenerimi neto gjatë viteve 2000/2004 është rritur vazhdimisht nga 1,914 GWh në vitin 2000, 2,568 GWh në vitin 2001, 3,153 GWh në vitin 2002, 3,326 GWh në vitin 2003, deri në 3,501 GWh në vitin 2004. Gjendja aktuale teknike e kapaciteteve energjetike dhe niveli i tyre teknologjik nuk garantojnë furnizim të qëndrueshëm dhe konkurrent për mbulimin e kërkesës së konsumatorëve, e sidomos jo atë të pritur në rritje.

Pjesëmarrja e amvisnive dhe shërbimeve është rritur nga 26% në 75%, respektivisht nga 7% në 13%, derisa përqindja e industrisë është zvogëluar nga 67% në 12%. Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të KEK-ut është vlerësuar të jetë rreth 360,000. Konsumi elektrik për ngrohje përbën 64.2% të energjisë së furnizuar, duke kërkuar kështu një ngarkesë të madhe gjatë stinës së dimrit.

Gjendja e lartpërmendur, në lidhje me furnizimin në sektorin elektrik, ka vendosur KEK-un në situatë shumë jostabile ekonomike, me kapacitete të kufizuara financiare për përmbushjen e detyrave të tij. Kështu, ka rëndësi të madhe për KEK-un, me mbështetjen politike nga qeveria, që të bëhen më shumë përpjekje për ndërtimin e marrëdhënieve efektive mes furnizuesit dhe konsumatorëve, zvogëlimi i humbjeve komerciale, që do të thotë rritja urgjente e faturimit dhe inkasimit. Këto janë sfidat dhe parakushtet kryesore për stabilizimin dhe funksionimin e sistemit elektro-energetik në Kosovë, si dhe themelimin e një mjedisi stabil dhe konkurrent për tërheqjen e investimeve.

Për të përmirësuar gjendjen e faturimit dhe inkasimit, menagjimenti KEK-ut është duke marr hapa të rëndësishëm për të përmirësuar faturimin dhe inkasimin duke i bërë përgjegjës nivelet më të ulëta të punëtorëve si dhe personat në terren për leximin e njehsorëve në mënyrë korrekte dhe llogaritja e tërë energjisë së shpërndarë në atë dalje, zbulimi njehsorëve të manipuluar dhe format tjera të vjedhjeve si dhe marrja e hapave të menjëhershëm për përmirësim të situatës, shpërndarja e faturave me kohë dhe zbatimi disiplinës së pagesës duke bërë çkyqje efektive tek konsumatorët që nuk paguajnë. Praktikën e menagjimentit të cilat janë duke u implementuar për të ndihmuar arritjen e rezultateve përfshijnë: kontrollimi në detaje i bilancit energetik për të monitoruar rezultatet e çdo daljeje të ekipeve në terren që janë përgjegjës për atë dalje.

Përkrahja nga Qeveria është shumë e rëndësishme dhe përpjekjet janë duke u bërë me Ministrinë e Drejtësisë për përkrahje në gjykata rreth zgjedhjes së lëndëve që kanë të bëjnë me vjedhje dhe mos pagesë dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme në ofrimin e përkrahjes së policisë gjatë çkyqjeve të konsumatorëve problematikë si dhe kthimi praktikës për kërkesë të dëshmisë së pagesës së energjisë për regjistrim të automjeteve si dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ti detyruar organizatat Buxhetore bërjen e pagesës së energjisë. Përkrahje gjithashtu është duke u kërkuar edhe nga mediat lokale për të drejtuar mesazhet tek konsumatorët për të paguar energjinë.

Problemet tjera që rëndojnë situatën janë: (i) mungesa e mjeteve financiare për rehabilitim dhe revitalizim, si dhe dilemat aktuale mbi atë se cilat njësi gjeneruese kanë nevojë për revitalizim dhe cilat duhen mbyllur; (ii) ristrukturimi dhe riorganizimi në proces, duke përfshirë korporatizimin; (iii) mungesa e kualifikimit dhe trajnimit të personelit për rritjen e aftësive të tyre menaxhuese, sidomos mungesa e ekspertëve të rinj; (iv) problemet afatgjata me ndotjen e mjedisit; (v) statusi i pazgjidhur i menaxhmentit të KEK-ut; (vi) jostabiliteti politik për investitorët e jashtëm.

Problemet e lartpërmendura nuk mund të zgjidhen pa ndërmarrë masa serioze në ristrukturimin e sektorit energetik në përgjithësi. Ristrukturimi i sektorit elektrik mund të sigurojë operimin në baza komerciale dhe mund të çlirojë konkurrencën në tregun e Kosovës. Kjo do të mundësonte tejkalimin e problemeve të lartpërmendura, duke rezultuar në shfrytëzimin efikas të aseteve aktuale të linjitet dhe energjisë elektrike.

Gjatësia e përgjithshme e linjave bartëse (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1,187 km. Gjatë kohës së luftës në Kosovë, rrjeti bartës e sidomos ai 400 kV është dëmtuar pjesërisht. Shumica e linjave bartëse janë kthyer në funksion pas riparimeve të pasluftës, derisa nën-stacionet janë ende në gjendje të keqe teknike.

Rrjeti bartës i Kosovës në nivel 400 kV dhe 200 kV është pjesë përbërëse e sistemit rajonal të interkonektuara të bartjes. Sistemi i bartjes së energjisë elektrike është i ndërlidhur me gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV përveç me Shqipërinë, ku linja është vetëm në nivelin 220 kV. Linja e re e interkoneksionit në nivelin 400 kV me Shqipërinë konsiderohet vitale për implementimin e shkëmbimit të konsiderueshëm të energjisë elektrike në afatin e mesëm dhe të gjatë mes sistemit kosovar me bazë në termocentrale dhe atij të Shqipërisë me bazë në hidrocentrale.

Strategjia e Energjisë e Kosovës 2005 – 2015 përcakton këto synime strategjike për zhvillimin e energjisë për periudhën 2005-2015: (i) brenda kësaj periudhe të ngrihen kapacitete gjenerimi të energjisë elektrike me së paku 1800 MW, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm për konsumatorët e Kosovës dhe eksportimin e rreth 30-50% të energjisë së prodhuar elektrike; (ii) përmirësimi i sektorit të ekonomisë, përmes finalizimit të rristurimit dhe reformimit të KEK-ut dhe rritjes së përparësive të tij konkurruese, duke siguruar inkasim të plotë të faturave elektrike deri më 2009; (iii) avancimi i rrjetit bartës dhe shpërndarës, derisa integrimi plotë me rrjetet rajonale dhe evropiane të energjisë dhe zvogëlimi i humbjeve teknike deri në nivel të standardeve ndërkombëtare deri më 2010-2012; (iv) rritja e efikasitetit në sigurimin e menaxhimit efikas të investimeve me theks në krijimin e kushteve atraktive për investitorë ndërkombëtarë që duhet të marrin pjesë me rreth 60% në financimin e investimeve të përgjithshme në këtë sektor; (v) deri në fund të vitit 2012, qendrat rajonale të Kosovës do të kenë sistem të ngrohjes qendrore dhe sistem rajonal të gazit; (vi) sanimi i pasojave në mjedisin e krijuar përreth termocentraleve deri më 2012 dhe implementimi i përgjithshëm i normave dhe standardeve të larta të mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit të kapaciteteve të reja të gjenerimit elektrik, duke synuar përmbushjen e obligimeve nga protokollin i Kjotos; (vii) rritja e vetëdijes mbi përfitimet e shfrytëzimit racional të energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve alternative të energjisë; (viii) rritja e konsiderueshme e kapaciteteve vendore dhe zhvillimi dhe implementimi i teknologjisë së avancuar dhe menaxhmentit modern brenda institucioneve dhe ndërmarrjeve publike të energjisë.

Në afatin e mesëm, me synim të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e energjisë, MEM-i dhe palët tjera, mes tjerash, do të shqyrtojnë dhe freskojnë strategjinë ekzistuese “Strategjia e Energjisë e Kosovës 2005 – 2015”; do të hartojë, miratojë dhe implementojë planin e veprimit për KEK-un Sh.A., i cili do të jetë i rëndësishëm kyç, me synim furnizimin stabil elektrik, eliminimi i konsumit ilegal dhe rritjen maksimale të faturimit dhe inkasimit të energjisë së shpenzuar. Në aspektin organizativ, PVPE-ja parashikon rristurimin e KEK-ut Sh.A., në pajtim me afatet e përcaktuara me Planin e Veprimit për Energji Elektrike. Këshilli Drejtues i ri do të themelohet në bazë të standardeve ndërkombëtare. Në lidhje me obligimet e marra përsipër me kornizën e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që është në përputhje të plotë me *Acquis Communautaire*, dhe përgatitjes së vazhdueshme të projektit të gjenerimit dhe furnizimit të energjisë elektrike “Kosova C”, do të implementohet një *Hartë Rrugore* për energjinë elektrike, rregullorja për autorizimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese do të hartohet dhe miratohet, stimujt financiarë do të krijohen për implementimin e masave dhe arrijen e qëllimeve indikative për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, implementimin e Programit të Efikasitetit të Energjisë 2007-2009 do të vazhdojë, do të vazhdojnë studimet mbështetëse për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit, si dhe do të finalizohet projekti Kosova C.

Në afatin e mesëm, me qëllim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e energjisë, MEM-i dhe palët tjera mes tjerash do të fokusohen në hartimin e kornizës legjislative dhe rregullative për inkurajimin e partneriteteve publiko-private dhe investimeve të përziera në këtë fushë, në pajtim me konkludimet e Studimit mbi Investimet në Gjenerim. Brenda këtij aspekti, legjislacioni ekzistues do të rishikohet, duke synuar inkurajimin e PPP-ve, derisa korniza legjislative dhe rregullative do të konsolidohet më tutje, duke përfshirë hartimin dhe miratimin e Ligjit mbi Gazin Natyror. Në lidhje me përmirësimin e mëtutjeshëm të performancës së shërbimit dhe integritetit me tregun rajonal elektrik, do të modifikohen rregullat e tregut tranzitor, pas miratimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, KOSTT-i do të mbështetet në implementimin e mekanizmit Tregtia Ndërkufitare / Kompensimi mes TSO-ve për Tranzit (CBT/ITC), pjesëmarrja e vazhdueshme në mekanizmin rajonal të balancimit, do të implementohen disa projekte, si Kontrollimi Mbikëqyrës dhe Grumbullimi i shënimeve/Sistemi i Menaxhimit Energjetik (SCADA/EMS), kapacitetet e rrjetit 110 kV do të përmirësohen, përpjekjet do të vazhdojnë për anëtarësimin e KOSTT-it në Sistemin e Operatorëve Evropianë të Bartjes (ETSO) dhe Unionin për Koordinimin e Bartjes së Energjisë (UCTE), ndërsa linja interkonektuese 400 kV do të ndërtohet mes Kosovës dhe Maqedonisë.

#### f. Shoqëria Informative dhe Mediat

Telekomunikacioni është element kyç për aktivitetet ekonomike vendore dhe thelbësor për krijimin e marrëdhënieve komerciale ndërkombëtare. Industria e komunikimit përbën një nga sektorët më fitimprurës për indikatorët makroekonomikë dhe shërben si katalizator në të ashtuquajturën “ekonomi e mençur”. Njëkohësisht, kjo industri shërben si “dritare” për bizneset dhe individët duke mundësuar qasjen e shpejtë dhe globale. Gjithashtu, është vegël për promovimin e transparencës dhe efikasitetit të qeverisë.

Politikat e telekomunikacionit janë pjesë përbërëse e politikave zhvillimore në Kosovë.

Në maj të vitit 2003 u shpall Ligji Nr. 2002/7 mbi Telekomunikacionin. Ky Ligj rregullon gjitha shërbimet e telekomunikacionit dhe ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë. Sipas këtij Ligji, MTPT-ja është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të sektorit, duke përfshirë legjislacionin, derisa Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është themeluar si organ i pavarur brenda institucioneve me këtë Ligj për të qenë përgjegjës për implementimin e politikave të Institucioneve të Kosovës dhe MTPT-së në bazë të këtij ligji.

Ligji Nr. 2003/37 mbi Shërbimin Postar që është shpallur në dhjetor 2003 rregullon ofrimin e shërbimeve postare në Kosovë. Roli i Ministrisë në bazë të këtij Ligji është përcaktimi i politikave dhe strategjive për zhvillimin e Postës si dhe rregullimi i sektorit postar në Kosovë. Ky Ligj parasheh që Departamenti i Postës, i cili do të shërbejë si Rregullator deri në vitin 2008, është përgjegjës për përcaktimin e politikave për zhvillimin e sektorit postar dhe sigurimin e kushteve organizative për implementimin e tyre duke inkurajuar investimet në Sektorin e Postave.

Ligji Nr. 02/L-23 mbi Shërbimet e Shoqërisë Informative parasheh që të bëjë gjithë dokumentacionin elektronik ligjërisht ekuivalent me pjesën tradicionale në letër, për të mundësuar aktivitetet komerciale. Këto politika reflektojnë parimet në lidhje me veprimet e domosdoshme që duhen ndërmarrë në zhvillimin e shoqërisë informative, si dhe themelimin e mekanizmave rregullatorë në përgjigje ndaj avancimeve të shpejta teknologjike.

Në afat të shkurtër, me qëllim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e shoqërisë informative dhe mediave, MTPT-ja dhe Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART), do të përgatisin Planin e Veprimit për implementimin e dokumentit “Politikat Sektoriale të Telekomunikacionit”, do të përqendrohen në zgjerimin e shërbimeve të internetit në gjitha shkollat dhe institucionet akademike, do të përqendrohen në zhvillimin e programeve të mësimi të vazhdueshëm të zyrtarëve qeveritarë në fushën e teknologjisë moderne të informimit dhe komunikimit deri në mes të vitit 2009 (ECDL/ICDL), krijimin e qendrave nacionale kompjuterike për reagim ndaj rasteve emergjente dhe fillimin e shkëmbimit të informatave, do të bëhet një studim mbi mundësitë më të mira për investime Publiko-Private në PTK dhe veprime tjera si pjesë e PVPE-së.

Në afat të mesëm, me qëllim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e shoqërisë informative dhe mediave, MTPT-ja dhe Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART), mes tjerash do të analizojnë dhe harmonizojnë kontradiktat mes Ligjit mbi Telekomunikacionin dhe Ligjit mbi Mediat dhe Komisionin e Transmetimit, si dhe do të fuqizojnë plotësisht ART-në për monitorimin, menaxhimin dhe implementimin e funksioneve që merren me brezin e frekuencave.

#### g. Kontrolli Financiar

Kontrolli i financave publike (KFP) në Kosovë rregullohet me këtë legjislacion primar:

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19 e 13 shtatorit 2001 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ) përcakton strukturën e administratës dhe rolin e përgjegjës të

Qeverisë, Ministrave dhe Ministrive. Ajo përcakton, mes tjerash, që ministrat duhet të sigurojnë që ministratë e tyre të implementojnë kontroll të duhur të brendshëm, si dhe përcakton elementet kryesore për themelimin e sistemeve të shëndosha të kontrollit të brendshëm.

Ligji i IPVQ-ve 2003/2 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërinë (LMFPP), miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), definon më tutje elementet e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe themelon njësinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave (Neni 8). Ky Ligj është në fazë të ndryshimit.

Ligji mbi Auditimin e Brendshëm, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 nëntor 2006 (Nr. 2/L-74), shpallur nga PSSP-ja më 6 qershor, parashikon një sistem të decentralizuar të auditimit të brendshëm dhe themelimin e komisioneve të auditimit në organizatat buxhetore, si dhe themelon një njësi qendrore të harmonizimit të auditimit të brendshëm, e cila do të hartojë standardet, të trajnojë auditorët e brendshëm, të monitorojë zhvillimet e revizionit të brendshëm, si dhe të sigurojë mbikëqyrje cilësore.

Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2008 dhe pret shpalljen e tij. Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike tanimë ekziston, ndërsa iniciimi i implementimit të saj është prioritet afatshkurtër. Megjithatë, gjatë afatit të mesëm, kjo Njësi do të konsolidohet më tutje përmes veprimeve si themelimi i Komiteteve të Auditimit të Brendshëm, në pajtim me Ligjin, si dhe hartimin dhe fuqizimin e rregullave për Kushtet e Referimit për Komitetet e Auditimit të Brendshëm.

Legjislacioni sekondar përbëhet prej:

Rregullat Financiare të Thesarit – Numër 01 - PIFC – Shkurt 2006: Kjo Rregull është hartuar për të definuar më tutje zinxhirin e përgjegjësisë dhe kërkesat minimale për kontrollin e brendshëm. Ajo vlen për gjithë administratën publike, e cila përfshin ministratë, komunat dhe organizatat e pushtetit të rezervuar. Mbulimi i saj përfshin organet rregullatore, por nuk mbulon subjektet e destinuara.

Udhëzimet e Thesarit dhe Rregullat Financiare – Numër 02 – Shpenzimi i parave publike – qershor 2006 e ndryshuar në nëntor 2006: Në të kaluarën, Thesari ka hartuar udhëzime administrative, të cilat adresonin shumë aspekte të shpenzimeve dhe çështje të kontrollit të brendshëm në lidhje me paratë publike. Ky dokument i Thesarit azhurnon dhe konsolidon këto udhëzime në një dokument të vetëm.

Rregullorja mbi Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Rregullorja mbi Strukturën e Auditimit të Brendshëm, Janar 2004.

Ekipi Veprues Hetues (ITF) ishte themeluar me Vendim Ekzekutiv të PSSP/UNMIK-ut më 21 tetor 2003. Synimi kryesor i ITF-së është të identifikojë mashtrimet dhe korrupsionin në lidhje me institucionet apo subjektet që financohen plotësisht apo pjesërisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Përmes një marrëveshjeje mes UNMIK-ut, AER-it dhe Qeverisë së Italisë, Njësia e Hetimeve Financiare (NjHF) u themelua më 26 shkurt 2004 brenda ITF-së, e cila përfshin përfaqësues të Zyrës Evropiane Kundër Abuzimeve (OLAF).

Secila organizatë buxhetore duhet të ketë Zyrtarin kryesor Administrativ (ZKA). ZKA është në krye të përgatitjes së buxhetit dhe proceseve të ekzekutimit me delegim nga Ministri. ZKA është gjithashtu përgjegjës për implementimin e kontrollit financiar në organizatën buxhetore.

Thesari është i vendosur në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe është përgjegjës për menaxhimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ai është në krye të kontrollit financiar dhe plotësimit të proceseve të pagesave nga të gjitha organizatat buxhetore. Thesari është gjithashtu përgjegjës për menaxhimin e llogarive bankare në lidhje me Bankën Qendrore të Kosovës, menaxhimin e shpenzimeve të fondeve, përcaktimin e proceseve për grumbullimin e shënimeve, si dhe themelimi e mirëmbajtja e shënimeve llogarimbajtëse.

Sa i përket procedimit të pagesave, Thesari ndërmer kontrollë *ex ante*. Sapo organizatat buxhetore të demonstrojnë sisteme të fuqishme të kontrollit të brendshëm, Thesari do të zvogëlojë këtë pikë kontrolli. Thesari është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e llogarive financiare dhe mirëmbajtjen e Rregullave Financiare.

Për të kryer funksionet e tyre, secila organizatë buxhetore përdor Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (FMIS) për regjistrimin e gjitha transaksioneve dhe sistemin Softverik të Llogarimbajtjes Qeveritare FreeBalance (Libri i përgjithshëm i Thesarit), i cili është i instaluar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF). Ky program mbështet nevojat kryesore të menaxhimit financiar.

Njësia qendrore e harmonizimit për kontrollin e brendshëm të financave publike, themeluar brenda Departamentit të Thesarit në MEF, vazhdon të punojë në kontrollin financiar.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në MEF duhet të bëjë revizionin e brendshëm në organizatat buxhetore sipas një plani pune të përcaktuar nga Sekretari i Përhershëm i MEF-it. Revizioni i brendshëm kryhet në pajtim në Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm; sipas këtij Ligji sistemi i centralizuar i auditimit të brendshëm do të decentralizohet. Secila organizatë buxhetore dhe ndërmarrje autonome publike do të themelojë dhe konsolidojë njësinë e revizionit të brendshëm. Njësitë e tilla do të themelohen në 30 komuna dhe 15 ministri, të cilat në total do të bëjnë 50 njësi të revizionit të brendshëm.

Për momentin, ekzistojnë rreth 100 revizorë të brendshëm në administratën publike: 21 në MEF, 32 në ministritë tjera, 13 në institucionet e pushtetit të rezervuar, si dhe 32 në 26 komuna.

Sa i përket krimeve financiare dhe ekonomike, si dhe në bazë të përvojës së mëhershme me Guardia di Finanzia në implementimin e trajnimeve, NjIF-i ka iniciuar një program ndërtimi kapacitetsh, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK). Synimi kryesor i këtij programi është t'i ofrohet zyrtarëve të SHPK-së njohuritë dhe aftësitë bazë për kryerjen e hetimeve mbi krime financiare dhe ekonomike.

Dokumenti i Politikave mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike u miratua nga Qeveria në janar të vitit 2005, (Vendimi 4/130) si dhe ndryshuar e plotësuar më 1 mars 2006.

Synimet kryesore të NjIF-së për të ardhmen janë përforsimi i bashkërendimit institucional me Zyrën e Auditorit Gjeneral (ZAGj), duke analizuar dhe vlerësuar raportet e ZAGj-it, për të përcaktuar nëse ka bazë të mjaftueshme për ndërmarrjen e hetimeve të mëtutjeshme administrative apo penale, vlerësimi i mundësive të zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet e PIFC-së, si dhe zgjerimi i aktiviteteve në procesin e privatizimit.

Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) ka qenë agjencia kryesore që mbështet zhvillimin e funksionit të auditimit të brendshëm në Kosovë.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e kontrollit financiar, MEF-i dhe palët tjera të përfshira, mes tjerash, do të rishikojnë legjislacionin ekzistues sekondar për përputhjen e tij me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, për të siguruar implementimin e UA Nr. 6/2007, si dhe do të përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve përmes trajnimit.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e kontrollit financiar, MEF-i dhe palët tjera të përfshira, mes tjerash, do të rishikojnë Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm (LAB) dhe harmonizojnë plotësisht me *Acquis*, do të hartojnë legjislacionin sekondar për implementimin e LAB-it, do të krijojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm, do të implementojë Strategjinë për Funksionimin e Institucionit Kosovar të Auditimit të brendshëm, do të përqendrohet në aspektet legjislative dhe ndërtimit të kapaciteteve, duke përfshirë hartimin e Ligjit të ri mbi Institucionin Suprem të Auditimit, dhe rritjen prej 20% në staf çdo vit. Në aspektin e bashkërendimit ndërsektoral, ZAGj ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të obligojë organizatat buxhetore të dorëzojnë planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZAGj-it brenda afateve të rekomanduara.

#### h. Statistikat

Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka funksionuar si zyrë profesionale qysh prej vitit 1948 dhe ka kaluar gjitha fazat historike të Kosovës. Më 2 gusht 1999, ESK-ja rifilloi punën e tij si institucion i pavarur dhe profesional i administratës publike në Kosovë. ESK-ja është agjenci ekzekutive brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike (MShP) dhe ka numër total prej 134 punëtorësh.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/14 mbi Statistikat ka hyrë në fuqi më 2 korrik 2001. Kjo rregullore citon këto detyra si funksione të ESK-së: (a) hartimi dhe zbatimi i strategjisë së përgjithshme, politikave dhe standardeve për grumbullimin e të dhënave, përpilimin e të dhënave statistikore, përpunimin elektronik të shënimeve si dhe shpërndarja e informatave dhe të dhënave statistikore; (b) të sigurojë që gjitha shënimet të merren dhe komunikohen në bazë të metodave dhe teknikave të njohura dhe të përshtatshme e të përdorura në fushën e statistikave; (c) themelimi dhe zhvillimi i shërbimeve të avancuara statistikore; (d) propozimi i rregulloreve, sipas nevojës, mbi çështjet në lidhje me shërbimet statistikore; (e) kryerja e gjitha funksioneve të një Autoriteti Rregullativ mbi shërbimet statistikore; (f) sigurimi i statistikave zyrtare mbi ekonominë, demografinë, gjendjen sociale dhe mjedisore në Kosovë; (g) ndërmarrja e hulumtimeve statistikore; (h) përpilimi dhe mirëmbajtja e regjistrave që do të përdoren për qëllime statistikore; (i) sigurimi i qasjes ndaj informatave statistikore dhe të dhënave për të gjithë shfrytëzuesit, si organet dhe organizatat e administratës publike, ekonominë, institucionet relevante shkencore dhe profesionale, mediat si dhe publikun e përgjithshëm, në pajtim me ligjin në fuqi; (j) garantimi i kushteve për interpretimin standard të shënimeve të grumbulluara dhe të përpunuara si dhe ndërtimi i masave për reagim nga përdorimit të gabueshëm aksidental apo të qëllimshëm të shënimeve statistikore; (k) bashkëpunimi dhe bashkërendimi me organet gjegjëse dhe organizatat e administratës publike në lidhje me shërbimet statistikore; si dhe (l) bashkërendimi i agjencive ndërkombëtare dhe qeveritare si dhe organizatave joqeveritare për të promovuar zhvillimin dhe implementimin koherent të shërbimeve statistikore.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e statistikave, ESK-ja mes tjerash do të fokusohet në përforsimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e pavarësisë operative dhe financiare, si dhe sigurimin e saktësisë në statistika, duke përfshirë cilësinë e të dhënave të marra në hulumtimet me respondentë, që i dorëzohen ESK-së pa pagesë. Më tutje, Ligji mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës do të miratohet, ndërsa ESK-ja do të bëhet agjenci e pavarur. Me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, ESK-ja ka paraparë trajnime dhe rekrutimin e 30 ekspertëve të statistikave produktive, si dhe themelimin e grupeve punuese në fushat e veçanta, me qëllim të përmirësimit të saktësisë dhe cilësisë së të dhënave. Në lidhje me zhvillimin e statistikave ekonomike dhe shpejtimin e zhvillimit të statistikave sociale, do të ndërtohet një numër statistikash, si shërbimet Hoteliere 2008, anketat dhe pyetësorët e ndryshëm, mes tjerash edhe hulumtimi i amvisërive bujqësore, si dhe analiza e statistikave bujqësore, si dhe veprimet tjera të parashikuara në PVPE.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e statistikave, ESK-ja mes tjerash do të fokusohet në përforsimin e kapaciteteve institucionale si dhe përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit brenda sistemit statistikor të Republikës së Kosovës. ESK-ja do të përqendrohet në zhvillimin dhe dokumentimin e një sistemi të menaxhimit cilësor, por edhe standardizimit të Divizionit të Prodhimit dhe Procedurave. Përveç këtyre, PVPE-ja 2008 parashikon krijimin e një Këshilli Statistikor, themelimin e kapaciteteve teknologjike për lidhjen e ESK-së me institucionet tjera, sistemin GIS, standardizimin e prodhimit të statistikave drejt përafrimit me EUROSTAT-in, përkthimin e materialeve të EUROSTAT-it për kodifikim, si dhe një numër trajnimesh për personelin e ESK-së.

### 2.3.3 Drejtësia, Liria dhe Siguria

Duke marrë parasysh prioritetin e Sundimit të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Drejtësia, Liria dhe Siguria reflektohen gjerësisht brenda PVPE-së 2008.

Institucioni kryesor përgjegjës në këtë fushë është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

MPB-ja është themeluar ligjërisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/53. Sipas kësaj Rregulloreje, MPB-ja është përgjegjëse për: (i) zhvillimin e politikave brenda fushës së përgjegjësisë së saj, mundësinë e përgatitjes dhe implementimit të legjislacionit në fushën e rendit dhe sigurisë publike; (ii) administrimi i çështjeve financiare dhe buxhetore të Shërbimit Policor të Kosovës dhe Ministrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; (iii) në koordinim me UNMIK-un, është përgjegjëse për implementimin e Menaxhimit të Integruar të Kufijve, në kuptimin e rregullimit të përcaktuar të vendkalimeve kufitare, në pajtim me standardet e vëna nga Bashkimi Evropian, e sidomos për koordinimin efektiv mes policisë dhe autoriteteve tjera publike të përfshira në kontrollimin e vendkalimeve kufitare; (iv) implementimi i ligjit në fuqi për lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe në bashkërendim me UNHCR-në, ndihma në marrjen parasysh të aplikacioneve për status refugjati në pajtim me ligjin në fuqi; (v) bashkëpunimi, përmes UNMIK-ut, me shërbimet, agjencitë dhe organizatat e jashtme ndërkombëtare që kanë përgjegjësi në fushën e rendit dhe sigurisë publike; (vi) kryerja e funksioneve në procedurat disiplinore kundër zyrtarëve policorë, në pajtim me ligjin në fuqi dhe Komitetin e Emërimeve të Larta Policore dhe Disiplinor (SPADC); (vii) hartimi dhe zbatimi i një strategjie mbi marrëdhëniet publike të Ministrisë dhe mbi bashkëpunimin mes Ministrisë dhe organeve tjera publike me përgjegjësi në fushën e rendit dhe sigurisë publike; (viii) ndihma në administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit dhe bazës së shënimeve të regjistrit qendror civil; (ix) ndihma në administrimin e politikave në lidhje me dokumentet civile dhe ushtrimi i përgjegjësisë në regjistrimin e veturave; (x) grumbullimi, mirëmbajtja dhe analizimi i të dhënave statistikore dhe informatave në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Si rezultat i transferimit të mëtutjeshëm të kompetencave, erdhi shpallja e Rregullores së UNMIK-ut 2006/26, e cila paraqet fillimin e kompetencave në lidhje me ShPK-në. Gjithashtu, kjo çoi në pushimin e ekzistencës së asaj që quhej Shtylla I (Policia e Drejtësisë), e cila u kthye në Zyrën e Policisë dhe Sundimit të Ligjit.

Gjatë kësaj kohe, janë themeluar këto departamente: Departamenti i Administratës Qendrore, Departamenti për Kufij, Azil dhe Refugjatë, Departamenti për Politika të Sigurisë së Brendshme, Departamenti i Statistikave, Hulumtimit dhe Zhvillimit. Gjithashtu, edhe dy zyra: Zyra Ligjore dhe Zyra për Marrëdhënie me Publikun.

Plani Strategjik i MPB-së 2007 – 2010 i cili u miratua në prill të vitit 2007 përcakton 8 Prioritete kryesore strategjike: (i) ndërtimi i strukturës gjegjëse ligjore; (ii) sigurimi i sundimit të ligjit; (iii) të sigurohet mbrojtja e jetës dhe pronës; (iv) të sigurohet liria e lëvizjes; (v) të parandalohet dhe zvogëlohet krimi; (vi) të mirëmbahet rendi publik; (vii) të bashkëpunohet me gjitha organizatat gjegjëse evropiane dhe ndërkombëtare; (viii) të zhvillohet një Ministri efektive dhe efikase.

Plani Strategjik gjithashtu përcakton 6 Synime Strategjike: (i) të zhvillohen shërbime cilësore policore për qytetarë, të cilat janë efektive, efikase dhe transparente; (ii) të hartohet dhe zbatohet Strategjia Kosovare e Sigurisë në Komunitet; (iii) të hartohen dhe zbatohen Strategjitë dhe Planet e Komunikimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të MPB-së; (iv) të zhvillohen kapacitetet organizative e zhvillimore të MPB-së; (v) të ndërtohen kapacitetet, aftësitë dhe kompetencat e Ministrisë; (vi) të përligjen Vlerat e MPB-së.

Marrëdhënia mes MPB-së dhe ShPK-së është zhvilluar më shumë por ende ka hapësirë për përmirësim në komunikim. Themelimi i Inspektoratit Policor të Kosovës si agjenci e pavarur që shërben si element

që do të mundohet të sigurojë ofrimin cilësor të shërbimeve policore për gjithë qytetarët e Kosovës. Rekrutimi i inspektorëve është përfunduar, derisa trajnimi ende vazhdon. Megjithatë, ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm të këtij funksioni të ri. Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë është esencial për të përmbushur përgjegjësitë e saj dhe për të përmirësuar shërbimet për qytetarë.

a. Vizat, Kontrollimi i Kufijve, Azili dhe Migrimi

Aktualisht, nuk ka regjim vizash në Kosovë. Së voni është miratuar Ligji mbi Ministrinë e Punëve të Jashtme, por zbatimi i tij nuk ka filluar ende. Autoritetet kosovare janë përgjegjëse për kontrollimin e kufijve. Megjithatë, siguria e “kufirit të gjelbër” është ende pjesë e kompetencave të KFOR-it.

Kufijtë e jashtëm të Kosovës (gjatësia kufitare, më saktë: me Shqipërinë - 150 km; me IRJM – 140 km; me Malin e Zi – 70 km, dhe me Serbinë - 245 km), nuk janë të përcaktuar, e as të demarkuar.

Numri aktual i personelit shkon deri në 1200 Policë Kufitarë (PK), duke përfshirë punëtorët civilë. Rritja e numrit të punëtorëve është e pashmangshme për efektshmërinë dhe suksesin e policisë në detyrat e vëna.

Pagesa e PK-ve (dhe doganierëve) është e dobët, s’ka mbrojtje sociale e as ligjore; nëse kjo gjendje nuk do të ndryshojë, masat për luftimin e korrupsionit do të pengohen në masë të konsiderueshme.

Kompetenca e PK-së është thellësisht e kufizuar në fushën e PKK-ve (Pikat Kontrolluese të Kufirit). Në kufirin e gjelbër vepron KFOR-i, por ajo nënkuptohet si përgjegjësi vetëm për ruajtjen ushtarake të kufijve.

Konsiderohet e pashmangshme që mbikëqyrja dhe mbrojtja e “kufirit të gjelbër” do të transferohet plotësisht brenda fushëveprimit dhe detyrave të UNMIK-ut/PK, për të pasur mbikëqyrje kufitare në një bartës të njëjtë dhe të vetëm.

Gjendja aktuale arsimore dhe e trajnimeve të PK-së është në rrugë të mirë dhe drejtimin e duhur: megjithatë, ka nevojë për intensifikim në gjitha fushat.

Në bazë të përshkrimit paraprak, gjendja aktuale paraqitet që Kufijtë e Kosovës janë gjerësisht të hapur, ndërsa masat mbikëqyrëse/kontrolluese nuk përputhen me standardet evropiane, mes tjerash, për shkak të bazës së pamjaftueshme ligjore, respektivisht për shkak të mungesës së pajisjeve.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufijve të Kosovës (IBM) në seancën e 279-të të mbajtur më 7 nëntor 2007. Gjatë këtij veprimi, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministritë dhe agjencitë tjera me përgjegjësi kufitare do të jetë e domosdoshme.

Sa i përket rolit perspektiv brenda BE-së, Kosova ka avancuar drejt arritjes së qëllimit 76: ‘Përforcimi i bashkëpunimit mes agjencive të menaxhimit kufitar’, nga Plani Kosovar i Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian, datë 9 gusht 2006. Ky do të jetë një ndër hapat e parë, ndërsa hapat tjerë do të arrihen:

Në lidhje me përmirësimin e marrëdhënieve bilaterale dhe shumëpalëshe, sidomos në lidhje me sigurinë e kufijve, ekziston bashkëpunim i mirë në nivelin lokal me Policinë Kufitare të Shqipërisë, si dhe me disa rezerva, edhe me IRJM-në.

Në masat legislative, prioritet i është dhënë Ligjit mbi Migrimin, implementimi i të cilit kërkon një strategji dhe plan veprimi gjegjës. Masat tjera afatshkurtra kryesisht trajtojnë çështje institucionale dhe implementim direkt të legjislacionit brenda kësaj nën-fushe, duke përfshirë bashkëpunimin mes agjencive të përfshira në menaxhimin kufitar, si dhe agjencitë e ngjashme në vendet fqinje, si dhe themelimin e strehimoreve për azilkërkuesit; por edhe përmirësimi i efikasitetit në kontrollin kufitar

dhe efektivitetit e transparencës në Departamentin e Policisë Kufitare. Në afat të mesëm, prioritet i jepet përmirësimit të kapaciteteve institucionale dhe operative në këtë fushë.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e vizave, kontrollit kufitar, azilit dhe migrimit, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, ndërtimin e TI, përf forcimin e bashkëpunimit rajonal përmes disa marrëveshjeve të bashkëpunimit, do të ndërtohet qendra e re për azilkërkuesit, Ligji mbi Azilin, Ligji mbi të Huajt dhe Ligji mbi Mbikëqyrjen dhe Kontrollimin e Kufijve Shtetërorë do të hartohen, miratohen dhe të fillojnë zbatimin e tyre, Strategjia për Ri-integrimin e Personave të Kthyer do të hartohet, miratohet dhe fuqizohet.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e vizave, kontrollit kufitar, azilit dhe migrimit, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në avancimin e Departamentit për Kufij, Azil dhe Refugjatë brenda MPB-së, në avancimin e nivelit të bashkëpunimit mes MPB-së dhe ShPK-së si dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale.

#### b. Shpërlarja e Parave

Shpërlarja e parave është identifikuar si një çështje që kërkon vëmendje urgjente. Për momentin, Qendra e Inteligjencës Financiare, strukturë e UNMIK-ut, është institucioni kryesor përgjegjës për luftimin e shpërlarjes së parave. Prapë, duke marrë parasysh që luftimi i këtij krimi ekonomik kërkon bashkëpunim dhe qasje shumë-dimensionale, PVPE 2008 adreson këtë çështje përmes veprimeve afatshkurtra, që kërkojnë ndërtimin e kapaciteteve administrative brenda Shërbimit Policor të Kosovës, gjykatave dhe përf forcimin e bashkëpunimit mes gjitha institucioneve të përfshira.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e shpërlarjes së parave, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin e bashkëpunimit mes MPB-së, ShPK-së, Doganave, ATK-së dhe AQBK-së, si dhe miratimi i Ligjit kundër Shpërlarjes së Parave.

#### c. Luftimi i Krimit të Organizuar

Luftimi i korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit është në majën e agjendës së prioriteteve qeveritare. Luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar kërkon vullnet politik. Është zotim i Qeverisë së Kosovës që të aplikojë zero tolerancë kundër këtyre fenomeneve.

Drejtoria për luftimin e krimit të organizuar, si pjesë përbërëse e Shtyllës së Krimit, vepron dhe funksionon në bazë të ligjeve në fuqi, si Kodi i Përkohshëm Penal, si dhe gjithashtu në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54, Rregullores 2001/22 mbi masat kundër Krimit të Organizuar, por edhe në bazë të Parimeve dhe Procedurave Standarde Operative.

Në lidhje me infrastrukturën institucionale dhe ndarjen e përgjegjësi në fushën e luftimit të krimit të organizuar, MPB-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave të sigurisë së brendshme, duke përfshirë krimin e organizuar në këtë rast. UNMIK-u tani është në fazën e transferimit të kompetencave tek MPB-ja dhe Misioni i EULEX-it. EULEX do të ketë përgjegjësinë e monitorimit dhe këshillimit në fushën e sigurisë.

Duke njohur rëndësinë e reagimit në fushën e krimit të organizuar, MPB-ja ka iniciuar Projekt-Strategjinë për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Planin e Veprimit për Parandalimin e Trafikimit të Drogave, si dhe Strategjinë për Grumbullimin e Armëve të Lehta.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e luftimit të krimit të organizuar, mes tjerash, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në vazhdimin e implementimit të Strategjisë për luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit, ndërtimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimit dhe rekrutimit, si dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit me Interpol-in dhe Europol-in.

#### d. Drogat

Problemet në lidhje me drogat, sidomos në trafikimin e tyre, janë identifikuar si brengosëse në Raportin e fundit të Progresit. Kështu, kjo çështje është adresuar gjerësisht me veprimet afatshkurtra dhe afatmesme në PVPE. Kjo bëhet me një qasje që synon zvogëlimin e kërkesës dhe furnizimit të drogave. Në afat të shkurtër, do të krijohet një Grup Ndërmnistror për t'u marrë me hartimin e një Strategjie të Parandalimit të Drogave. Përveç kësaj, për të luftuar krimin në lidhje me drogën, planifikohet ndërtimi i kapaciteteve të ShPK-së përmes trajnimeve, pajisjeve dhe punësimeve. Prioriteti dhe veprimet afatmesme gjegjëse synojnë përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet simotra fqinje në luftimin e krimit në lidhje me drogat.

Kosova është ende vend transiti për heroinën; megjithatë, ekziston një prirje e uljes së nivelit të transimit si rezultat i luftës për parandalimin e narkotikëve. Fillimi i vitit 2008 ka shënuar rezultate pozitive në konfiskimin e substancave narkotike dhe arrestimin e disa grupeve kriminale. Fusha e drogave rregullohet me Kodin e Përkohshëm Penal të 2 nëntorit 2007, derisa është miratuar edhe Ligji mbi Substancat Narkotike Nr. 2007/02-L128.

Në lidhje me infrastrukturën institucionale dhe ndarjen e përgjegjësisë në fushën e luftimit të krimit të organizuar, MPB-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave në këtë fushë. UNMIK-u tani është në fazën e transferimit të kompetencave tek MPB-ja dhe Misioni i EULEX-it. EULEX do të ketë përgjegjësinë e monitorimit dhe këshillimit në fushën e sigurisë.

Duke njohur rëndësinë e reagimit në fushën e krimit të organizuar, MPB-ja ka iniciuar Planin e Veprimit për parandalimin e trafikimit të drogave.

Në afat të shkurtër, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e drogave, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve, themelimin e grupit punues ndërmnistror me qëllim të parandalimit, hetimit, luftimit të narkotikëve dhe edukimit, strategjinë dhe planin e veprimit për parandalimin e drogave.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e drogave, veprimet e parashikuara do të përqendrohen në nivelin e bashkëpunimit mes institucioneve të ndryshme në fushën e drogave, si dhe përf forcimin e bashkëpunimit rajonal.

#### e. Policia

ShPK-ja është organi kryesor për zbatimin e ligjit dhe rendit në Republikën e Kosovës, një organ që gëzon një shkallë të lartë të besimit tek qytetarët. Megjithatë, në përmbushjen efektive të detyrave të tij, si dhe në shërbimin adekuat të shoqërisë, ShPK-ja ka nevojë për ndërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane. Në këtë aspekt, PVPE-ja sugjeron ndryshime në infrastrukturën ligjore. Në afat të shkurtër, synimi është miratimi i legjislacionit gjegjës, duke përfshirë aktet nënligjore, derisa implementimi pritet të fillojë gjatë këtij viti, si dhe të zhvillohet në afatin vijues të mesëm. Gjithashtu, adresohet edhe sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme, duke përfshirë pajisjet moderne për ShPK-në. Shumë veprime janë propozuar për ndërtim kapacitetesh të njësive hetuese të ShPK-së. Çështjet në lidhje me krimin e organizuar dhe terrorizmin janë gjithashtu

të adresuara nga PVPE-ja në nivel strategjik, gjegjësisht me miratimin (implementimin) e strategjive relevante.

ShPK-ja në strukturën e tij ka rreth 8000 oficerë në gjitha nivelet. ShPK-ja si Agjenci Ekzekutive funksionon dhe vepron në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54, Procedurat Standarde Operative, si dhe Ligjit mbi Policinë i cili është në procedurë të miratimit.

Në lidhje me infrastrukturën institucionale dhe ndarjen e përgjegjësi, MPB-ja ndan përgjegjësitë me UNMIK-un për shkak të kompetencave të rezervuara, por me arritjen e EULEX-it, ai do të jetë përgjegjës për mbikëqyrje dhe do të ketë rol këshillues, derisa MPB-ja do të marrë përsipër përgjegjësi shtesë.

Duke marrë parasysh kërkesën për avancimin e cilësisë së punës së ShPK-së, MPB-ja, në bazë të Urdhëresës Administrative Nr. 143 të 13 marsit 2008, e cila analizon mbikëqyrjen, vlerësimin dhe funksionalitetin e Strukturës së ShPK-së, është hartuar analiza e kësaj strukture, ndërsa pritet të themelojë një komitet të përbashkët mes MPB-së dhe ShPK-së për përgatitjen e strukturës së re.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e Policisë, veprimet e parashikuara, mes tjerash, do të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve përmes trajnimit dhe punësimit, miratimit dhe zbatimit të Ligjit mbi Policinë, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit mbi Policinë, do të hartohet dhe zbatohet Strategjia dhe Plan i Veprimit për veprimin policor në parandalimin e krimit, hartimi dhe zbatimi i Ligjit mbi Armët e Lehta, hartimi dhe miratimi i Strategjisë për grumbullimin e armëve në Kosovë, miratimi dhe zbatimi i disa ligjeve, si dhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore.

#### f. Mbrojtja e të Dhënave Personale

Për momentin, nuk ekziston ndonjë sistem adekuat dhe i përafuar me *Acquis communautaire* – për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në afat të shkurtë, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, veprimet e parashikuara, mes tjerash, do të përqendrohen në miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në pajtim me Direktivën për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 95/45/EC) si dhe krijimin e një organi gjegjës të pavarur gjegjës për implementimin e standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës.

Në afat të mesëm, me synim të adresimit të Prioriteteve të Partneritetit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, veprimet e parashikuara, mes tjerash, do të përqendrohen në ngritjen e sistemeve mbrojtëse të shënimeve personale, në pajtim me standardet evropiane, si dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe do të ketë aktivitete të organizuara vetëdijesimi në lidhje me të dhënat personale dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre.

### **3 REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KAPACITETET ADMINISTRATIVE**

#### **a. Sfondi**

Zhvillimi institucional është një nga prioritetet kyçe për avancimin e administratës publike në Kosovë. Me institucione të reja, Qeveria e Kosovë, nën mbikëqyrjen e autoriteteve të UNMIK-ut, ka arritur të konsolidojë plotësisht një shërbim civil profesional dhe të përgjegjshëm. Kompetencat gradualisht po i transferohen autoriteteve vendore nga UNMIK-u, si dhe do të vazhdojnë të mbështeten edhe nga Misioni EULEX.

Përkundër institucioneve të reja, si dhe me zgjidhjen e statusit, përmirësimi dhe reformimi i administratës publike konsiderohet domosdoshmëri për plotësimin e kërkesave aktuale dhe për të përmbushur obligimet e krijimit të shtetit demokratik, për të ofruar shërbime efikase për qytetarë, si dhe për të qenë në gjendje të përmbushjes së obligimeve aktuale dhe të ardhme ndërkombëtare.

Në përpjekjet e vazhdueshme për hyrje në BE, institucionet kosovare do të duhet të përmirësojnë funksionimin e gjithë administratës publike.

#### **b. Institucionet Përgjegjëse dhe Gjendja Aktuale**

Përgjegjësia kryesore për ndërtimin e kapaciteteve të Administratës publike të Kosovës bie tek Ministria e Shërbimeve Publike (MShP), gjegjësisht Institutit Kosovar për Administratën Publike (IKAP). MShP-ja/IKAP-i është përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e politikave drejt krijimit të një shërbimi civil profesional, shumë-etnik dhe të përgjegjshëm në institucionet e Kosovës.

Agjencia për Integritet Evropian, gjegjësisht Departamenti për Komunikim, Informim dhe Trajnime koordinon gjitha aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të shërbyesve civilë në të gjitha fushat në lidhje me BE-në. Zbatimi i PVPE-së do të varet nga niveli i ndërtimit të institucioneve dhe trajnimit të shërbyesve civilë, nga njohuritë dhe aftësitë e përmbushjes së obligimeve të tyre nga Partneriteti evropian.

#### **c. Çka duhet bërë...?**

Implementimi i vazhdueshëm i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike ka identifikuar shtatë fusha strategjike: menaxhimin e burimeve njerëzore, strukturën institucionale, komunikimin me qytetarë, menaxhimin e administratës publike, e-Qeverisja, financimi i administratës publike, anti-korrupsioni, si dhe politikat e legjislacioni.

Prioritetet kryesore përfshijnë hartimin dhe miratimin e legjislacionit në përputhje me Acquis, si dhe funksionalizimi i mekanizmave të monitorimit në implementimin e legjislacionit. MShP-ja është duke implementuar projektin për Rishikimin Funksional të Institucioneve të Kosovës për të iniciuar reformën e administratës publike. E-Qeverisja është prioritet tjetër i Qeverisë për të avancuar punën në administratë publike dhe për të ofruar shërbime efektive për qytetarë e biznese.

Reforma e administratës publike plotëson një nga prioritetet e partneritetit Evropian 2008 si dhe plotëson aktivitetet e trajnimit mbi çështjet e BE-së.

Plani i Integritimeve Evropiane 2008-2010, miratuar nga Qeveria e Kosovës, mbulon ndërtimin e kapaciteteve, trajnimin dhe aktivitete tjera në këtë fushë për implementimin e PVPE-së 2008. Fokusi kryesor i AIE-së do të jetë përfundimi i strukturave evropiane në gjitha nivelet e Qeverisë për të siguruar bashkërendim dhe zbatim më të mirë të PVPE-së 2008.

## 4 PËRKTHIMI I ACQUIS TË BE-SË.

### a. Sfondi

Me çdo asocim të ri, i gjithë legjislacioni i Komunitetit Evropian në fuqi në atë kohë - *Acquis* – duhet të përkthehet në gjuhën e vendit të ri para hyrjes në BE, ashtu që qytetarët të dinë se për çka po përkushtohen.

Në periudhën e para-asocimit, Qeveria e Vendlit, e jo Bashkimi Evropian, është përgjegjëse për përkthimin e legjislacionit evropian në fuqi në gjuhën e saj, si dhe duhet të ndërtojë një njësi të veçantë për këtë. Përkthimi dhe shqyrtimi i *Acquis* është ndoshta e vetmja detyrë në gjithë operacionin e bashkimit që është absolutisht e njëjtë për secilin Shtet aspirues.

Përkthimi i akteve ligjore të BE-së dhe akteve vendore duhet kuptuar si pjesë përbërëse e gjithë procesit të harmonizimit dhe implementimit në lidhje me integrimin në BE. Është qenësore që aktet vendore të përkthehen gjatë vetë transponimit në ligje vendore. Përkthimet e akteve vendore ligjore të harmonizuara me *Acquis* duhet të jenë në dispozicion të institucioneve të BE-së që janë përgjegjëse për monitorimin e progresit të arritur në përafrimin e legjislacionit.

*Acquis* aktualisht përbëhen nga rreth 100 000 faqe të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian (faqe të OJ). Ky është numër “dinamik”, i cili përherë ndryshohet, modifikohet, shumëzohet – mbi 5.000 faqe të Gazetës miratohen në vit.

### b. Institucioni Përgjegjës dhe Gjendja Aktuale

Mes përgjegjësive të AIE-së, përveç harmonizimit të legjislacionit vendor, koordinimit të fondeve të BE-së dhe komunikimit e informimit, ekziston edhe koordinimi i përkthimit të legjislacionit të BE-së, si dhe përgatitja e *Acquis* të BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Dinamika e procesit të përafrimit/harmonizimit me *Acquis të BE-së*, si një nga prioritetet kryesore të Partneritetit Evropian, varet drejtpërsëdrejti nga përkthimi i suksesshëm e korrekt e në kohë i legjislacionit evropian. Në këtë kuptim, procesi i përkthimit do të konsiderohet si një nga prioritetet më të rëndësishme në të cilën nën-fushë duhet investuar shumë në kuptimin e resurseve njerëzore, ekspertizës dhe fondeve.

### c. Çka duhet bërë...?

Përfundimi i mëtutjeshëm i Agjencisë për Integritime Evropiane dhe themelimi i një Zyre të veçantë për Koordinimin e Përkthimit, përgjegjëse për përgatitjen e Versionit Nacional të *Acquis Communautaire* mbeten prioritet kryesorë. Zyra për Përgatitjen e Versionit Kombëtar të *Acquis Communautaire* do të mbulojë dy fusha kryesore:

1. Revizioni dhe Terminologjia, duke përcaktuar kriteret për përkthimin konsistent të akteve ligjore të BE-së, duke krijuar dhe zhvilluar terminologjinë, duke implementuar kontroll mbi procesin e përkthimit të akteve ligjore të BE-së, por edhe legjislacionit vendor.

2. Koordinimi i Përkthimit, monitorimi dhe koordinimi i procesit të përkthimit përmes bazave të centralizuara të shënimeve.

Në ekzekutimin e përgjegjësive të saj në të ardhmen, Zyra për Përgatitjen e Versionit Nacional të *Acquis Communautaire* duhet të arrijë këto synime;

- Përgatitja e Versionit Kosovar të *Acquis Communautaire* – një nga parakushtet për hyrje në BE
- Përkthimi i legjislacionit kosovar
- Mbështetje e plotë ndaj procesit të harmonizimit dhe negociatave
- Bazat e centralizuara të shënimeve
- Terminologjia, përkthimet e memorizuara, si dhe Korpusi i Përkthimeve
- Resurset njerëzore

Duke marrë parasysh këto synime dhe kapacitetet ekzistuese brenda Agjencisë, për këtë qëllim janë parashikuar prioritete afatshkurtra dhe afatmesme, por edhe afatgjate. Prioritetet si të tilla mund të përmbledhen në themelimin e një Zyre për përgatitjen e versionit nacional të *Acquis*, punësimin e stafit me aftësitë e duhura, si dhe fillimin e fushatës në lidhje me *Acquis*.

Hartimi i Planit Strategjik për Përgatitjen e Versionit Nacional të *Acquis Communautaire*, përkthimi i Legjislacionit të Kosovës, bashkëpunimi rajonal me Shqipërinë dhe Maqedoninë, si dhe sipas mundësisë edhe me Serbinë, do të jenë sfidat e ardhshme për Agjencinë për Integritet Evropian – Zyrën për Përgatitjen e Versionit Nacional të *Acquis Communautaire*.

## 5 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

### a. Sfondi

Integritet evropian kanë qenë dhe do të vazhdojnë të ngrihen si prioritete kryesore të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Proceset e integriteteve evropiane do të kërkojnë një përpjekje madhore të menaxhuar së brendshme dhe së jashtme. Qeveria është në procesin e finalizimit të Planit të ri të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) 2008. Kështu, qëllimi dhe funksioni thelbësor i strategjisë së komunikimit të brendshëm do të jetë përfundimi dhe mbështetja e bashkërendimit dhe zbatimit të PVPE-së.

Disa organizata të shoqërisë civile kanë qenë aktive në vitet e fundit, si dhe kanë ndërtuar një numër strukturash që do të sigurojnë platformën e diskutimit dhe mësimin mbi çështjet e BE-së në të ardhmen. Në anën tjetër, ekziston një pajtueshmëri e gjerë që niveli i vetëdijes themelore dhe kuptimit të çështjeve të integritet evropian, si dhe rëndësisë së tyre për realitetin ekzistues është i ultë, në publikun e gjerë por edhe tek udhëheqësit e opinionit. Ekziston një ndjenjë e përbashkët që derisa opinioni është përgjithësisht në favor të integritet evropian, ky bazohet shpesh në një mungesë të diskutimit të informuar, si dhe një vlerësimi jo real të zgjedhjeve që duhen bërë në rrugën e integritet.

### b. Institucionet e Përgjegjëse dhe Gjendja Aktuale

Një nga prioritete kryesore të Qeverisë së Kosovës është të sigurojë informim dhe komunikim efektiv mbi Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian (PVPE) dhe procesin e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asocimit (MPSA) mes institucioneve qeveritare, si dhe, ngritjen e vetëdijes dhe kuptimit të proceseve të integritet evropian tek publiku i përgjithshëm.

AIE-ja ka bashkërenduar përgatitjen e PVPE-së, si dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për udhëheqjen dhe koordinimin e implementimit të tij. Suksesi i PVPE-së do të varet në masë të madhe nga efektiviteti dhe motivimi i atyre që do të jenë të përfshirë në mënyrë direkte (dhe indirekte) në zbatimin e tij. Është qenësisht e rëndësishme për ata që janë të përfshirë që të kuptojnë mirë rëndësinë e procesit, të njohin vlerën e shtuar të kontributit të tyre – si dhe të mbesin të informuar për përparimin e arritur në këtë drejtim. Për këtë qëllim, AIE-ja ka përgatitur Strategjinë e Komunikimit dhe Informimit.

c. Çka duhet bërë...?

Këtë vit, derisa ka përqendrim të vëmendjes në pasojat e statusit të ri dhe rregullimit të ri qeverisës, pritet që një vëmendje më kritike do të përqendrohet në iniciativat e politikave në kontekstin e integritetit evropian dhe implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Ata që kuptojnë drejt procesin pranojnë që integritetet evropiane në të ardhmen nuk do të shihen si përgjithësisht beninje apo neutrale, por më shumë, në secilën fushë të politikave, si krijuese të ndikimeve diferencuese në perspektivën e grupeve të ndryshme të interesit.

Kështu, qëllimi dhe funksioni thelbësor i strategjisë së komunikimit është zhvillimi i mjeteve për t'i mundësuar Agjencisë për Integritet Evropian të promovojë synimin qeveritar për integritet duke siguruar që:

1. Shoqëria e gjerë (duke përfshirë opinionin publik) të jetë e informuar për të pasur vlerësime të arsyeshme dhe realiste të orientimeve politike;
2. Gjitha grupet e interesave sektoriale – duke përfshirë mediat, organet politike (qendrore dhe lokale), organet profesionale (p.sh. komuniteti i bizneseve, sektori rural), partnerët socialë, shoqëria civile, të konsultohen dhe përfshihen si partnerë në formësimin e pajtueshmërisë kosovare mbi integritetet evropiane.

## 6 2008 SHTOJCAT: TABELAT

### a. Tabela e Shpenzimeve të PVPE-së

| Kapitulli                                         |                                                                           | Buxheti     |             |             |             |
|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Fusha                                             |                                                                           | Total       | BKK         | Donacion    | Mungesa     |
| Nën-fusha                                         |                                                                           |             |             |             |             |
| 0. Prioritetet kryesore                           |                                                                           | 68,135,416  | 34,625,224  | 8,500,000   | 25,010,192  |
| 1. Kriteret politike                              |                                                                           | 89,208,855  | 26,452,790  | 39,661,788  | 23,094,277  |
| 1.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit               |                                                                           | 64,019,759  | 16,449,365  | 29,067,788  | 18,502,606  |
|                                                   | 1.1.1 Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes                       | 736,003     | 504,003     | 140,000     | 92,000      |
|                                                   | 1.1.2 Parlamenti/Zgjedhjet                                                | 383,623     | 340,623     | -           | 43,000      |
|                                                   | 1.1.3 Administrata Publike                                                | 26,729,351  | 11,817,808  | 14,196,543  | 715,000     |
|                                                   | 1.1.4 Sistemi Gjyqësor                                                    | 36,122,782  | 3,786,931   | 14,731,245  | 17,604,606  |
|                                                   | 1.1.5 Politika anti-korrupsion                                            | 20,000      | -           | -           | 20,000      |
| 1.2 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave  |                                                                           | 24,133,896  | 9,880,725   | 9,691,000   | 4,562,171   |
|                                                   | 1.2.1 Të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e pakicave | 22,079,600  | 9,030,429   | 9,632,000   | 3,417,171   |
| 1.3 Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare |                                                                           | 1,055,200   | 122,700     | 903,000     | 29,500      |
| 2. Kriteret ekonomike                             |                                                                           | 171,805,482 | 6,931,300   | 12,680,182  | 152,194,000 |
| 3. Standardet evropiane                           |                                                                           | 431,511,010 | 198,586,304 | 87,858,509  | 145,066,197 |
| 3.1 Tregu i brendshëm                             |                                                                           | 57,531,169  | 36,971,016  | 2,035,600   | 18,524,553  |
|                                                   | 3.1.1 Lëvizja e lirë e mallrave                                           | 369,463     | 320,116     | -           | 49,347      |
|                                                   | 3.1.2 Lëvizja e lirë e kapitalit                                          | 1,470,000   |             | 1,470,000   |             |
|                                                   | 3.1.3 Doganat dhe tatimet                                                 | 4,610,700   | 2,538,100   | 220,600     | 1,852,000   |
|                                                   | 3.1.4 Prokurimi Publik                                                    | 299,500     | 299,500     | -           | -           |
|                                                   | 3.1.5 Të drejtat e pronës intelektuale                                    | 141,400     | 110,400     | -           | 31,000      |
|                                                   | 3.1.6 Të drejtat e punësimit dhe politikat sociale                        | 5,096,206   | 28,000      | -           | 5,068,206   |
|                                                   | 3.1.7 Arsimi dhe hulumtimi                                                | 45,543,900  | 33,674,900  | 345,000     | 11,524,000  |
| 3.2 Politikat sektoriale                          |                                                                           | 295,475,833 | 125,499,700 | 83,656,909  | 86,319,224  |
|                                                   | 3.2.1 Industria dhe NVM-të                                                | 1,970,851   | 1,960,851   | -           | 10,000      |
|                                                   | 3.2.2 Bujqësia dhe peshkataria                                            | 7,906,249   | 2,168,500   | 1,636,109   | 4,101,640   |
|                                                   | 3.2.3 Mjedisi                                                             | 15,193,160  | 4,768,160   | 4,650,000   | 5,775,000   |
|                                                   | 3.2.4 Politika e Transportit                                              | 44,783,984  | 7,608,000   | 2,080,000   | 35,095,984  |
|                                                   | 3.2.5 Energjia                                                            | 181,842,560 | 106,325,260 | 73,786,000  | 1,731,300   |
|                                                   | 3.2.6 Shoqëria informative dhe mediat                                     | 35,290,000  | 1,600,000   | -           | 33,690,000  |
|                                                   | 3.2.7 Kontrolli Financiar                                                 | 6,069,814   | 806,214     | 1,504,800   | 3,758,800   |
|                                                   | 3.2.8 Statistikat                                                         | 2,419,215   | 262,715     | -           | 2,156,500   |
| 3.3 Drejtësia, liria dhe siguria                  |                                                                           | 78,504,008  | 36,115,588  | 2,166,000   | 40,222,420  |
|                                                   | 3.3.1 Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi                         | 33,671,854  | 1,046,854   | 1,600,000   | 31,025,000  |
|                                                   | 3.3.2 Luftimi i krimit të organizuar                                      | 6,562,000   | 4,000       | 8,000       | 6,550,000   |
|                                                   | 3.3.3 Shpëlarja e parave                                                  | 56,000      | 48,000      | 8,000       | -           |
|                                                   | 3.3.4 Drogat                                                              | 334,500     | 72,000      | -           | 262,500     |
|                                                   | 3.3.5 Policia                                                             | 37,389,714  | 34,781,214  | 550,000     | 2,058,500   |
|                                                   | 3.3.6 Mbrojtja e të dhënave personale                                     | 489,940     | 163,520     | -           | 326,420     |
| BUXHETI TOTAL                                     |                                                                           | 760,660,763 | 266,595,618 | 148,700,479 | 345,364,666 |

b. Tabela e Legjislacionit të Ri

| Veprimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Afati   | Institucioni përgjegjës | Institucioni përgjegjës | Dokumenti referues                                           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|-------------------------|-------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Tabela siguron një pasqyrë të rregullave nacionale ligjore që do të harmonizohen me legjislacionin e BE-së dhe përmban ligje dhe akte nën-ligjore me një listë të masave të BE-së që duhet të transpozohen në to, si dhe institucioni i cili është përgjegjësi kryesor për përgatitjen e aktit duke përfshirë mbetjen e institucioneve që marrin pjesë në përgatitjen rregullave ligjore. Afati për miratimin e rregulloreve nga Qeveria e Republikës së Kosovës është shënuar si dhe afati për miratim nga ana e Kuvendit të Kosovës poashtu. |         |                         |                         |                                                              |
| <b>0. Prioritet kyq</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |         |                         |                         |                                                              |
| <b>4. Të sigurohet respekt i plotë për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve si dhe të ndjeket një politikë për zero tolerancë kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimit financiar.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |         |                         |                         |                                                              |
| 2. Kushtetuta së Republikës së Kosovës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 |                                                              |
| 4. Ligji për te drejtat dhe interesat e komuniteteve pakice                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 |                                                              |
| 6. Ligji mbi menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | K3-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| 9. Ligji mbi deklarimin e origjinës së pasurisë të zyrtarëve të lartë publik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| <b>5. Të sigurohet qeverisje demokratike dhe bartje e shërbimeve publike tek të gjithë qytetarët e Kosovës, duke themeluar administratë publike reprezentuese e cila është profesionale, e përgjegjshme, e arritshme, e liruar nga ndërhyrjet politike.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                    |         |                         |                         |                                                              |
| 3. Ligji mbi ndërmarrjet publike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| 6. Ligji mbi transferin e ndërmarrjeve publike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| <b>6. Të avansohet reforma e vetë-qeverisjes dhe të ngirten kapacitetet administrative për të ndihmuar decentralizimin, duke i marrë nën konsideratë synimet dhe intereset e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të adaptohet korniza legjislative dhe të ndahen resurset e duhura buxhetare.</b>                                                                                                                                                                                                                                                |         |                         |                         |                                                              |
| 2.Ligji për vetëqeverisje lokale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| 6. Ligji për kufijt komunal                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| 9. Ligji mbi zgjedhjet lokale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | K2-2008 | Kuvendi i Kosovës       | Qeveria                 | Strategjia Legjislative 2008                                 |
| 11.Ligji mbi referendumin komunal                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | K3-2008 | MAPL                    | Qeveria                 | Pako e Ahtisarit, Karta Europiane mbi Vetë-qeverisjen Lokale |
